

**LEGJISLACIONI DHE PRAKTIKAT E RAJONIT**

**NË LUFTIMIN E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE PASURISË SE PALIGJSHME**

Shqipëri

Kroaci

Turqi

Sloveni

Bullgari

Maqedoni

Serbi

Kosova



**PERSONELI**

**Ismet KRYEZIU** - Drejtor Ekzekutiv

email: [ikryeziu@kdi-kosova.org](mailto:ikryeziu@kdi-kosova.org)

**Vjollca VOGËL** - Menaxhere e administratës dhe financave

email: [vjollca@kdi-kosova.org](mailto:vjollca@kdi-kosova.org)

**Leonora CIKAJ** - Asistente për administratë dhe financa

email: [lcikaj@kdi-kosova.org](mailto:lcikaj@kdi-kosova.org)

**Donjeta DRESHAJ** - Asistente për administratë dhe financa

email: [ddreshaj@kdi-kosova.org](mailto:ddreshaj@kdi-kosova.org)

**Arsim Gjinovci** - IT & Design

email: [agjinovci@kdi-kosova.org](mailto:agjinovci@kdi-kosova.org)

**PROGRAMI: TRANSPARENCA DHEANTIKORRUPSIONI**

**Merita MUSTAFA** - Menagjere e programit

email: [mmustafa@kdi-kosova.org](mailto:mmustafa@kdi-kosova.org)

**Enis XHEMAI** - Kryesues i hulumtimit

email: [exhemai@kdi-kosova.org](mailto:exhemai@kdi-kosova.org)

**Besnik RAMADANAJ** - Asistent i projektit

email: [bramadanaj@kdi-kosova.org](mailto:bramadanaj@kdi-kosova.org)

**Natyra KASUMAJ** - Koordinatore

email: [nkasumaj@kdi-kosova.org](mailto:nkasumaj@kdi-kosova.org)

**PROGRAMI: DEMOKRATIZIMI DHE  
PRAKTIKAT PARLAMENTARE**

**Driton SELMANAJ** - Menaxher i programit

email: [dselmanaj@kdi-kosova.org](mailto:dselmanaj@kdi-kosova.org)

**Isuf ZEJNA** - Asistent i projektit

email: [izejna@kdi-kosova.org](mailto:izejna@kdi-kosova.org)

**PROGRAMI: ZGJEDHJET E LIRA DHE TË DREJTA**

**Liridon SELMANI** - Menaxher i programit

email: [lselmani@kdi-kosova.org](mailto:lselmani@kdi-kosova.org)

**PROGRAMI: QEVERISJA LOKALE DHE  
PJESËMARRJA QYTETARE**

**Kreshnik BASHA** - Koordinator

email: [kbasha@kdi-kosova.org](mailto:kbasha@kdi-kosova.org)

**NaimCAHANAJ** - Koordinator

email: [ncahanaj@kdi-kosova.org](mailto:ncahanaj@kdi-kosova.org)

Ky punim është përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)/ Transparency International Kosova (TIK), në bashkëpunim me partnerët regjional të organizatës me renome botërore “Transparency International” me degët e saja në Kroaci, Bullgari, Slloveni, Serbi, Turqi, Maqedoni dhe Shqipëri.

**Partnerët që kanë kontribuar në këtë punim :**

- Kroaci (TI Croatia /TI Hrvatska, National Chapter)
- Bullgari (Transparency International Bulgaria, National Chapter)
- Slloveni (DRUSTVO Integriteta - Association for Ethics in Public Service (National Chapter in Formation))
- Serbi (Transparency Serbia / Transparentnost Srbija)
- Turqi (Transparency International Turkey / Seffaflik Dernegi (National Chapter in Formation))
- Maqedoni (Transparency-Zero Corruption , National Chapter)
- Shqipëri - (Transparency International Albania, National Chapter)

Publikimi i punimit “Legjislacioni dhe praktikat e rajonit në luftimin e krimit të organizuar dhe pasurisë se paligjshme” është mundësuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, Projekti “Avokimi për Kompletimin e Pakos së Ligjeve Anti-Korrupsion në Kosovë”

**Përmbajtja**

Përmbledhje.....	6
Kroaci .....	9
Bullgari.....	19
Slloveni.....	29
Serbi.....	47
Turqi.....	68
Maqedoni.....	78
Shqipëri.....	91

## Përmbledhje

6

Krimi i organizuar (kontrabanda, trafikimi, pastrimi i parave etj), korrupsioni janë aktivitete fitimprurëse, të cilat ndikojnë në stabilitetin ekonomik, politik dhe social të çdo vendi. Këto fenomene në vazhdimësi po i përcjellin në një apo formë tjetër, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, që reflekton mungesën e mbrojtjes të të drejtave pronësore, të mundësive të punësimit dhe dobësisë së shtetit.

Format e ndryshme të manifestimit të krimit të organizuar dhe prezenca gjithnjë e më e madhe e tij, si dhe infiltrimi në shumë fusha, duke shfrytëzuar lëvizjet jo të dobishme në sferën shoqërore - ekonomike politike e sfera tjera, është shndërruar në njërin ndër faktorët destabilizues, kufizues dhe frenues të konsolidimit dhe zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërive në tranzicion, së këndejmi edhe të vendeve të Ballkanit.

Se çfarë është gjendja aktuale, dhe me cilat sfida po përballen në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, shumica e vendeve të Ballkanit? Ky punim do të tentojë të ofrojë të dhëna të mjaftueshme dhe shumë të rëndësishme lidhur me legjislacionin dhe praktikat e vendeve të rajonit në luftë kundër krimit të organizuar dhe pasurisë së paligjshme.

Kroaci - Të dhënat nga raportet e ndryshme lidhur me këtë vend, të tilla si "Raporti Kombëtar për Drejtësi dhe Punë të Brendshme i vitit 2004<sup>1</sup> vëren se "krimi i organizuar në Republikën e Kroacisë kryesisht përcaktohet nga tre faktorë: pozicionin gjeografik, proceset gjithpërfshirëse ndërkombëtare dhe nga pasoja e shkatërrimit të Jugosllavisë". Korniza ligjore për frenimin e krimit të organizuar po përmirësohet çdo here e më shumë dhe institucionet kroate po përmirësojnë kapacitetet e tyre për tu marrë me krimin e organizuar.

Bullgari - Legjislacioni kundër krimit të organizuar dhe pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme, rregullohet në detaje me disa ligje. Këto ligje po zgjerohen dhe përmirësohen vazhdimisht. Kompetencat e institucioneve që i luftojnë këto dukuri negative përcaktohen plotësisht dhe ekziston ndarje e qartë ndërmjet përgjegjësive dhe detyrimeve të tyre. Problemi në këtë vend është se ligjet nuk zbatohen mjaftueshëm në praktikë. Ka shumë arsye për këtë - mungesa e burimeve financiare dhe të tjera, mungesa e motivimit, numri i vogël i krimeve të zbuluara, etj

Slloveni - Përmes analizimit të legjislacionit që ndërlidhet me luftimin kundër krimit, analizat kanë treguar që në krahasim me pjesën tjetër të Evropës, shteti slloven ka ligje më adekuate dhe institucione shumë më të specializuara për ndjekjen penale të krimeve, të cilat megjithatë nuk janë të lidhura me njëra tjetrën dhe nuk punojnë së bashku. Të gjeturat tregojnë që ky bashkëpunim nuk është duke funksionuar mirë për shkak të interesave personale të individëve që punojnë në këto institucione. Gjykatat të cilat së fundmi janë fajësuar për mos-ulje të shkallës së krimit, nuk kanë përfaqësues politik që mund të flasin në favor të pavarësisë së gjykatave.

<sup>1</sup> Gluščić, Stjepan, Mbështetje për promovimin e mirëkuptimit reciprok në mes të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, Raport nacional, DREJTËSIA DHE PUNËT E BRENDSHME, nën Marrëveshjen e Grantit Specifik RELEX I-2 190202 REG 4-14, Cepor, 2004

Serbi - Krimi i organizuar në këtë shtet është i pranishëm në të dyja format e tij "klasike", si krim i dhunshëm, kontrabandimi i narkotikëve, vjedhja e makinave, etj, por gjithashtu edhe në formën e "re", të organizuar si krim i "jakës së bardhë" lidhur me shpërdorimet e privatizimit, shmangia nga tatimet ose shpërdorimi i burimeve publike. Element domethënës që ka ndikim në nivelin e krimit të organizuar është statusi i vendit transit për disa tipe të veprimtarisë kriminale. Faktor tjetër i rëndësishëm është bashkëpunimi rajonal dhe ndër-shtetëror i grupeve të organizuara kriminale.

Që nga viti 2003 dhe vrasja e Kryeministrit Zoran Djindjic, nga një grup i organizuar kriminal, Serbia ka ndërtuar kornizë të fortë ligjore dhe institucionale për ta luftuar krimin e organizuar, që përfshin organet e veçanta të krijuara (prokuroria, gjykatat, njësitë policore), mundësinë për të përdorur teknika të veçanta hetimi me qëllim të luftimit të krimit të organizuar si dhe mundësia e dhënies së statusit të dëshmitarit bashkëpunues anëtarit të grupit të organizuar kriminal.

Turqi - Burimet kryesore i të ardhurave ilegale në Turqi janë të lidhura ngushtë me trafikimin e drogës, por gjithashtu edhe me kontrabandën, mashtrimet dhe falimentimet, falsifikimin e dokumenteve, grabitjet, plaçkitjet dhe kidnapimet në autostradë dhe krimet serioze kundër shtetit. Metodot primare për pastrimin e fondeve janë transferet e parave dhe transaksionet tjera bankare, transaksionet komerciale, transaksionet e llogarive dhe blerja e pronës së paluajtshme.

Turqia ka treguar përpjekje të rëndësishme me qëllim të ballafaqimit me problemin në rritje të krimit të organizuar në vitet e fundit. Gjatë procesit të aderimit në BE, një numër i ndryshimeve po bëhet me qëllim të ofrimit të ligjeve turke në linjë me *acquis communautaire*. Këto përfshijnë Kodin e ri Penal të Turqisë, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin mbi Parandalimin e Pastrimit të Pasurive të Fituara nga Veprat Kriminale. Turqia gjithashtu ka nënshkruar shumicën e traktateve ndërkombëtare.

Maqedoni - Edhe ky shtet përkundër që ka avancuar dukshëm në procesin ligjor në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, megjithatë nuk është imune ndaj aktiviteteve kriminale dhe të jashtëligjshme nga grupet kriminale dhe veprimeve korruptive nga individë dhe zyrtarë publik.

Shqipëri - Për disa vjet në Shqipëri, reagimi ndaj veprimtarive kriminale në rritje ishte i dobët për shkak të presionit, korrupsionit, frikës dhe pasigurisë. Sidoqoftë, ishte presioni i vazhdueshëm ushtruar nga organizatat ndërkombëtare dhe nga vet qytetarët që i bënë institucionet të ndërmarrin masa për luftimin e krimit të organizuar dhe disa prej formave të tij, si: trafikimi i qenieve njerëzore - femra ose fëmijë, trafikimi i armëve, trafikimi i automjeteve, trafikimi i substancave narkotike dhe kultivimi i bimëve narkotike.

Sidoqoftë duhet konstatuar se ekziston një mobilizim i të gjitha shteteve të sipërmendura që të konsolidojnë qoftë bazën legale apo edhe veprimet konkrete bilaterale dhe multilaterale që këto dukuri të goditen fuqishëm.







Kroaci

## Vlerësimi mbi nivelin e krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme

*Historiku dhe vlerësimi mbi nivelin e krimit të organizuar dhe pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme*

Shfaqja e krimit të organizuar në Kroaci mund të vërehet që nga ndarja e ish Jugosllavisë dhe embargoja e armëve e cila e pengoi Kroacinë të blejë armë në mënyrë ligjore. Si rezultat, me qëllim të blerjes së armëve për vetëmbrojtje qeveria kroate iu drejtua tregut të zi i cili operonte përgjatë tërë ish vendit. Gati nuk kishte mbikëqyrje mbi shpenzimet e parave nga buxheti i shtetit dhe atij të krijuar nga diaspora, çka u krijoi rrethana individëve për të përfituar në aspektin financiar, por edhe në pushtetin politik (rasti më i famshëm i cili tani po pret gjykimin është ai i ashtuquajtur "Rasti Thesari" me Gjeneralin Vladimir Zagorec)<sup>2</sup>.

Në fillim të viteve '90 grupet e nëntokës gjithashtu u futën në trafikimin me naftë, duhan dhe mallra tjera në dhe përmes vendeve në konflikt. Përpyekjet nga gazetarët hulumtues të cilët i përcollën këto raste dhe raportuan për to (Ferald Tribune, Globus, Nacional) mbetën të mbyllura dhe çfarëdo raportimi për lidhjet e zyrtarëve dhe aktiviteteve ilegale etiketohej si jo-patriotike, kundër shtetit dhe "jugonostalgjike". Përveç kësaj, një numër i proceseve gjyqësore ishin nisur kundër botuesve dhe gazetarëve, të cilët ishin ndjekur me raste në gjykata, kërcënime fizike, imponim të taksave dhe forma tjera të presionit politik.

Raporti Kombëtar për Drejtësi dhe Punë të Brendshme i vitit 2004<sup>3</sup> vëren se "krimi i organizuar në Republikën e Kroacisë kryesisht përcaktohet nga tre faktorë: pozicioni gjeografik, proceset gjithëpërfshirëse ndërkombëtare dhe nga pasoja e shkatërrimit të Jugosllavisë". Raportet e njëjta tregojnë se struktura e llojeve të shkeljeve kriminale të kryera nga krimi i organizuar në Kroaci zbulon një numër të fushave në të cilat grupet e organizuara operojnë, siç janë kontrabanda me narkotik, armët, njerëzit, produktet me tarifë të lartë, zhvatjet, shantazhi, mbrojtja me forcë - reketimi, korrupsion, kërcënimet dhe vrasja. Përveç kësaj, ata filluan ti investojnë pasuritë-paratë e fituara në mënyrë të paligjshme në prona të paluajtshme atraktive dhe aktivitete të caktuara ekonomike". Raporti gjithashtu thekson se "sot në Kroaci "kravata e bardhë" e krimit po bëhet gjithnjë e më shumë e zakonshme, me qëllimin themelor që të investohet kapitali i fituar me qëllim të përfitimit ekonomik dhe pushtetit politik". Ky raport më gjithëpërfshirësi gjer tani, vjen në përfundim se "llojet më të rëndësishme të krimit të organizuar në Republikën e Kroacisë mbesin llojet tradicionale si: emigrimi ilegal, kontrabandimi me narkotik, kontrabandimi dhe shitja e armëve dhe falsifikimi dhe shpërndarja e parave të falsifikuara".

Mesatarisht Kroacia regjistron rreth 105,000 shkelje kriminale të llojeve të ndryshme. Sipas raportit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kroacisë, në 2010 policia ka regjistruar 107,995 krime në total. Në 73,328 raste proceset ishin iniciuar ex officio, në

<sup>2</sup> Dolezal, Dalibor. Krimi i Organizuar dhe Korrupsioni në Kroaci - Vështrim Kriminologjik, në: Krimi i Organizuar dhe Konteksti Politik në Ballkan, Fondacioni për Monitorimin e Rrezikut, 2010, f.63.

<sup>3</sup> Gluščić, Stjepan, Mbështetje për promovimin e e mirëkuptimit reciprok në mes të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, Raport nacional, DREJTËSIA DHE PUNËT E BRENDSHME, nën Marrëveshjen e Grantit Specific RELEX I-2 190202 REG 4-14, Cepor, 2004

12,448 raste proceset dështuan që në fillim për shkak të mungesës së padive (nuk ishin shpallur dënime) dhe në 22,219 raste procedura penale ishte iniciuar duke ndjekur një proces gjyqësor privat. Nëse përqindja e krimit kalkulohet nga të gjithë regjistrat e krimeve kishte 2,433 krime për 100,000 banorë dhe përqindja e krimeve për të cilat policia inicioi rastet e shkeljeve ex officio ishte 1,652 krime për 100,000 banorë. Nga 73,328 shkelje kriminale për të cilat procedura shkon ex officio një total prej 47,267 (p.sh. 48.8 përqind) ishin zgjidhur. Në krahasim me 2009 numri i të gjitha krimeve të raportuara u zvogëlua për 0,3 përqind, dhe krimet për të cilat ishte iniciuar procedura ex officio u zvogëlua për 0.2 përqind.

Krim i organizuar ishte regjistruar në 921 raste, çka përbën 1.3 përqind të shkeljeve kriminale të filluara ex officio. Krahasuar me 2009 kjo paraqet një rritje prej 22.3 përqind, dhe 590 persona ishin në ndjekje ligjore (553 persona ishin në ndjekje ligjore në vitin 2009). Sipas raportit, kjo rritje është rezultat i një bashkëpunimi të përmirësuar në hetimin ndërkombëtar të zhvilluar në 2009 dhe 2010. Rezultati më i qartë ishte pre- rja e kanaleve më të rëndësishme të kontrabandës, e ashtuquajtura Rruga e Ballkanit, e cila ishte transferuar në vendet fqinje të BE-së. Ministria e Punëve të Brendshme thek- soi në raportin e saj se gjatë hetimeve në lidhje me krimin e organizuar, një numër i konsiderueshëm i krimeve tjera ishin regjistruar, të cilat në mënyrë statistikore i takonin fushave tjera, siç janë krimi ekonomik dhe korrupsioni.

Në raportet ndërkombëtare, Kroacia është përmendur në Vlerësimin e Kërcënimit të Krimit të Organizuar të 2011 (OCTA) në lidhje me trafikimin e armëve: „Ballkani Perëndimor pritet të jetë një burim kyç i trafikimit të armëve të rënda të zjarrit në BE, për shkak të rezervave të mëdha të paligjshme në Shqipëri, Bosnje e Hercegovinë, Kroaci, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi<sup>4</sup>”. Sipas informacioneve në dispozicion në Gunpolicy.org, “armët e mbajtura pa leje (...) në Kroaci vlerësohet të jenë 597,458”<sup>5</sup>. I njëjti burim, i bazuar në Raporti Nacional i Kroacisë mbi zbatimin e Programit të Veprimit i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Luftimin dhe Çrrënjosjen e Tregtisë së Armëve të Vogla të Paligjshme dhe Armëve të Lehta në të Gjitha Aspektet (UNPoA) dhe Hulumtimi i ALË për Kroacinë: Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta (SEESAC tregon se niveli i armëve të zjarrit dhe kontrabandimi me mu- nicione në Kroaci është i lartë.

Strategjia e SHBA-ve për Luftimin e Krimit të Organizuar Ndërkombëtar e lëshuar në korrik të 2011 nuk e përmend Kroacinë në mënyrë specifike, por e përfshinë Ballkanin si një nga prioritetet rajonale ku deklorohet se “kanal tradicional për kontrabandimin e armëve në mes të lindjes dhe perëndimit, Ballkani është bërë një ambient ideal për kultivimin dhe zgjerimin e Krimit të Organizuar Transnacional (KOT). Institucionet e dobëta (...) u kanë mundësuar grupeve të KOT me bazë në Ballkan që ti pushtojnë rrugët kryesore të trafikimit me qenie njerëzore dhe drogë dhe tregjet e Evropës Perëndimore. Rajoni i Ballkanit është bërë një pikë e re hyrëse për kokainën Amerikano- Latine, një burim i drogave sintetike dhe një rajon tranzit për kemikalet pararendëse të heroinës për përdorim në Kaukaz dhe Afganistan. Armët e shkatërrimit në masë kon- trabandohen tek vendet e interesuara. Kontrollat e pamjaftueshme të kufijve dhe

<sup>4</sup> Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar i BE-së, OCTA, 2011, f. 29.

<sup>5</sup> <http://www.gunpolicy.org/firearms/region/croatia>

lehtësia e marrjes së pasaportave mundëson tranzitin e kriminelëve dhe figurave terroriste në Evropën Perëndimore.

Bashkëpunimi në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, gjithashtu bashkëpunimi bilateral me vendet në rajon për të rritur zhvillimin e institucioneve ligjore, progresi ekonomik dhe qeverisja e mirë në Ballkan do të jetë kyç për eliminimin e një ambienti mbështetës për KOT<sup>6</sup>. I njëjti raport tërheq vërejtjen se „Shumica prej grupeve mirë të organizuara të cilat nuk kanë qenë të involvuara në trafikimin e drogës – duke përfshirë ato në Rusi, Kinë, Itali, dhe Ballkan – tani po i krijojnë lidhjet me prodhuesit e drogës për të zhvilluar rrjetet e tyre të shpërndarjes dhe tregjeve”, duke tërhequr vërejtjen se „zgjerimi i trafikimit të drogës shpesh shoqërohet me një rritje dramatike të korrupsionit dhe krimit lokal”<sup>7</sup>.

### Baza ligjore dhe ndarja e përgjegjësive për institucionet

Në Kroaci krimi i organizuar mbulohet nga legjislacioni vendor (Kodi Penal, Akti i Procedurës Penale (APA), Akti i Policisë (AP), Akti mbi Frenimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (AFKKO), Akti Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (AKPPFT), Akti i Mbrojtjes së Dëshmitarëve (AMD), Akti i ri për Konfiskimin e Pasurive të Fituara në Mënyrë të Paligjshme (AKPFMP), dhe instrumentet legale ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara nga Kroacia.

Sipas Kodit Penal, baza për krimin e organizuar është një organizatë kriminale, e cila definohet si grup prej së paku tre personave që punojnë së bashku me një qëllim të përbashkët për të kryer veprime kriminale, për të përfituar në mënyrë të drejtpërdrejt apo jo të drejtpërdrejt financiarisht apo të mira materiale. Për këto veprime kriminale dënimi minimal është katër vite burgim. Kodi Penal tani po amandamentohet dhe gjatë sessionit parlamentar i cili do të fillon pas 15 shtatorit duhet ti nënshtrohet leximit të dytë dhe final.

Një nga ndryshimet më të rëndësishme në rregullativën kroate sa i përket frenimit të krimit të organizuar është Akti i ri mbi Konfiskimin e Pasurive të Fituara në Mënyrë të Paligjshme, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2011. Ky Akt mundëson një konfiskim më të lehtë dhe më efikas të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme – një fushë e cila më parë ishte rregulluar nga disa akte të ndryshme dhe konventa ndërkombëtare të ratifikuara nga Kroacia.

Dispozitat e Kodit të ri Penal dhe APA inkorporojnë dispozita që lidhen me masat e sigurisë dhe pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme. Amandamentet e Kodit Penal të dekretuara me 1 korrik 2009 përcaktojnë konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme të personave që gjenden fajtor dhe krimin e organizuar. Kjo shtrihet tek e gjithë prona që i takon personit, me përjashtim të pasurive për të cilat vërtetohet se janë të fituara në mënyrë të ligjshme. Në vitin 2009 masat e sigurisë u ishin shqiptuar 32 personave dhe pasuritë u ishin konfiskuar 40 personave. Zyra për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (LKKO) mund të urdhëron ngrirjen e pasurisë së një personi

<sup>6</sup> <http://www.whitehouse.gov/administration/eop/nsc/transnational-crime/threat>

<sup>7</sup> Po aty

të dyshuar për veprime të lidhura me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Zyra mund tu qaset të dhënave në posedim të Autoritetit Tatimor në kontrollimin e të hyrave të të dyshuarve. Në vitin 2009 pasuritë u ishin ngrirë në një vlerë totale prej 3,960,076.70 HRK, 80,000 EUR, pronë e luajtshme me një vlerë prej 527,000 HRK, aksione në vlerë të 4,400,000 HRK dhe pasuri e paluajtshme në vlerë prej 8,000,000 HRK. Në të njëjtën periudhë një total prej 28,631,525.65 HRK dhe 424,484 EUR ishin konfiskuar.

Nga 1 shtatori 201 hyri në fuqi APA -ja e re, e cila ishte në linjë me legjislacionin e BE-së të fundit vitit 2008. CPA-ja e re e transferon hetimin dhe mbledhjen e evidencës nga gjykatësit hetues tek prokurori i shtetit, të cilët kanë autoritet më të gjerë (p.sh. ekzaminim të tërthortë) dhe tani është gjithashtu edhe Prokurori i Shtetit në vend të gjykatës i cili merr vendime nëse një rast do të pranohet apo refuzohet. Prokurori i Shtetit gjithashtu lëshon urdhra për policinë, duke mundësuar një mbledhje më të shpejtë dhe më të lehtë të evidencës.

### Institucionet Përgjegjëse

Një linjë institucionale e ashtuquajtur veprimi “anti-mafia” që përfshin Zyrën Kombëtare të Policisë për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, USKOK dhe departamentet e gjykatës të specializuara ekskluzivisht në krimin e organizuar dhe korrupsion ishte themeluar.

Zyra për Ndalimin e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (ZNKOK) – agjencia e parë e specializuar për luftimin e krimin të organizuar dhe korrupsionit- ishte themeluar në vitin 2001. Zyra Kombëtare për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ishte themeluar në qershor të 2008 brenda Drejtoratit të Policisë Kriminale të Drejtoratit të Përgjithshëm të Policisë në një përpjekje për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate trendeve të tanishme në krimin e organizuar dhe korrupsion dhe përbëhet nga Zyra Qendrore dhe 4 qendra rajonale. Ky model i organizimit të Policisë Kriminale është në linjë me organizimet e Zyrës për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (ZNKKO), derisa parimet bazë të operimit të Zyrës Kombëtare janë përshtatshmëria dhe fleksibiliteti. Detyra e Zyrës së Policisë është të monitoroj dhe studioj ngjarjet rreth korrupsionit dhe krimin të organizuar, kështu që ekipet e Zyrës së Policisë mund të veprojnë në parandalim veçanërisht në fusha të ndjeshme, mbi bazë të rezultateve të analizës. Në të njëjtën kohë, Zyra mundëson që hetime më komplekse kriminale të kryhen në një mënyrë multidisiplinare në bashkëpunim me ZNKKO kur ka ballafaqim me raste të korrupsionit të nivelit të lartë. Në 2009 katër zyra rajonale të ZNKKO ishin formuar në katër qytetet më të mëdha kroate (Zagreb, Split, Rijek dhe Osijek) të cilat miratojnë hetimet kriminale mbi krime të organizuara apo komplekse, veçanërisht kur hetimet janë nën juridiksionin e disa policive të qarqeve administrative, kur nevojitet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe kur mënyrat më komplekse të krimin të organizuar janë në fokus. Kjo zyrë e re ishte formuar mbi baza të vet përvojës së policisë kroate dhe praktikave të mira të policive nga vendet e BE-së. Kjo gjithashtu është një sjellje proaktive e bazuar në një koncept të Policisë së Udhëhequr nga Inteligjenca, i njohur si element kyç në Strategjinë e BE-së për zhvillimin e sferës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë (Programi i Hagës 2004-2009). Me qëllim të arritjes së veprimeve me shpejtësinë e dëshiruar në të gjitha nivelet, ndryshimet në Rregulloren e Gjykatës të adop-

tuara në tetor të viti 2008 kujdeset për formimin e departamenteve të veçanta të gjykatave në qarqe dhe komunat e Zagrebit, Splitit, Osijekut dhe Rijekes për tu marrë ekskluzivisht me rastet që bien në kompetencë të ZNKKO-së të ashtuquajtura gjykatat e ZNKKO-së. Veç kësaj, kushte tjera janë parashikuar për të garantuar shtytje dhe kompaktësi për procedurat gjyqësore – kontrollet obligative të sigurisë mbi gjykatësit në departamentet e ZNKKO-së, afatet precize për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara për shqyrtimin e rasteve (p.sh. gjykatësit e ZNKKO-së duhet ti fillojnë sesionet hetimore dhe debatet kryesore brenda shtatë ditësh pas marrjes së padisë), konfidencialitetin e dosjeve, monitorimin statistikor të rasteve të korrupsionit, etj. Gjykatësit e ZNKKO-së caktohen për një mandat prej katër vitesh dhe marrin paga më të larta rreth 400 Euro se sa gjykatësit e zakonshëm. Me qëllim të dhënies prioritet rasteve penale të cilat kanë të bëjnë me shkelje për korrupsion, Rregullorja e Gjykatës ishte ndryshuar në shtator të 2008 dhe ishte krijuar një bazë e të dhënave mbi statusin e rasteve të korrupsionit nga Gjykata Supreme e Republikës së Kroacisë. Aktivitetet e ZNKKO fokusohen në veprimin mbi një seri të rasteve mesatare apo të nivelit të lartë të rasteve të korrupsionit (INDEKS, ZAGREBAČKE CESTE, MAESTRO, DIJAGNOZA I dhe II, GRUNTOVEC, dhe të tjera). Qasja proaktive e ZNKKO ishte fuqizuar, duke quar në zbulimin dhe ndjekjen ligjore të rasteve të reja të korrupsionit apo shtrirjen e hetimeve në rastet ekzistuese (MAESTRO, PETZVJEDICA, GRUNTOVEC, etj.). Ndryshimet në Rregulloren e Gjykatës kanë siguruar një veprim më të përshpejtuar të rasteve të korrupsionit, që do të thotë në fillimin e gjykimeve kryesore.

## Zbatimi i ligjeve dhe efektet e arritura në praktikë

Sipas informacioneve në dispozicion të mediave<sup>8</sup> ZNKKO ka ngrirë pasuri në vlerë prej 43 milionë HRK<sup>9</sup> në rastet e korrupsionit dhe ngriu 86,000 EUR në rastet e lidhura me krimin e organizuar në vitin 2010. Në total 33 milionë HRK dhe 106,000 EUR ishin konfiskuar, nga të cilat 4 milionë HRK ishin të lidhur me rastet e korrupsionit dhe pasuritë e mbetura ishin konfiskuar në lidhje me rastet e krimit të organizuar.

Në mes të 1 nëntorit 2007 dhe 1 nëntorit 2008, ZNKKO-ja mori raporte për 855 persona në lidhje me shkelje për korrupsion. Kërkesat për hetime ishin regjistruar kundër 226 personave. Gjithsejtë, 75 persona ishin dënuar. Gjashtëdhjetë e tri gjykime ishin bërë nga të cilat 53 ishin dënime. Apelimet ishin regjistruar në rastet të cilat ishin refuzuar apo për ato të cilat përfunduan me një shfajësim. Bashkëpunimi në mes të departamenteve ishte fuqizuar me nënshkrimin e një marrëveshje në mes të Drejtoratit të Përgjithshëm të Policisë dhe ZNKKO për shkëmbim reciprok të informacioneve. Përveç kësaj, marrëveshje të ngjashme janë duke u zbatuar në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ZNKKO, dhe në mes të Administratës Tatimore dhe ZNKKO. Bashkëpunimi i organeve shtetërore është siguruar përmes dispozitave të Aktit të Procedurës Penale, i cili i cakton rolet kryesore në bërjen e hetimeve të prokurorit, p.sh. ZNKKO, mbi urdhrat e të cilëve veprojnë edhe organet tjera shtetërore<sup>10</sup>.

<sup>8</sup> <http://www.tportal.hr/vijesti/hrvatska/124804/USKOK-je-korumpiranim-politicarima-lani-blokirao-44-mil-kuna.html>

<sup>9</sup> HRK – Vlera monetare e Kroacise (Hravatska Kruna)

<sup>10</sup> Programi Kombëtar për Aderimin e Republikës së Kroacisë në Bashkimin Evropian – 2009, f. 43.

Në vitin 2009 (raporti më i ri në dispozicion) ZNKKO pranoi raporte për 1,118 persona në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar, nga të cilat 215 ishin në lidhje me krimin e organizuar (p.sh. 19.2%)<sup>11</sup>. Në të njëjtin vit gjykatat caktuan 242 verdikte për krime të lidhura me krimin e organizuar - 228 (p.sh. 94.2%) e të cilëve ishin shpallur fajtor.

Struktura e akteve kriminale të raportuara është si vijon: 80 persona ishin raportuar për vepra kriminale për "bashkëveprim me qëllim të kryerjes së veprave penale" (Neni 333 i Aktit Penal), derisa të tjerët ishin raportuar për kryerjen e krimeve tjera si pjesë e grupit apo bashkëveprimit kriminal. Në të njëjtën periudhë 14 persona ishin raportuar për organizimin e krimit të organizuar dhe vetëm 4 persona ishin raportuar si pjesëtar të grupeve të tilla<sup>12</sup>. Ndonëse edhe kjo mund të duket surprizë në fillim, pasi dikush mund të pres më tepër raportime për anëtarët e organizatave kriminale se sa për organizatorët, USKOK-u raporton se kjo gjë më tepër ka të bëjë me natyrën ndërkuftare të këtyre grupeve, me anëtarë që vijnë nga vende të ndryshme dhe policia i ka fokusuar përpjekjet në identifikimin e organizatorëve. Grupet kriminale është zbuluar se kanë qenë të organizuar kryesisht me të njëjtat qëllime si edhe në vitet paraprake - trafikimi i narkotikëve, trafikimi me qenie njerëzore dhe shmangien e kontrolleve kufitare, por edhe involvimi në krimin ekonomik.

Mbetet të shikohet se si do të ndikoj legjislacioni i ri në luftimin e krimit të organizuar. Ka pasur disa tregues se ndikimi i Aktit mund të pengohet nga fakti se Qeveria dështoi ta siguroj si të gjitha burimet e nevojshme për zbatim të suksesshëm të Aktit të ri Penal. Më saktësisht, në Raportin mbi Punën e Zyrës së Prokurorit të Shtetit<sup>13</sup> të dorëzuar në Parlament thuhet se "mungon hapësira, pajisjet dhe burimet njerëzore", çka tregon se Zyra e Prokurorit të Shtetit mund të ballafaqohet me probleme në zbatimin e Aktit të ri.

## Rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010

Raporti i Progresit i KE 2010 për Kroacinë, përmend krimin e organizuar në disa raste: kur flitet për lirinë e shprehjes, vërehet se "ka pasur progres të kufizuar në hetimin e kërcënimeve kundër gazetarëve që punojnë në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, me një përjashtim të dukshëm për një rast të një vrasje të mirënjohur"<sup>14</sup>. Raporti gjithashtu vëren se është bërë progres për rregullimin e çështjeve kufitare dhe se Kroacia ka kontribuar në progresin e luftimit të krimit të organizuar në rajon, inter alia përmes ndryshimeve në kushtetutën e saj e cila lejon ekstradimin e banorëve të saj. Më saktë, seksionet mbi marrëdhëniet bilaterale me Malin e Zi dhe Serbinë nënvizojnë nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për ekstradim të cilat mundësojnë që vendet të ekstradojnë banorët e tyre tek njëri tjetri për procese penal apo fuqizimin e dënimeve me burgim në rast të krimit të organizuar apo korrupsionit.

<sup>11</sup> Raporti mbi Punën e Zyrës së Prokurorit të Shtetit në 2009, qershor 2010., f. 37

<sup>12</sup> Ibid., f. 36

<sup>13</sup> Ibid., f. 6-7

<sup>14</sup> Raporti i Progresit i KE 2010, f. 11

Raporti i Progresit pranon se „korniza ligjore për luftimin e korrupsionit është përmirësuar edhe më tej. Ndryshimet për Aktin ZNKKO e përforcojnë mbajtjen e rasteve për ZNKKO të rasteve të mashtrimeve me taksat, të krimit të organizuar dhe korrupsionit<sup>15</sup>” dhe „ka pasur progres të mirë me zbatimin e Kodit të ri të Procedurës Penale, “zbatimi për rastet e krimit të organizuar dhe rasteve të korrupsionit që nga 2009, ka përshpejtuar fazat e hetimit, me një bashkëpunim më të mirë në mes të policisë dhe shërbimeve të prokurorisë që ka quar në më shumë dënime.” Gjithashtu vërehet progres në luftën kundër krimit të organizuar: „Zyra Kombëtare e Policisë për Frenimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (ZKPFKKO) ka qenë plotësisht operacionale që nga shtatori i vitit 2009. Katër departamente operative regjionale kanë filluar punën. Rastet e profilit të lartë të krimit të organizuar ishin hetuar shpejt. Ministria e Punëve të Brendshme ka përpiluar një vlerësim për kërcënimin nga krimi i organizuar (OCTA) për 2009, bazuar në modelin e inteligjencës së krimit. Ministria, në bashkëpunim me Zyrën për Frenimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (ZNKKO), ka përpiluar një Plan për Prioritetet në Frenimin e Krimit të Organizuar dhe ka filluar zbatimin e tij. ZNKKO ka qenë aktiv në hetimin e rasteve të profilit të lartë të krimit të organizuar. Megjithatë, përpjekje të mëtejme janë të nevojshme për këtë fushë, veçanërisht sa i përket përdorimit të kornizës së re legjislative dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në praktikë. Një marrëveshje për krijimin e një zyre rajonale për përmirësimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar ishte nënshkruar në tetor të 2010 me Shqipërinë, Bosnje e Hercegovinën, Malin e Zi, Serbinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”<sup>16</sup>.

Raporti është kritik për Kroacinë duke theksuar se „ka tani rreth 200 raste të pazgjidhura në katër dhomat e specializuara të ZNKKO në Gjykatat e Qarqeve. 54 gjykatës që janë duke punuar në këto dhoma të specializuara nuk janë liruar nga detyrat e tyre paraprake. Përgatitjet për fuqizimin e kodit të ri për të gjitha rastet kriminale nga 2011 janë në vazhdim. Procedurat e reja ofrojnë afate më të kufizuara për intervistimin e të dyshuarve, çka kërkon burime të reja në polici”. Raporti bën thirrje për më tepër rezultate në hetimin dhe ndjekjen e krimeve të lidhura me drogën, duke tërhequr vëmendjen se Kroacia mbetet një nga rrugët kryesore të trafikimit të drogës për në BE dhe se nuk mund të raportohet asnjë progres në bashkëpunimin e doganave.

Progres përmbajtësor ishte bërë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe kriminale, sidomos me ndryshimet në kornizën ligjore e cila do të mundësojë zbatimin e fletë arrestimeve evropiane me efekt në aderim dhe me nënshkrimin e një marrëveshje për ekstradim me Serbinë. Progresi gjithashtu vazhdoi në politikat kundër narkotikëve, por rezultatet në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të drogës nevojitet të shtohet”<sup>17</sup>.

Raporti njih 'progres të kufizuar' në fushën kundër pastrimit të parave, veçanërisht në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të pastrimit të parave, dhe 'ca progres' në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Megjithatë, ai kërkon vëmendje që „bashkëpunimi rajonal në parandalimin dhe identifikimin e viktimave të trafikimit me njerëz ka nevojë që të intensifikohet”<sup>18</sup>.

<sup>15</sup> Po aty, f. 50

<sup>16</sup> Po aty, f. 56

<sup>17</sup> Ibid. f. 58

<sup>18</sup> Ibid. f. 56



Raporti gjithashtu tregon për progres në luftën kundër terrorizmit, gjithashtu luftën kundër drogave, por paralajmëron se policia e ka shënjuar aktivitetin e saj mbi grupet e organizuara kriminale më tepër se tek shitësit e vegjël të rrugëve. Gjithashtu është nënvizuar që „involvimi i grupeve të krimit të organizuar në shkeljen e DPI (e drejta e pronës intelektuale) është duke u rritur”, dhe se “shkeljet e pronës intelektuale janë një shqetësim në rritje për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve”, derisa njohuritë e publikut për këto tema mbeten të vogla.

### **Roli i Shoqërisë Civile në luftën kundër krimit të organizuar dhe pa-surisë së fituar në mënyrë të paligjshme**

Lufta efikase kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit shpesh duhet të mbështetet në gatishmërinë e qytetarëve për të bashkëpunuar për fuqizimin e ligjit. Prandaj është e nevojshme të ndërtohet besimi i publikut për institucionet dhe kjo kërkon demon-strimin e gatishmërisë politike dhe rezultate të prekshme për reformat e suksesshme politike. Të dy institucionet dhe udhëheqësit e tyre duhet të tregojnë shembuj të mirë duke adoptuar standarde të larta etike, duke vendosur procedura strikte dhe të trajto-hen në mënyrë të duhur rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në shumë vende kjo ishte lehtësuar me asistencën dhe mbështetjen e aktorëve të shoqërisë civile siç janë shoqatat e avokatëve dhe shkollat e drejtësisë. Praktikrat e mira të përdorura në vende të ndryshme përfshijnë themelimin e organeve të shoqërisë civile të përbëra nga një panel i gjykatësve dhe anëtarëve të tjerë të publikut të cilët veprojnë si “vëzhgues të gjykatës” në rastet që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionit në sek-torin publik. Kjo praktikë është treguar e suksesshme në ngritjen e legjitimitetit të gjyqë-sorit në vende të tilla si Kosta Rika, Italia dhe Shtetet e Bashkuara<sup>19</sup>.

OSHC-të gjithashtu mund të luajnë një rol në mbështetje të viktimave dhe dëshmi-tarëve në raportimin e rasteve të tyre.

<sup>19</sup> Buscaglia, Edgardo and van Dijk, Jan: Controlling Organized Crime And Corruption In The Public Sector, p. 28.

## Përfundime

18

Asnjë hulumtim aktualisht nuk është duke u zhvilluar për krimin e organizuar në Republikën e Kroacisë dhe vlerësimi për nivelin dhe statusin e krimit të organizuar mund të bazohet mbi analizimin e të dhënave të mbledhura nga policia gjatë punës operative, raportet e lëshuara nga Zyra e Prokurorit të Shtetit, Zyra për Frenimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, gjithashtu raportet e ndryshme të përgatitura përgjatë viteve nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare (të tilla si Raporti i UNODC apo Letra e Bardhë e lëshuar nga Shoqata Kroate e Gazetarëve Hulumtues), dhe mbulimi i medieve për këto çështje. Më konkretisht, korniza ligjore për frenimin e krimit të organizuar po përmirësohet çdo here e më shumë dhe institucionet po përmirësojnë kapacitetet e tyre për tu marrë me krimin e organizuar. Pritet që Akti i ri Penal do të mundësoj procese më të shpejta për kriminelët dhe do ta bëjë më të vështirë për ta që ta shmangin dënimin për shkak të gjykimeve të vjetruara.



**Bulgari**

## Vlerësimi mbi nivelin e krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme

Vlerësimi i krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme në Bullgari mund të bëhet bazuar në raportet e dy organizatave të mëdha bullgare - "Qendra për Studimin e Demokracisë (QSD)" dhe "Monitori (Vëzhguesi) i Rrezikut". Themeluar nga fundi i 1989, "Qendra për Studimin e Demokracisë (QSD)" është institut interdisciplinar i politikave publike i përkushtuar ndaj vlerave të demokracisë dhe ekonomisë së tregut. "Monitori i Rrezikut" është institut jo-fitimprurës, joqeveritar i politikave publike që punon për zvogëlimin, kontrollin dhe parandalimin e krimit të organizuar korrupsionit të nivelit të lartë politik dhe institucional. Këto organizata identifikojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin institucional si procese publike të rrezikut të lartë dhe si kërcënim i sistemit politikë, demokratik dhe liberal, institucionet e tij publike si dhe zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë së hapur në kontekstin e pas tranzicionit.

Raporti i fundit i paraqitur për këtë temë ishte nga "QSD" - **Përmbledhje Politikash Nr. 26 nga nëntori 2010** - i titulluar "Krimi i Organizuar dhe Korrupsioni: Karakteristikat Kombëtare dhe Politikat e Shteteve Anëtare të BE-së". Ky përmban përfundimet kryesore dhe rekomandimet e bazuara në informatat e mbledhura gjatë një studimi, i cili ishte kryer për QSD-në nga Drejtorati i Përgjithshëm i Çështjeve të Brendshme i BE-së. QSD-ja u desh t'i analizojë lidhjet ndërmjet krimit të organizuar dhe korrupsionit. Dëshmia kryesore për raportin vjen nga 156 intervistat e gjysëm-strukturuara të kryera në 27 shtetet anëtare. Pikëpamjet e konsultuara përfshijnë ato të organeve kundër korrupsionit, zbatimit të ligjeve, gjyqësisë, sektorit privat (avokatëve, auditorëve, dhe hetuesve të mashtrimit), akademikëve dhe gazetarëve. Janë ndërmarrë studime të thella në gjashtë (6) vende (Bullgari, Francë, Greqi, Itali, Holandë, dhe Spanjë) bazuar në numrin e madh të intervistave ballë për ballë dhe burimeve dytësore më gjithëpërfshirëse.

### Pikat kryesore:

- Bazuar në analizat statistikore të 14 treguesve (matja e korrupsionit, krimi i organizuar, efektiviteti i qeverisë, treguesit makro-ekonomikë, dhe ekonomia e hirtë) kanë dalë shtatë grupe të vendeve. Bullgaria, bashkë me Poloninë dhe Rumaninë, është në grupin e fundit, i cili përfshin vendet ku krimi i organizuar e përdor korrupsionin në mënyrë më aktive dhe ku lufta është më e dobët.
- Raporti përfundon se tregjet e prostitucionit dhe drogave të paligjshme ushtrojnë efektin më korruptues në BE.
- Korrupsioni politik është mjeti (vegla) më i fuqishëm i krimit të organizuar.
- Korrupsioni administrativ dhe politik i nivelit lokal është vëzhguar më së shpeshti në BE. Shembuj të kryetarëve ose kuvendarëve të komunave të dënuar për lidhje me krimin e organizuar dhe krimet e jakës së bardhë janë gjetur në BE, përfshirë Bullgarinë.
- Rastet studimore në Bullgari, Francë, dhe Greqi treguan se veprimtaria kundër korrupsionit dhe dukshmëria publike e korrupsionit politik janë veçanërisht të forta kur ndryshojnë qeveritë.

- Policia është më së shumti e ekspozuar dhe ka kontakte më të shpeshta me krimin e organizuar dhe, si e tillë, krimi i organizuar i shënjestron ata më së shpeshti.
- Korrupsioni i zyrtarëve doganorë kryesisht e ndihmon krimin e organizuar t'i shmangë mallrat e kontrabanduara, t'i shmangë hetimet (kur doganat kanë kompetenca hetuese) ose ta lehtësojnë përkushtimin/nivelin e mashtrimeve doganore (zvogëlimi i taksave doganore/importuese). Veçanërisht është e lidhur me kontrabandimin e mallrave me akcizë: cigaret, karburantet dhe prodhimet e tyre, dhe alkoolin.
- Të dhëna lidhur me korrupsionin e sektorit privat nga krimi i organizuar përgjithësisht nuk kanë qenë në dispozicion, meqë shumica e vendeve nuk mbledhin të dhëna të tilla. Raporti ka ofruar një listë të gjatë të praktikave korruptive të lidhura me prodhimin, furnizimin, dhe trafikimin e mallrave ilegale. Për shembull shitësit e automjeteve në Bullgari që shesin automjete të vjedhura.
- Në Bullgari kufiri ndërmjet ekonomive ligjore dhe joligjore është më pak i qartë sesa në shumicën e shteteve anëtare të BE-së. Krimi i organizuar që prodhon pasurim nga drogat, kontrabandimi dhe prostitucioni, është përzier me korporatat dhe grupet që zotërojnë asetet e privatizuara nga shteti dhe ka transformuar pasurinë e grumbulluar në fuqi politike dhe administrative.
- Rrjetet e krimit të organizuar janë infiltruar në shumicën e institucioneve publike, përfshirë policinë, doganat dhe prokuroritë. Krimi i organizuar ndikon shumë në elitën politike dhe partitë politike në nivelin lokal, ndërsa disa struktura kriminale kanë qenë të afta të ndikojnë edhe në anëtarë parlamenti ose politikanë të nivelit shtetëror.

QSD-ja i kushton vëmendje të veçantë pastrimit të parave si pjesë e madhe e krimit të organizuar, duke e shqyrtuar këtë problem në një raport të veçantë – **Përmbledhje Politikash Nr. 21 nga shkurti 2010** – Hetimi i Pastrimit të Parave: qasje institucionale". Aty vërehet se hulumtimi më i fundit nga QSD zbulon se të ardhurat vjetore nga veprimtaria e organizuar kriminale dhe korrupsioni vlerësohet në më shumë se 4-5 miliardë BGN në vit. Veç kësaj, tregu në rritje i paluajtshmërive në Bullgari ka bërë vendin destinacion tërheqës për pastrimin e shumave të mëdha nga të ardhurat e paligjshme nga Evropa dhe kontinentet tjera. Krimi i organizuar në Bullgari i përshtatet shpejtë realiteteve të reja dhe në masë të madhe hyn në ekonominë e ligjshme duke legalizuar kapitalin e mbledhur nga veprimtaria kriminale. Në Bullgari pastrimi i parave merr formë të veçantë: 'investim politik'. Konfigurimet kriminale dhe oligarkike në vend pastrojnë para nga veprimtaritë e paligjshme duke i blerë votat ose duke sponsoruar partitë politike. Si rezultat, ky tip i veçantë i pastrimit të parave korrupton bazat e demokracisë së vendit – sistemin e tij politik.

Një raport nga Monitori i Rrezikut nga 2011, titulluar "Konfiskimi civil në Bullgari (2005-2010), përmbledhë rezultatet e hulumtimit të kryer nga Fondacioni që ka monitoruar veprimtarinë e Komisionit të pronës së fituar paligjshëm (organ i specializuar shtetëror). Objekti i monitorimit është të identifikohen aspektet pozitive dhe negative të veprimtarisë së Komisionit gjatë pesë viteve (2005-2010) për punën e tij. Mund të identifikohen përfundimet e mëposhtme:

- Komisioni ka vështirësi serioze sipas burimeve të sigurisë. Një nga ato është intensiteti i lartë i qarkullimit të stafit, e cila seriozisht e përçan punën e Komisionit. Ai përballet me mungesë të burimeve financiare, veçanërisht gjatë viteve të kufizimeve

financiare lidhur me krizën ekonomike. Vetë në Komision ka mungesë të sistemit adekuat për procedimin e sasisë së madhe të informative, e cila është pasojë e fakteve të lartpërmendur. Prania e këtyre parakushteve logjikisht shkakton pasoja më të dëmshme. Pasojat më domethënëse janë:

- Mungesa e metodologjisë uniforme për vlerësimin e aseteve të hetuara dhe varësinë e tepërt të Komisionit në ekspertët e brendshëm për përgatitjen e vlerësimeve;
- Puna e Komisionit gjatë pesë vjetëve të fundit vështirësohet nga praktika e parregullt gjyqësore, e cila kryesisht është e orientuar në hulumtimin e lidhjes shkakësore ndërmjet krimit dhe aseteve të fituara paligjshëm;
- Menaxhimi joefektiv i pronës së konfiskuar. Gjatë procedurave ligjore kjo pronë shpesh, me ose pa qëllim, dëmtohet. Kjo është arsyeja se pse më vonë kjo pronë nuk mund të shitet ose përdoret;
- Mungesa e kontrollit publik për punën e Komisionit po ashtu krijon probleme. Komisioni përbëhet nga pesë njerëz të cilët zgjedhën sipas bazës së kuotës nga përfaqësuesit e Këshillit Kombëtar, Kryeministrit dhe Presidentit sipas përpjesëtimit 3:1:1. Përfaqësuesi i Kryeministrit gjithmonë është kryesues. Ky model i përbërjes përfshin llogaridhënien e dobët, varësinë e tepërt në Kryeministrin, dhe mungesën e llogaridhënies dhe, në fund, efikasitetin e ulët.

## Baza ligjore dhe ndarja e përgjegjësive për institucionet

Legjislacioni kundër krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, në Republikën e Bullgarisë rregullohet me disa ligje. **Neni 93, P. 20** i Kodit Penal përmban përkufizimin ligjor për "grupin e organizuar kriminal". Grupi i organizuar kriminal është grup i strukturuar i tre ose më shumë personave për t'u këshilluar në ose jashtë shtetit, e i cili përcakton dënim me burgim prej më shumë se tri vjet. Shoqata krijohet pa ndonjë ndarje formale të funksioneve ndërmjet pjesëmarrësve, kohëzgjatjes së anëtarësisë ose strukturës së zhvilluar. **Neni 321** i Kodit Penal përkufizon dënimin për ndonjë person "i cili formon ose udhëheqë një grup të organizuar kriminal ose merr pjesë në një grup të tillë". Në **Nenin 321a** është rregulluar dënimi për ndonjë person i cili merr pjesë në udhëheqjen e organizatës ose grupit i cili, duke përdorur forcë ose ngjallë frikë, kryen veprime ose krijon përfitime.

Neni 321 (1) (plotësuar SG 92/02) "Kushdo që formon ose udhëheqë grup të organizuar kriminal do të dënohet me burgim nga tri gjer në dhjetë vjet". Po ashtu ky Kod parashihet që: Kush merr pjesë në grupin e tillë do të dënohet me burgim nga një gjer në gjashtë vjet.

Po ashtu dispozitat e këtij Kodi parashohin se nëse grupi është i armatosur ose i formuar për qëllime të përfitimit ose për qëllime të kryerjes së krimeve sipas neneve 142, 142a, 143a, 243, 244, 253, 280, 337, 339, paragrafët 1 - 4, 354a, paragrafët 1 dhe 2 dhe neni 354b, Paragrafët 1 - 4 ose një zyrtar merr pjesë në të, dënimi do të jetë: (Sipas Paragrafit 1) - burgim nga pesë deri pesëmbëdhjetë vjet; dhe (sipas Paragrafit 2) - burgim nga tri deri në dhjetë vjet.

Dispozitat po ashtu kanë përcaktuar që, nuk do të dënohet pjesëmarrësi në grup i cili vullnetarisht u dorëzohet organeve zyrtare dhe zbulon gjithçka që di rreth grupit, para se krimi të kryhet nga ai apo grupi.

**Neni 321a** (e re, SG 62/97) (1) Kushdo që merr pjesë në udhëheqjen e organizatës ose grupit i cili, duke përdorur forcë ose ngjallë frikë, kryen veprime ose krijon përfitime, do të dënohet me burgim nga tri deri tetë vjet.

Përveç këtyre hipotezave në Kodin Penal gjithashtu ka raste të cilësuar të kryera nga ose në emër të një grupi të organizuar. Për shembull Neni 116 – vrasja; Neni 131 – shkaktimi i lëndimit trupor; Neni 142 p. 2 – kidnapimi; Neni 155 p. 5 – nxitja e personit tjetër për prostitucion ose pronësia e shtëpisë publike për prostitucion; Neni 156 p. 3 – rrëmbimi i personit tjetër me qëllim të orgjisë; Neni 159 p. 5 – shpërndarja e materialeve pornografike; Neni 199 – grabitja, etj.

Në Bullgari ekziston gjykata e specializuar penale nën juridiksionin e së cilës janë rastet e veprave penale të referuara në nenet 321 dhe 321a të Kodit Penal. Kompetencat e saj dhe statusi rregullohen në **Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin e Gjyqësisë**.

Pjesë e legjislacionit që e rregullon këtë fushë është edhe **Ligji i Gjyqësisë i cili në nenin 100a - 100f**, rregullon strukturën dhe statutin e kodit të specializuar penal. Gjykata e specializuar penale është e barabartë me gjykatën rajonale dhe e vendosur në Sofje. Ajo përbëhet nga gjyqtarë dhe udhëhiqet nga kryesuesi. Gjykata e specializuar penale përbëhet nga panele prej një gjyqtari dhe dy anëtarë jurie, përveç nëse caktohet ndryshe në ndonjë ligj. Panelet e gjykatës caktohen nga gjyqtari më i vjetër në pozitë ose rang. Kryesuesi i gjykatës së specializuar penale ka kompetenca të kryesuesit të gjykatës rajonale.

**Kodi i Procedurës Penale** në neni 411a – 411f parasheh rregullat e veçanta për t'u marrë me rastet sipas juridiksionit të gjykatave të specializuara penale. Gjykata e specializuar penale ka juridiksion në rastet e krimeve sipas Nenit 321 dhe 321a të Kodi Penal (krimet e kryera nga grupi i organizuar kriminal). Gjykata e specializuar penale po ashtu ka juridiksion në rastet e krimeve të paraqitura detajisht në Nenin 411a p. 2. Gjykata e specializuar penale gjithashtu ka juridiksion në rastet e krimeve të lartpërmendura të cilat janë kryer jashtë shtetit. Në këto raste kur disa akuza janë ngritur kundër të njëjtit person, njëra nga të cilat bie nën juridiksionin e Gjykatës së Specializuar Penale, rasti do të jetë nën kompetencën e gjykatës në fjalë për të gjitha akuzat. Kur dy ose më shumë raste lidhur me krime të ndryshme kundër personave të ndryshëm ndërliidhen, ato bashkohen nëse kjo kërkohet nga shqyrtimi i duhur i secilës prej tyre. Nëse ndonjëri nga rastet e ndërliidhur bie nën juridiksionin e Gjykatës së Specializuar Penale, kjo e fundit ka kompetencë gjyqësore për t'u marrë me rastin e bashkuar. Kur rasti bie nën juridiksionin e Gjykatës së Specializuar Penale si dhe atë të gjykatës ushtarake, gjykata ushtarake merret me rastin. Rastet e zgjidhura nga Gjykata e Specializuar Penale shqyrtohen nga Gjykata e Specializuar e Apelit si gjykatë e shkallës së apelit, dhe shqyrtohen nga Gjykata Supreme e Kasacionit si gjykatë e shkallës së kasacionit, e cila po ashtu i shqyrton kërkesat për rikthim të rasteve në Gjykatën e Specializuar Penale.

Sa i përket rasteve nën juridiksionin e Gjykatës së Specializuar Penale, autoritete

paragjyqësore janë prokurori publik i Prokurorisë së Specializuar Publike dhe autoritetet hetuese. Autoritete hetuese lidhur me juridiksionin e Gjykatës së Specializuar Penale janë hetuesit e Departamentit të Hetimeve të Prokurorisë së Specializuar Publike si dhe policët hetues të caktuar me urdhër të Ministrit të Brendshëm. Prokurori publik ushtron kompetencat e tij brenda 15 ditësh nga marrja e dosjes së rastit.

Pjesëmarrësit në procedurën gjyqësore obligohen të paraqiten në seancë të rastit pa marrë parasysh nëse janë ftuar nga ndonjë gjykatë tjetër ose autoritet paragjyqësor. Në rastet kur dëshmitari ose eksperti nuk paraqitet në gjykatë pa ndonjë shkak serioz ai, nëse është e nevojshme, sillet me forcë në datën tjetër të seancës, ashtu si caktohet nga gjykata.

**Ligji për Ministrinë e Brendshme** - vendos parimet, detyrat, veprimtarinë, strukturën, dhe menaxhimin e Ministrisë së Brendshme (MB) si dhe statusin e të punësuarve në të. Pjesë e strukturës themelore të MB-së është edhe Drejtorati i Përgjithshëm i "Luftimit të Krimit të Organizuar" i cili është strukturë kombëtare e specializuar operative hetuese e MB-së për parandalimin, neutralizimin, hetimin dhe zbulimin e veprimtarisë së organizuar kriminale të strukturave kriminale vendore dhe ndërkombëtare, lidhur me: regjimin e doganave, sistemin monetar, të taksave, dhe të sigurimeve; substancat narkotike, krimeve kompjuterike; pronësisë intelektuale; falsifikimi i parave, instrumenteve të pagesave dhe dokumenteve zyrtare; trafikimi i njerëzve; korrupsioni në organet shtetërore etj.

Për zbatimin e detyrave sipas ligjit, Drejtorati i Përgjithshëm i "Luftimit të Krimit të Organizuar" pavarësisht ose në bashkëpunim me organe tjera të specializuara kryen operacione për parandalimin, neutralizimin, hetimin dhe zbulimin e krimeve të kryera nga strukturat kriminale; pjesëmarrja në veprimtari e operacione hetuese për zbulimin e veprimtarisë kriminale të strukturave kriminale në të gjithë vendin; ofrimi dhe zbatimi i infiltrimit strategjik dhe kryerja e ujdive të fshehta përmes nëpunësve të fshehtë; kryerja e furnizimeve të kontrolluara; mbledhja, procedimi, ruajtja, analizimi, dhe ofrimi i informative për situatën, strukturën dhe dinamikën e krimit të organizuar në të gjithë vendin; studimi dhe vlerësimi i metodave të veprimeve taktike policore që zbatohen për luftimin e krimit të organizuar, dhe përgatitja e propozimeve për përmirësimin e punës; ofrimi i trajnimit për nëpunësit e njësisë së saj territorial për zgjerimin e kualifikimeve të tyre profesionale; identifikimi i individëve, duke ndjekur procedurat e përcaktuara nga Ministria e Brendshme; lëshimi i mendimeve për projektet legjislative ose aktet tjera që rregullojnë luftimin e krimit të organizuar dhe përfshirja në përgatitjen e programeve dhe strategjive; pjesëmarrja në ekipe të ngritura me organet tjera shtetërore, administratën dhe autoritetet e shtetit dhe organizatat ndërkombëtare;

Organet policore janë organe të Drejtoratit të Përgjithshëm të "Luftimit të Krimit të Organizuar". Organet policore vëzhgojnë, themelojnë dhe kontrollojnë vendet dhe personat për të cilët ka informata se përgatisin, kryejnë ose kanë kryer krime, përfshijnë rastet e veprimtarisë së organizuar kriminale të grupeve ose organizatave vendore ose ndërkombëtare (Neni 82 i Ligjit të Ministrisë së Brendshme).

Statuti dhe kompetenca e Drejtoratit të Përgjithshëm të "Luftimit të Krimit të Organizuar" gjithashtu rregullohen në Rregulloren për zbatimin e Ligjit të Ministrisë së



Brendshme, ku përsëri shënohen struktura dhe veprimtaria e tij në mënyrë të detajuar.

Që nga marsi 2005 në Bullgari gjithashtu ekziston ligji i veçantë që rregullon fushën e asetëve të fituara paligjshëm – **Ligji për marrjen në dobi të shtetit të pronës së fituar nga veprimtaria penale**. Sipas kapitullit 1 “ky ligj ofron kushtet dhe rendin për vendosjen e masave të sigurisë dhe marrjen në dobi të shtetit të pronës së fituar drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga veprimtaria kriminale. Prona, e fituar drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga veprimtaria kriminale, e cila nuk i është kthyer të dëmtuarit ose nuk është marrë në dobi të shtetit ose nuk është konfiskuar sipas ligjeve, do t’i nënshtrohet marrjes sipas kërkesave të këtij ligji. Objektivat e këtij ligji janë parandalimi dhe kufizimi i mundësive për rrjedhjen e përfitimeve nga veprimtaria kriminale si dhe parandalimi i disponueshmërisë me pronën e fituar nga veprimtaria kriminale”.

Ligji rregullon statutin dhe veprimtarinë e organeve për vërtetimin e pronës së fituar nga veprimtaria kriminale (Komisioni për vërtetimin e pronës së fituar nga veprimtaria kriminale). Komisioni është organ i specializuar shtetëror për vërtetimin e pronës së fituar nga veprimtaria kriminale (Neni 12). Komisioni është organ korporativ me qendër në Sofje, administrator parësor me burime buxhetore. Komisioni është organ kolegjal i përbërë nga pesë anëtarë, përfshirë kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin. Kryesuesi i Komisionit emërohet nga Kryeministri, zëvendëskryesuesi dhe dy anëtarë zgjedhën nga Kuvendi Kombëtar dhe një anëtar emërohet nga Presidenti i Republikës. Anëtarët e Komisionit emërohen, përkatësisht zgjedhën, për mandat 5 vjeçar me të drejtë prej jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme. Anëtarët e Komisionit ligjërisht duhet të jenë shtetas bullgarë e të cilët nuk janë dënuar për vepra të qëllimshme penale, kanë arsimim të lartë juridik ose ekonomik dhe së paku 5 vjet praktikë në lëmin përkatëse.

Ky ligj rregullon procedurat që do të ndiqen, kur mendohet se personi i caktuar ka fituar pronë ose vlerë domethënëse për të cilën ekziston supozimi i bazuar se ajo është fituar nga veprimtaria kriminale, dhe kundër të cilit ka filluar ndjekja penale sipas Kodit Penal. Lloje të ndryshme të krimeve paraqiten në detaje në Nenin 3 p.1, P 1. Procedurat po ashtu zhvillohen kur ka të dhëna të mjaftueshme për dyshimin e bazuar se pronë e vlerës domethënëse është fituar nga veprimtaria kriminale, por:

1. Procedura penale ka filluar ose procedura e filluar ka mbaruar meqë personi ka vdekur, ose
2. Procedura penale nuk ka filluar ose procedura e filluar ka mbaruar meqë pas kryerjes së krimit personi ka rënë në çrregullim të fortë mendor, duke përjashtuar gjendjen normale ose amnistinë.

Me urdhër të ligjit hiqet prona e fituar gjatë periudhës së hetimeve ndaj personave për të cilët ka bazë sipas nenit 3 dhe në rastin konkret mund të ketë dyshim të bazuar se prona e fituar është e lidhur me veprimtarinë kriminale të personave përderisa nuk është vendosur burimi i ligjshëm (Neni 4 p. 1).

Të drejtat e shtetit sipas këtij ligji shuhet me kalimin e periudhës parashkruese prej 25 vitesh. Periudha e parashkrimit fillon nga data e fitimit të pronës (Neni 11).

Komisioni ka njësi territoriale të cilat kanë statusin e drejtorateve territoriale. Organet e Komisionit në procedurë të vendosjes së pronës së fituar nga veprimtaria kriminale janë drejtorët e drejtorateve territoriale dhe inspektorët në këto drejtorate.

Komisioni funksionon në bazë të ligjit dhe rregullores së vetë strukturore e cila përcakton veprimtarinë e tij, stafit, rajonet e veprimtarisë dhe organizimin e punës së drejtorateve territoriale. Ky Komision merr vendime për: vendosjen e procedurës për të provuarit e pronës së fituar nga veprimtaria kriminale; dërgimi në gjykatë i kërkesës për imponimin e masave të sigurisë; dërgimi në gjykatë i kërkesës së motivuar për marrjen në dobi të shtetit të pronës së fituar nga veprimtaria kriminale; emërimi i drejtorëve të drejtorateve territoriale dhe, sipas propozimit të tyre, përcakton inspektorët në to (Neni 13).

Gjatë zbatimit të kompetencave, Komisioni nxjerrë vendime të marra me shumicë të më shumë së gjysmës së anëtarëve. Komisioni përgatit çdo vit raport për veprimtarinë e tij dhe deri në fund të marsit të vitit vijues ia paraqet Kuvendit Kombëtar, Presidentit të republikës dhe Këshillit të Ministrave. Raporti është publik dhe botohet në faqen e internetit të Komisionit.

## Zbatimi i ligjeve dhe efektet e arritura në praktikë

Informata për zbatimin e ligjeve kundër krimit të organizuar dhe pasurisë së fituara në mënyrë të paligjshme dhe efektet e arritura në praktikë, mund të gjendet në raportet e "QSD"-së dhe "Monitorit të Rrezikut". Në këto raporte mund të gjejmë shembuj për zbatimin e keq të ligjeve, por gjithashtu edhe efektet e mira të arritura në praktikë. Në Përmbledhjen e Politikave Nr. 21 të QSD-së nga shkurti 2010 "Hetimi i pastrimit të parave: qasja institucionale" thuhet se "Pavarësisht nga disa nisma legjislative dhe numri në rritje i hetimeve për pastrimin e parave në dhjetëvjetëshin e fundit, përndjekja e këtij tipi të krimit në Bullgari mbetet e papeshë. Arsyet rreth kësaj mund të identifikohen lehtë. Kapaciteti i kufizuar i institucioneve të specializuara shtetërore është një problem. Moszbatimi i ligjeve përkatëse kundër pastrimit të parave (PP) është gjithashtu mjaft i dukshëm. Në të njëjtin raport ekziston përshkrimi i detajuar i Doracakut për Hetimin e Pastrimit të Parave, i sapo hartuar. Qëllimi kryesor i këtij doracaku është që të ndihmohen prokurorët dhe hetuesit policorë të cilët hetojnë krimin e organizuar, por nuk kanë ndjekur trajnim të specializuar për hetimin e pastrimit të parave. Zhvillimi i doracakut solli njohuritë dhe përvojën e të gjitha institucioneve përkatëse që punojnë lidhur me pastrimin e parave, dhe është plotësuar me ekspertizën e mbledhur nga OJQ-të dhe sektorin privat. Përgatitja e Doracakut mblodhi ekspertizën e të gjitha institucioneve kryesore të përfshira në parandalimin e pastrimit të parave - Ministrinë e Brendshme, SANS, Shërbimin Hetues Kombëtar, Prokuroria Supreme e Kasacionit, dhe Komisioni për të Vërtetuarit e Pronës së Fituar nga Veprimtaria Kriminale.

Në Përmbledhjen e Politikave të po kësaj qendre -QSD në vitin 2009 - "**Krim pa Dënim: Luftimi i Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Bullgari**" është theksuar se reformat aktuale legjislative dhe institucionale në gjyqësi dhe organet ligj-zbatuese nuk kanë çuar në rezultatet e pritura dhe të shpresuara për zvogëlimin e dënimit për praktikat korruptive dhe krimin e organizuar në vend. Në anën tjetër, janë përmendur edhe

disa trende pozitive. Për shembull, korrupsioni administrativ në biznes ka rënë për 50% që nga hyrja e vendit në BE. Për më tepër, reformat aktuale legislative dhe administrative me synim për ta parandaluar konfliktin e interesit si dhe keqpërdorimet në ofrimin e koncesioneve, padyshim paraqesin hapa në drejtimin e duhur. Në fund, eliminimi i tregtisë pa dogana në kufijtë tokësorë të Bullgarisë në maj 2008 ka pasur efekte të konsiderueshme kundër korrupsionit, çka vërteton vullnetin e Qeverisë së Bullgarisë ta luftojë korrupsionin politik dhe krimin e organizuar.

Nga ana tjetër raporti i organizatës tjetër - **Monitorit të Rrezikut** i titulluar “**Konfiskimi Civil në Bullgari**” (2005-2010)- tregon aspektet pozitive dhe negative të veprimtarisë së Komisionit për pesë vite (2005-2010) të funksionimit të tij. Miratimi i ligjit të veçantë dhe krijimi i Komisionit për vërtetimin e pronës së fituar nga veprimtaria kriminale më 2005 shpejtë çoi në rritjen e numrit të procedurave ligjore për konfiskimin e pasurive të fituara paligjshëm. Gjatë dy viteve të para të veprimtarisë së tij, Komisioni ka dërguar në gjykata më shumë se 50% të rasteve sesa Prokuroria gjatë periudhës 1997-2005. Në anën tjetër, Komisioni ka vështirësi serioze sipas burimeve të sigurisë. Ato janë intensiteti i lartë i qarkullimit të stafit, mungesa e burimeve financiare, mungesa e sistemi adekuat për procedimin e sasisë së madhe të informatave. Prania e këtyre parakushteve logjiksht shkaktonte pasoja të dëmshme që pengojnë veprimtarinë e mirëfilltë të Komisionit në zbatimin e ligjit.

### **Roli i Shoqërisë Civile në luftën kundër krimin të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.**

Në Bullgari roli i shoqërisë civile në luftën kundër krimin të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, përgjithësisht është mjaft i vogël. Vetëm “QSD”-ja dhe “Monitori i Rrezikut” botojnë raporte periodike për këto tema dhe organizojnë konferenca e diskutime publike. Domethënë në raporte të këtyre dy organizatave mund të gjejmë informata për rolin e Shoqërisë Civile.

Për shembull QSD-ja, si organizatë e pavarur, ka nisur formimin e task forcës ndërmjet agjencive për ta hartuar Doracakun për Hetimin e Pastrimit të Parave, sepse pastrimi i parave është pjesë e madhe e problemit të përgjithshëm me krimin e organizuar. Siç është përmendur tashmë qëllimi kryesor i këtij Doracakut është të ndihmohen prokurorët dhe hetuesit policorë të cilët hetojnë krimin e organizuar, por nuk kanë ndjekur trajnim të specializuar për hetimin e pastrimit të parave. Ideja kryesore e Doracakut është të shpjegohen teknika dhe metoda të ndryshme për hetimet e PP-së. Hartimi i Doracakut u bazua në njohuritë dhe përvojën e të gjitha institucioneve përkatëse që punojnë lidhur me pastrimin e parave, dhe është plotësuar me ekspertizën e mbledhur në OJQ-të dhe sektorin privat. Kjo veprimtari është shenjë e pjesëmarrjes aktive të Shoqërisë Civile në luftën kundër krimin të organizuar.

Në anën tjetër raporti i QSD-së “**Krimi pa Dënim: Luftimi i Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Bullgari**” në 2009 thekson se Bullgaria ka shumë karakteristika të shtetit të pllakosur nga korrupsioni politik. Shenjat më të qarta janë: përpjekjet e pandërprera për zënien e OJQ-ve - një nga elementet më të rëndësishme të përgjegjë-

sisë së jashtme politike – duke krijuar kuazi OJQ ose duke i bashkuar OJQ-të ekzistuese në përpjekje për t'i zbutur zërat kritikë në shoqëri.

Element i ri në raport është analiza e sulmeve të praktikave korruptive në strukturat e shoqërisë civile (OJQ), të cilat tradicionalisht janë konsideruar më së paku të korruptuara në krahasim me sferat e tjera të veprimtarisë shoqërore-ekonomike në Bullgari. Për periudhën 2000 – 2007, numri i OJQ-ve është rritur pesë herë, meqë shumica e organizatave të reja janë themeluar nga zyrtarët e lartë shtetërorë si instrumente për gjoja të hyra krejt legjitime si mjete për krijimin e qarqeve të miqësive politike dhe personale, si dhe mbrojtje kundër humbjeve të fuqisë politike. Më shumë se  $\frac{3}{4}$  e anëtarëve të parlamentit dhe përpjesëtimi i njëjtë i ministrave dhe shefave të agjencive ekzekutive, dhe mbi 90% e kryetarëve të komunave në Bullgari përfaqësohen në bordet e drejtorëve të OJQ-ve.

Me tërheqjen e donatorëve të jashtëm publikë dhe privatë, qeveria bullgare është bërë faktor përcaktues në financimin e OJQ-ve në vend. Burimet financiare të kontrolluara nga Qeveria (qoftë përmes buxhetit ose fondeve të BE-së) të ndara për OJQ-të në 2008 përbëjnë afërsisht 40% të financimit të përgjithshëm të disponueshëm për 2006. Kështu të gjitha dobësitë dhe rreziqet e korrupsionit të lidhura me vendosjen strategjike të shënjestrave dhe prokurimit publik, po ashtu janë transferuar në këtë sektor.

## Përfundime

Në fund mund t'i nxjerrim përfundimet e mëposhtme. Legjislacioni kundër krimit të organizuar dhe pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme, rregullohet në detaje me disa ligje. Këto ligje po zgjerohen dhe përmirësohen vazhdimisht. Kompetencat e institucioneve që i luftojnë këto dukuri negative përcaktohen plotësisht dhe ekziston ndarje e qartë ndërmjet përgjegjësive dhe detyrimeve të tyre. Problemi është se ligjet nuk zbatohen mjaftueshëm në praktikë. Ka shumë arsye për këtë – mungesa e burimeve financiare dhe të tjera, mungesa e motivimit, numri i vogël i krimeve të zbuluara, etj. Në anën tjetër, çka edhe është vërejtur shumë herë në raporte e të dyja organizatave, korrupsioni në mesin e zyrtarëve dhe autoriteteve që luftojnë krimin e organizuar dhe pasurive të fituara paligjshëm, është i përhapur dhe ai ndikon në rezultatet përfundimtare. Po ashtu lufta joefektive kundër krimit të organizuar dhe pasurive të fituara paligjshëm duhet të theksohet edhe si problem i rolit të dobët të shoqërisë civile dhe pjesëmarrjes së saj të vogël në këtë luftë.

Identifikimi i problemeve dhe arsyeve për to është hapi i parë dhe më i rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe pasurive të fituara paligjshëm. Hapi tjetër është të gjendet zgjidhja e mundshme e këtyre problemeve. Dhe kjo fazë duhet të përfshijë të gjitha palët: Qeverinë, Parlamentin, autoritetet gjyqësore, shoqërinë civile etj.



Sloveni

## Vlerësimi mbi nivelin e krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme

### 1. Krimi i organizuar

Grupi punues sloven, i përbërë nga përfaqësues të Policisë dhe Ministrisë së Drejtësisë e ka definuar krimin e organizuar, si një aktivitet i planifikuar (me tendencën që të marr një të ardhur apo pushtetin për të implementuar një akt kriminal të një rëndësie të madhe) ku një apo më shumë koleg bashkëpunojnë gjatë një kohe të shkurtë apo të gjatë, dhe në këtë mënyrë ata e ndajnë punën:

- Duke përdorur struktura artizanale apo komerciale,
- Duke kërcënuar përmes forcës apo mjeteve të tjera,
- Duke tentuar të ndikojnë politikën, mediat, administratën publike, drejtësinë apo ekonominë.

Shkurtimisht: krimi i organizuar është si një aktivitet biznesor që realizohet përmes organizatave kriminale të cilat përdorin dhunën dhe/apo korrupsionin për të fituar financiarisht apo për të fituar pushtet në shoqëri (Ministria e Punëve të Brendshme e Sllovenisë, 1998).

Nga tabelat e mëposhtme (tabelat 1 dhe 2) mund të shohim proporcionin e krimit të organizuar në krahasim me të gjitha aktet e tjera kriminale. Për shembull, rastet e krimit të organizuar në vitin 2010 paraqesin një shkallë të vogël në kuadër të të gjitha krimeve të raportuara (afërsisht 0,004%). Megjithatë krimi i organizuar paraqet një përqindje të vogël nga të gjitha krimet, sigurisht është më i rrezikshmi për shtetin dhe situatën e tij financiare e sundimin e ligjit. Statistikat e policisë tregojnë që prodhimi dhe tregtimi i llojeve të drogave jo-ligjore, substancave ilegale që përdoren në sport dhe substancave pararendëse për prodhimin e drogave ilegale janë krimet më të shpeshta që ndërlidhen me krimin e organizuar. Teoria dhe praktika sllovene ka identifikuar 15 krime kryesore që kryhen nga kriminelët dhe grupet e organizuara kriminale: vrasje pa paramendim; vrasje, lëndime trupore; lëndime të rënda trupore; kalimi i territorit apo kufirit shtetëror; prodhimi i paligjshëm i parave; prodhimi dhe tregtimi i paligjshëm me armë; abuzimi me prostitucionin; prodhimi dhe tregtimi i llojeve të drogave jo-ligjore, substancat ilegale që përdoren në sport dhe substancat pararendëse për prodhimin e narkotikëve ilegal; lejimi i mundësisë për konsumimin e drogave dhe substancave të paligjshme në sport; vjedhja; vjedhja e rëndë, plaçkitja, mashtrimi dhe zhvatja (shih tabelën 2).

Tabela 1<sup>20</sup>

	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Numri i të gjitha krimeve në Slloveni	84379	90354	88197	81917	87465	89489
Numri i krimeve/kundërvajtjeve të hetuara	32896	36984	38213	36936	42247	46133
Kundërvajtjet/Krimet ekonomike	6115	8471	7962	7459	9259	13064
Dëmi financiar i krimeve ekonomike (në MIL EUR)	69,4	87	106,8	112,5	193,3	505,4
Numri i krimeve të organizuara	397	499	293	359	413	352
Aktet korruptive	18	44	19	18	231	71

<sup>20</sup> Raportet statistikore nga Policia Sllovene mund të gjenden në <http://www.policija.si/index.php/statistika>

Tabela 2

<b>Krimi i organizuar</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>
Vrasje pa paramendim	-	-	-	-	-	-
Vrasje	-	-	-	-	-	-
Lëndime trupore	-	-	-	-	-	1
Lëndime të rënda trupore	-	-	-	-	-	-
Kalimi ilegal i territorit apo kufirit shtetëror	130	85	42	112	55	45
Prodhimi i paligjshëm i parave	3	2	6	16	4	-
Prodhimi dhe tregtimi i paligjshëm i armëve apo eksplozivëve	4	22	1	8	15	4
Abuzimi me prostitucionin	4	8	-	1	8	-
Prodhimi dhe tregtimi i llojeve të drogave jo-ligjore, substance ilegale që përdoren në sport dhe substance pararendëse për prodhimin e drogave ilegale	208	236	145	52	271	184
Lejimi i përdorimit të drogave apo substancave të paligjshme në sport	1	6	2	-	2	3
Vjedhja	2	10	1	2	4	2
Vjedhja e rëndë	11	24	17	68	27	24
Plaçkitja	-	6	5	3	1	16
Mashtrimi	1	4	1	-	1	3
Zhvatja	9	11	18	11	-	14
Të tjera	24	85	53	86	25	56
<b>Totali</b>	<b>397</b>	<b>499</b>	<b>293</b>	<b>359</b>	<b>413</b>	<b>352</b>

Siç mund të shihet nga tabela 1, dëmi financiar i krimeve ekonomike në Slloveni është mjaft i lartë. Në vitin 2010 ishte 505 MIL EUR (193 MIL EUR në 2009, 112 MIL EUR në 2008, 106 MIL EUR në 2007 etj.). Statistikat (zyrtare) fatkeqësisht nuk tregojnë sa është dëmi nga krimi i organizuar.

## Masat/statistikat tjera rreth krimit të organizuar

### EUROPOL

Vlerësimi i Europol për Kërcënimet nga Krimi i Organizuar për vitin 2011 (OCTA 2011) nxjerr në pah që nga të gjitha qendrat, në Juglindje (ku gjendet Sllovenia) është shfaqur përhapja më e madhe, si rezultat i trafikimit përmes Detit të Zi, rritja e numrit të rrugëve të Ballkanit për trafikimin e paligjshëm nga dhe për në BE dhe një rritje e konsiderueshme e imigrimit ilegal përmes Greqisë. Këto zhvillime në regjion, kanë kontribuar në formimin e një vije të Ballkanit për trafikim për në BE, që përbëhet nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa Juglindore. Qendra të reja të transitit janë në proces të krijimit në shtete si Hungaria, ku rrugë të ndryshme të Ballkanit dhe Detit të Zi bashkohen. Grupet kriminale shqip-folëse, Turke dhe të Ish Bashkimit Sovjetik, janë duke synuar të zgjerojnë interesat e tyre në BE dhe ata mund të shfrytëzojnë mundësitë e hyrjes potenciale të Bullgarisë dhe Rumanisë në Zonën Schengen, si dhe heqja në të ardhmen e afërt e vizave për në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor, Ukrainës dhe Moldavisë.

Në raportin e OCTA, Sllovenia përmendet vetëm një herë: Në Evropën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor, kultivimi brenda dhe jashtë vendit janë vëzhguar. Grupet kriminale shqip-folëse luajnë një rol domethënës në furnizimin e Evropës Juglindore: kanabisi i kultivuar në Shqipëri dhe regjionin e Kosovës shpërndahet në Greqi, Itali, Slloveni, Hungari, dhe po ashtu trafikohet në Turqi, ku shkëmbehet me heroinë. Brenda qendrave të Evropës Juglindore vërehet një trend në rritje i kultivimit nga të moshuarit, produktet e të cilëve pastaj merren nga grupet kriminale të lidhur me shpërndarjen e polidrogave. Njëjtë si në rastin e emigrantëve ilegal dhe individëve të dëmtuar nga kriza ekonomike, kultivimi i kanabisit sjell grupet e ndjeshme të shoqërisë në një kontakt më të afërt me krimin e organizuar.<sup>21</sup>

### Raporti për Siguri dhe Krim i Sllovenisë për vitin 2011 "OSAC"

Krimi i organizuar, veçanërisht dyshimi për përfshirje në trafikimin me narkotikë, vjedhjen e veturave, mashtrimi, evazioni i taksave, falsifikimi i produkteve dhe trafikimi i qenieve njerëzore nga një shtet në tjetrin janë problem në Slloveni, por të paraqitura në një masë më të vogël se sa në shtetet fqinje. Si një anëtar i zonës Schengen, Sllovenia ushtron kontroll shumë strikt në kufijtë e saj dhe në procedurat e lëshimit të vizave.<sup>22</sup>

### EUROSTAT

Raporti i Eurostat nr. 58/2010 ka paralajmëruar që në disa shtete jugore si Portugalia, Sllovenia, Spanja, Italia dhe Qiproja, shkalla e krimeve është rritur.<sup>23</sup>

### 2. Asetet e fituara ilegalisht

Siç mund të shihet më poshtë nga tabela 3, janë bërë mesatarisht 370 propozime për konfiskim dhe marrje të të ardhurave (beneficioneve nga prona). Po ashtu kemi zbuluar që statistikën (zyrtare) nuk i tregojnë më këto të dhëna që nga viti 2008, megjithëse legjislacioni që e rregullon këtë fushë nuk ka ndryshuar. Sistemi slloven i drejtësisë nuk ka pasur as edhe një rast të vetëm të shpronësimit si ndëshkim kryesor që do të duhet tu jepej personave juridik. Por, në anën tjetër kanë qenë disa masa të përkohshme të ngrirjes së të ardhurave (për beneficionet nga pronat) – në një mesatare prej 29 rastesh në vit. Në vitin 2010 kanë qenë 58 raste të tilla. Të dhëna të tjera statistikore nuk ekzistojnë.

<sup>21</sup> [https://www.europol.europa.eu/sites/default/files/publications/octa\\_2011.pdf](https://www.europol.europa.eu/sites/default/files/publications/octa_2011.pdf)

<sup>22</sup> <https://www.osac.gov/Pages/ContentReportPDF.aspx?cid=10494>

<sup>23</sup> [http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY\\_OFFPUB/KS-SF-10-058/EN/KS-SF-10-058-EN.PDF](http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-SF-10-058/EN/KS-SF-10-058-EN.PDF)



Tabela 3<sup>24</sup>

	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Propozimet për konfiskim të objekteve dhe të ardhurave (nga beneficionet e pronave)	461	315	334	Nuk ka të dhëna*	Nuk ka të dhëna *	Nuk ka të dhëna *
Shpronësimi- ndëshkimi kryesor ndaj personave juridik	0	0	0	0	0	0
Ngrirja e aseteve dhe pronësisë në të ardhurat nga (beneficionet e pronës) dhe sigurimi i përkohshëm i të ardhurave (nga beneficionet e pronës).	19	18	16	32	30	58
* Raportet vjetore nuk i paraqesin më këto statistika.						

## Baza ligjore dhe ndarja e përgjegjësive për institucionet

### 1. Krimi i Organizuar

Në mendimin tonë, legjislacioni sloven është i përshtatshëm për të luftuar krimin e organizuar dhe për të konfiskuar pronat dhe të ardhurat (asetet e fituara ilegalisht). Në sistemin e Sllovenisë – legjislacioni për të luftuar krimin e organizuar është i definuar në ligje të ndryshme (Kodi i Policisë, Kodi i Prokurorisë së Shtetit, Kodi i Procedurës Penale, Kodi Penal, Kodi për Parandalimin e Shpëlarjes së parave, etj) ku të drejtat, obligimet dhe autoritet (pushtetet) e policisë, prokurorisë dhe trupave të tjerë janë të definuar. Nuk ka ndonjë ligj të veçantë kundër krimit të organizuar.

Qëllimi është që objektet e trajtimit të Policisë që ndërlidhen me krimin e organizuar janë të gjitha krimet që kryhen nga organizatat kriminale. Organizatat kriminale janë të definuara në Nenin 294 të Kodit Penal të Republikës së Sllovenisë: (1) kushdo që merr pjesë në një asociacion kriminal i cili ka për qëllim kryerjen e veprave kriminale për të cilat vlen dënimi me burg për më shumë se tri vjet apo me burgim të përjetshëm, duhet të dënohet prej tre muaj deri në pesë vite burgim. (2) Kushdo që themelon apo udhëheq një asociacion siç është referuar në nenin e mësipërm, duhet të dënohet nga gjashtë muaj deri në 8 vite burgim. (3) Kryerësi i një veprë kriminale nga nenet e mëparshme i cili parandalon kryerjen e mëtutjeshme të këtyre veprave apo zbulon informacione që kanë ndikim në hetimet dhe faktimin e veprave kriminale të cilat tanimë janë kryer, mund t'i zvogëlohet dënimi, në përputhje me nenin 51 të këtij Kodi Penal.

Të gjitha rregullimet “e veçanta” janë të definuara në ligjet e sipërpërmendura, për shembull:

- Kodi penal parasheh dënime më të larta për krimet, të cilat kryhen nga grupet apo asociacionet kriminale:

Shfrytëzimi përmes Prostitucionit (Neni 175 i Kodit Penal):

*(1) Cilido që merr pjesë në prostituimin e dikujt me qëllim të shfrytëzimit apo udhëzon, merr ose inkurajon dikë tjetër që të angazhohet në prostitucion përmes forcës, kërcënimeve apo mashtrimit*

<sup>24</sup> Raporti statistikor i Prokurorisë Publike të Sllovenisë; mund t'i qaseni në:  
[http://www.dt-rs.si/sl/vrhovno\\_drzavno\\_tozilstvo/porocila\\_o\\_delu\\_drzavnih\\_tozilstev/](http://www.dt-rs.si/sl/vrhovno_drzavno_tozilstvo/porocila_o_delu_drzavnih_tozilstev/)

*duhet të dënohet me burgim për tre deri në pesë vite. (2) Nëse një krim i paraparë në nenet e mëparshme kryhet kundër një të mituri, kundër më shumë se një personi apo si pjesë e një organizate kriminale, kryerësi duhet të marr dënimin me burg në mes të një deri në dhjetë vite.*

Një nen tjetër që ndërlidhet me përgjegjësinë e anëtarëve dhe udhëheqësve të organizatave kriminale (neni 41 i Kodit Penal):

*(1) Një dënim më i lartë mund të shqiptohet për një veprë kriminale ndërkombëtare për më shumë se tri vite burgim nëse vepra kriminale është kryer brenda një organizate kriminale. (2) Një anëtar (këtu e tutje: anëtari) i organizatës kriminale që ka në përbërje së paku tre persona duhet të dënohet me një dënim edhe më të lartë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, nëse ai ka kryer veprën penale për të zbatuar planin e organizatës kriminale në bashkëpunim me së paku një anëtar si ndihmës apo bashkëpunëtor. (3) Në rastet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, udhëheqësi i organizatës kriminale, që ka udhëhequr zbatimin e planit kriminal apo ka pasur në posedim beneficione të fituara ilegalisht në kohën e kryerjes së krimit bazuar në planin kriminal, pa marr parasysht nëse ai ka marr pjesë në zbatim direkt apo si ndihmës sipas Nenit 20 apo 37 dhe 38 të këtij Kodi Penal, duhet të dënohet njësoj si kryerësi i veprës.*

Përveç ligjeve të përmendura, duhet theksuar që Parlamenti i Sllovenisë në vitin 2004 ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërshtetëror.

Për një luftë më efikase kundër krimit të organizuar, Ligji për Policinë është amandamentuar në atë mënyrë që tani Sllovenia ka Zyrën Kombëtare për Hetime (për më shumë, shih pikën e ardhshme – organet përgjegjëse për luftimin e krimit të organizuar). Legjislacioni slloven po ashtu parasheh edhe Instruksionet për punën e grupit të Prokurorëve të Shtetit për ndjekjen penale të krimit të organizuar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, Nr. 53/06 dhe 70/08) ku procedurat dhe rregullat e punës për Prokurorët Special kundër krimit të organizuar janë të definuara.

## **2. Konfiskimi i aseteve të fituara ilegalisht**

Në Slloveni, konfiskimi i të ardhurave kriminale ka për qëllim primar rikthimin e kushteve financiare në gjendjen e njëjtë siç kanë qenë para kryerjes së veprës penale. Konfiskimi trajtohet si i pavarur nga seksioni i Kodit Penal që flet për sanksionet kundër veprës penale dhe nuk merret parasysht në përcaktimin e dënimit. Korniza e përgjithshme ligjore përcaktohet nga:

- a) Kapitulli i 7 i Kodit Penal – Konfiskimi i pronës së fituar nga aktivitetet kriminale (shih shtojcën I), që përmban provizionet e detajuara duke përshkruar bazën dhe metodat për konfiskimin e pronës, mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe konfiskimin nga personat juridik;
- b) Nenet 498-507 të Kodit të Procedurës Penal (shih Shtojcën II), që përshkruajnë procedurat e konfiskimit dhe
- c) Neni 73 i Kodit Penal – Konfiskimi i Objekteve të Fituara përmes Kryerjes së Veprës Penale – (shih shtojcën III), që rregulloj konfiskimin e objekteve.

Sipas Nenit 498 të Kodit të Procedurës Penale, [“objektet (...) duhet të konfiskohen edhe në rastet kur ndjekja penale nuk përfundon me një verdikt të shpalljes së fajësisë”]. Për më shumë, “grykëta duhet të vendos për konfiskim edhe në rastet kur në aktvendimin e gjykatës për dënim nuk parashihet një provizion i tillë”, sidomos “kur kështu kërkohet nga interesat e sigurisë publike apo nga konsideratat morale” (shih Shtojcën II). Po ashtu, në rastet kur procesi gjyqësor përfundon me aktvendim të fajësisë, paratë apo prona mund të konfiskohen kur faktet tregojnë se ato e kanë prejardhjen nga veprat kriminale - Neni 245 (vepra penale e shpëlarjes së parave) dhe 151, 157, 241, 242, 261, 262, 263 si dhe 264 të Kodit Penal janë të vendosura. Në këtë rast, gjykatësi hetues, me kërkesën e panelit para-gjyqësor të përbërë nga tre gjykatës të Gjykatës së Qarkut, mbledh provat dhe heton të gjitha rrethanat me rëndësi për përcaktimin e origjinës së paligjshme të parave apo pronës së dhënë apo të marr përmes rryshfetit. Në fund të hetimeve, paneli i përbërë nga gjashtë gjykatës lëshon një vendim që i kumtohet pronarit të parave apo të pronës i cili ka të drejtën e apelit (Neni 498a).

Neni 75 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal parasheh rregullat e aplikueshme për konfiskim (shih Shtojcën I). Konfiskimi i vlerës është i mundshëm. Përparësitë ekonomike apo pronat e fituara përmes apo si rezultat i kryerjes së një veprë penale vlerësohen ex officio: gjykatat apo agjencitë e tjera të thirrura për sundim të ligjit që janë përgjegjëse për hetimit e veprave kriminale mbledhin fakte që janë domethënëse në vlerësimin e pasurisë. Kur grykëta konsideron që është i nevojshëm mendimi i specialistit për vlerësimin e pasurisë pronësore, mund të angazhojë ekspertë. Sidoqoftë, grykëta mund të vendos një shumë fikse të pasurisë sipas diskrecionit të saj, në rastet kur një vlerësim i saktë mund të shkaktoj shumë vështirësi dhe kështu procesi mund të zgjas shumë më shumë seç duhet.

8. Prona mund të konfiskohet edhe nga personat të cilëve prona i është transferuar falas apo për një shumë që nuk korrespondon me vlerën e saj reale, në rastet kur këta persona kanë qenë të njoftuar që kjo pronë është fituar përmes kryerjes së veprës penale. Ndërsa sa i përket përfituesve, njohuria nëse prona rrjedh nga veprat penale nuk është e domosdoshme. Një pronë mund të konfiskohet kur t’i transferohet familjarëve<sup>25</sup>, përveç nëse këta persona mund të dëshmojnë që vlera e plotë e pronës në fjalë është paguar.

Konfiskimi i aseteve që i takojnë personave juridik është i paraparë në Nenin 75 të Kodit Penal (shih Shtojcën I). Shpenzimet për fitimin e të ardhurave nuk mund të hiqen. Neni 97 i Kodit Penal thotë si vijon: “Nëse pala e dëmtuar është shpërblyer sipas kërkesës për kompensim të dëmit [përvojës si rezultat i kryerjes së veprës penale] sipas Gjykatës Penale, kjo e fundit duhet të urdhëroj konfiskimin e pronës vetëm për aq sa nuk e tejkalon vlerën që i duhet dhënë palës së dëmtuar”. Po ashtu ceket që Grykëta Penale mund t’i kërkojë palës së dëmtuar që të paraqes kërkesën për kompensim para një gjykatë civile në rastet kur vlerësimi për kompensimin e dëmit është i vështirë dhe kështu do të shkaktonte vonesa në gjithë procesin gjyqësor. Për më shumë, çdo palë e dëmtuar, e cila nuk ka bërë kërkesë për kompensim gjatë rrjedhës së procesit gjyqësor, mund të fillojë një rast civil për marrjen e kompensimit të dëmit, Brenda gjashtë muajsh prej momentit të njoftimit për urdhrin e konfiskimit.

<sup>25</sup> "Familjarët e afërm" nënkupton: burrin/gruan, vëllanë, motrën apo kushëririn e parë deri në shkallën e tretë, një të afërm përmes martesës deri në shkallën e dytë, prindërit adoptues, fëmijën e adoptuar, prindërit kujdestar, fëmijën nën kujdes apo ndokënd tjetër që jeton në shtëpinë e kryerësit.

Masat e përkohshme janë të rregulluara përmes Neneve 109, 502 dhe 507 të Kodit të Procedurës Penale. Neni 109 flet për të gjitha rastet që lidhet me masat e përkohshme për ruajtjen e interesave të personave që kërkojnë kompensim të dëmeve, përderisa neni 502 ka të bëjë me procedurat që lidhen me konfiskimin e të ardhurave nga pronat (shih shtojcën IV). Për më shumë, këto provizione, duhet cekur që Zyra për parandalimin e shpëlarjes së parave është fuqizuar për të suspenduar çfarëdo transaksioni Brenda 72 orësh, nëse besohet që ka arsye të dëshmuara për të dyshuar për raste të shpëlarjes së parave. Legjislacioni po ashtu ofron bazën për aplikimin e masave të përkohshme për të gjitha veprat penale.

### **Menaxhimi i aseteve të konfiskuara**

Neni 506a i Kodit të Procedura Penale thotë që: *"(1) Gjykata e cila ka urdhëruar ruajtjen e objekteve të konfiskuara apo ato që janë siguruar përkohësisht, kërkesën për sekuestrim të të ardhurave apo pronave në vlerë të të ardhurave duhet të ndërmerren veprime të shpejta në raste të tilla. Duhet t'i menaxhoj objektet dhe pronat të përdorura për sigurim të përkohshëm të kërkesës si dhe objektet ose pronën e paraqitura me kujdes. (2) Nëse ruajtja e sendeve të sekuestruara ose sigurimi i përkohshëm i padisë së përdorur në paragrafin e mësipërm përfshin shpenzime jo-proporcionale ose nëse vlera e pronës është në rënie, gjykata mund të urdhërojë që prona të tilla ose objekte të shiten, shkatërrohen, ose dhurohen për shërbim publik. Para vendimit gjykata duhet të marrë edhe mendimin nga pronaret e pronës ose të objektit. Nëse identiteti i pronarit nuk është i njohur ose nëse thirrja për ta marrë mendimin nuk mund të bazohet në të, gjykata duhet të bëjë një thirrje në bordin e njoftimeve dhe pas tetë ditëve do të konsiderohet se thirrja i është referuar atij. Nëse pronari nuk e paraqet mendimin e tij në afatin prej tetë ditësh pas thirrjes, atëherë do të konsiderohet se ai pajtohet me shitjen, shkatërrimin ose dhënien si donacion. Gjykata gjithashtu përcakton se në rastet kur grumbullimi i sendeve përfshin "shpenzime te tepruara" ose vlera e tyre ulet për shkak të konfiskimit, gjykata mund të urdhërojë që një pronë e tillë ose objekt të shitet, shkatërrohet ose dhurohet si donacion publik.*

"Dekreti për Procedurat e Menaxhimit të gjësendeve, pronës apo depozitave të sigurisë të konfiskuara" e Marsit të vitit 2002 (i amendamentuar dy herë në vitin 2007 - shih Shtojcën - vetëm në gjuhën sllovene) rregullon të gjitha procedurat që lidhen me menaxhimin gjësendeve dhe pronave siç është definuar në Nenin 506a. Neni 3 thotë që Gjykata mund të urdhërojë që ndonjë gjësend të depozitohet dhe menaxhohet nga ekzekutuesit - përmbaruesit - të caktuar në përputhje me ligjin relevant, dhe që menaxhimi, ruajtja, shitja dhe shkatërrimi i gjësendeve apo pronës së konfiskuar mund të mbikëqyret nga "Komisioni i gjësendeve të konfiskuara", që përbëhet nga gjykatës, prokurorë dhe përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

### **Ligji për Konfiskimin e aseteve të përfituara në mënyrë të paligjshme - (është në lexim të dytë në Parlament)**

Qëllimi kryesor dhe objektiva e ligjit të ri është parandalimi i marrjes dhe shfrytëzimi i aseteve të fituara ilegalisht. Këto prona duhet tu merren personave që i kanë ato, natyrisht, për tu siguruar mbrojtja e të drejtave të personave që i kanë fituar ato prona në mënyrë legjitime. Rregullat e propozuara krijojnë procedura special për konfiskimin e

aseteve të fituara ilegalisht, që në procedura gjyqësore ishte pika fillestare vetëm në rast të dyshimit për prejardhje jo-ligjore. Baza për procesin e konfiskimit të pronës pas-taj ofrohet gjatë hetimit të veçantë financiar. Ndërsa, sa i përket ngrirjes së përkohshme të posedimit të të ardhurave (nga beneficionet e pronës) dhe sigurimit të përkohshëm të tyre si dhe konfiskimit përfundimtar të tyre, gjykatat do të vendosin në procedura civile, duke marr parasysh parimin e peshës së provave.

Kështu, ligji ofron mundësinë e konfiskimit nëse i dyshuari nuk është në gjendje të dëshmojë që e ka fituar pronën në mënyrë të ligjshme. Procedura për konfiskim do të jetë në juridiksion të zyrës së veçantë të prokurorit publik (Grupi i tanishëm i prokurorëve të shtetit për ndjekjen e krimeve të organizuara në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Shtetit të Republikës Sllovene). Në institutin e ri – një hetim financiar – do të vlerësohet nëse asetet ishin fituar legalisht apo jo (siç është përmendur në kontekstin civil dhe jo atë penal). Nëse i dyshuari është në gjendje të dëshmojë që pronën e ka fituar në mënyrë të ligjshme atëherë ajo do t'i kthehet atij. Organii cili do të menaxhojë me pronën, është i obliguar që të ruaj vlerën e saj reale.

Ky ligj nuk do nuk parasheh krijimin e institucioneve të reja por shfrytëzimin e kapaciteteve Brenda institucioneve ekzistuese të sistemit të drejtësisë (shih në shtojcë versionin Slloven të ligjit të propozuar).

### **Institucionet Përgjegjëse**

Duhet të theksohen edhe institucionet e tjera që kanë rol në luftimin kundër krimit të organizuar. Këto institucione janë:

- Policia ( Drejtorati i policisë kundër krimit, divizioni i krimit te organizuar, (seksioni i narkotikëve, seksioni kundër terrorizmit dhe dhunës ekstreme dhe seksioni i asocioneve kriminal)
- Prokuroria e shtetit
- Zyra për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave
- Gjykata supreme

#### **a. Policia**

Përmes Ligjit për Policinë, i cili ka hyr në fuqi me 18 korrik 1998, shërbimi i policisë është shndërruar në një trup Brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Sllovenisë. Sipas strukturës organizative të policisë, në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë është krijuar Drejtoria kundër Krimit. Sipas kësaj strukture organizative mund të shohim në detaje se si janë të organizuara njësitet/ sektorët e policisë:

## DIVIZIONI KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Sektorit kundër narkotikëve  
Sektori kundër terrorizmit dhe dhunës ekstreme  
Sektori kundër grupeve kriminale

## DIVIZIONI KUNDËR KRIMEVE TË PËRGJITHSHME

Sektori i krimeve ndaj pronës  
Sektori i vrasjeve dhe krimeve seksuale  
Sektori i krimeve nga të rinjtë

## DIVIZIONI I KRIMEVE EKONOMIKE

Sektori i krimit financiar dhe shpëlarjes së parave  
Sektori i krimit publik dhe në biznes  
Sektori kundër korrupsionit  
Sektori i krimeve të rënda ekonomike

## DIVIZIONI PËR RASTE TË VECANTA

Sektori i operacioneve të fshehta  
Sektori i përgjimeve  
Sektori i teknikave të veçanta  
Sektori për mbrojtjen e dëshmitarëve

## DIVIZIONI PËR BASHKËPUNIM POLICOR NDËRKOMBËTAR

Sektori i Interpol-it  
Sektori Sirene  
Sektori i Europol-it  
Sektori i Administratës dhe telekomunikimit

## QENDRA E INTELIGJENCËS KUNDËR KRIMIT

## QENDRA E HETIMEVE KOMPJUTERIKE

## ZYRA KOMBËTARE E HETIMEVE

**Policia kundër krimit** - bashkëpunojnë me policinë në uniform në zbulimin e rasteve kriminale dhe kryerësve të tyre. Për shkak të prezencës së tyre të vazhdueshme ata mund të ndërmarrin aksione të menjëhershme në krime më të lehta. Disa forma të krimit, të cilat kërkojnë njohuri dhe teknika të veçanta hetuese kërkojnë angazhimin e hetuesve kriminal.

Krimi nuk ndalet nga dallimet në kufij kombëtar apo etnik. Në dekadën e fundit, me shpërbërjen e bllokut lindor, krimi ka depërtuar në perden e hekurt të perëndimit. Kjo ka të bëjë në veçanti me krimin e organizuar, trafikimin e paligjshëm të armëve dhe narkotikëve dhe shpëlarjen e parave. Sllovenia po ashtu po përballet më shpesh me këto krime, prandaj edhe nuk befason fakti që luftimi i organizatave të krimit të orga-

nizuar të përfshira në krime ndërkombëtare është shndërruar në qëllimin kryesor të policisë kundër krimit.

Përpjekjet e policisë kundër krimit jo vetëm për të ndjekur në kohë kryerësit e krimeve por edhe për të qenë një hap para tyre, bën që ata gjithmonë të jenë në kërkim të metodave dhe teknikave hetuese modern, të trajnojnë dhe pajisin ekspertët për të ndjekur rastet dhe format më serioze të krimeve, të përmirësojnë kualitetin e përdorimit të provave gjatë procedimit të rasteve, të përmirësojnë përdorimin e metodave dhe teknikave të veçanta për hetimin e rasteve të krimit të organizuar, përforcimin e punës në parandalim të rasteve, monitorimin e krimeve të kryerave nga të rinjtë më thellësisht etj. Policia kundër krimit ka themeluar grupe të veçanta ekspertësh për luftimin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe atij kibernetik; kjo do të ndihmoj në lehtësimin e monitorimin të lëvizjeve kriminale, Brenda dhe jashtë shtetit dhe do të kontribuoj në uljen e shkallës së krimeve, që megjithatë tani është ndër më të ulëtat në Evropë.

**b. Zyra Kombëtare e Hetimeve** është krijuar në Slloveni në vitin 2010. Është një njësit i specializuar hetimesh kriminale në nivel kombëtar të Ministrisë së Brendshme për zbulimin dhe hetimin e krimeve të rënda. Arsyet për këtë janë:

Në shkurt të vitit 2009, grupi punues për përgatitjen e konceptit që institucionet e sundimit të ligjit të jenë në gjendje për t'iu përgjigjur në mënyrë më të suksesshme dhe efektive formave të reja të krimit , përpiloi një analizë të thuktë të punës të Policisë kundër krimit në nivel shtetëror dhe regional. Analiza e situatës problematike ka treguar të meta në vazhdim të cilat kanë ndikuar në eficiencën e punës së policisë në hetimin e krimeve ekonomike, korrupsionit dhe formave të tjera të krimit:

- Legjislacioni joadekuat

Nuk ka bazë ligjore për një qasje multidisiplinate ndaj hetimeve të krimit të organizuar dhe atij ekonomik, provizionet e papërshtatshme të Dekretit për bashkëpunimin e Zyrës së Prokurorit të shtetit slloven dhe Policisë në zbulimin dhe hetimin e kryerësve të krimeve.

- organizimi i papërshtatshëm i Policisë kundër Krimit

Detyrat operacionale dhe jo-operacionale të Policisë kundër Krimit tejkalojnë fushat e specializimit për hetimet.

- Politikat e papërshtatshme rreth personelit

Numri i personelit adekuat dhe të kualifikuar është shumë i ulët; lëvizjet e personelit si vijnë si rezultat i nënvlerësimit të punësimit dhe posteve e pagesave.

- Burimet e papërshtatshme material

Prezantim i ngadalshëm i zhvillimeve teknologjike. Edukimi dhe trajnimi i papërshtatshëm.

Sistemi i trajnimit është i mbyllur.

- Bashkëpunimi i pamjaftueshëm institucional

Veprimet e pa-harmonizuara të institucioneve të përfshira në procedurat para gjykimit. Një problem tjetër shumë i theksuar është ruajtja e përkohshme dhe heqja e përhershme të avantazheve të fituara nga kryerësi i krimit me rastin e kryerjes së krimit. Në periudhën e viteve 2004 – 2009, policia ka kryer 365 hetime financiare me qëllim të identifikimit të pronave që kanë prejardhje nga krimi i organizuar dhe ai ekonomik. Si rezultat, në Prokurorinë e Shtetit janë dërguar 172 mocione për ruajtje të përkohshme të pronës nga policia. Në 138 raste nuk është gjetur asnjë arsye apo pronë për një mocion për ruajtje të përkohshme të pronës gjatë hetimeve financiare. Sipas të dhënave të policisë, në bazë të mocioneve të dërguara në prokurori (vetëm) 19 vendime për ruajtje të përkohshme të pronës janë lëshuar nga gjykatat. Megjithatë, duket theksuar që policia nuk ka të dhëna të sakta për vendimet e lëshuara nga gjykatat, dhe momentalisht nuk ka asnjë bazë ligjore për shkëmbim të drejtpërdrejtë të të dhënave në mes të gjykatave dhe policisë. Ky është një tregues i qartë i problemeve sistematike në këtë fushë në të gjithë zinxhirin e drejtësisë – duke filluar nga Policia, Prokuroria e deri të gjykatat.

Duke u bazuar në të metat e përshkruara dhe në problemet që hasen shumë shpesh nga institucionet për sundim të ligjit gjatë luftës së tyre kundër krimit të organizuar dhe atij ekonomik si dhe korrupsionit, një koncept për zbulim dhe ndjekje penale më efikase në këtë fushë është krijuar grupi i brendshëm punues. Ky grup ka propozuar krimin e Zyrës Kombëtare të Hetimeve, e cila është themeluar në Janar të vitit 2010.

ZKH është pjesë e policisë slovene dhe një njësit hetues autonom në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, që punon në kuadër të kornizës së punës së Drejtorisë së Policisë kundër Krimit. Ky njësit ekskluzivisht zhvillon detyra operacionale që kërkojnë personelin e kualitetit më të lartë dhe pajisjet më të zhvilluara që ka shteti në dispozicion. Zyra është përgjegjëse për zbulimin dhe hetimin e krimit ekonomik, korrupsionit dhe formave të tjera të krimeve serioze, kompleksiteti i të cilave kërkon trajnime të specializuara për hetim, organizim dhe pajisje si dhe harmonizim dhe performancë të përbashkët të shumë institucioneve të nivelit lokal dhe ndërkombëtar.

ZKH po ashtu ka sjell mundësinë e zhvillimit të ndryshimeve strukturale e organizative brenda strukturave ekzistuese të Drejtorisë së Policisë kundër Krimit. Me riorganizimin e Drejtorisë së Policisë kundër Krimit, "Qendra e Inteligjencës kundër Krimit" është themeluar dhe ka si aktivitet kryesor – policimin që udhëhiqet nga inteligjenca. (ILP).<sup>26</sup>

### c. Prokuroria e shtetit

Zyra e Prokurorit të përgjithshëm të shtetit është zyra më e lartë e prokurorisë në vend, në kuadër të së cilës funksionojnë prokurorët më të lartë dhe supreme të shtetit, ata të gjykatave të qarkut të caktuar nga kjo zyrë për kryerjen e detyrave profesionale të komplikuar dhe prokurorët e shtetit të caktuar për ndjekjen penale të rasteve të krimit të organizuar.

<sup>26</sup> Burimi i informacionit për NBI: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/Mesko/235122.pdf>; faqe 243-259



Grupi i prokurorëve të shtetit të caktuar për ndjekjen penale të rasteve të krimit të organizuar është përgjegjës për ndjekjen e kryerësve të veprave kriminale në fushën e krimeve “klasike” ekonomike, të terrorizmit, atyre që lidhen me korrupsion apo krime të tjera ku zbulimi dhe ndjekja e këtyre rasteve kërkon organizim dhe aftësi të veçantë duke përfshirë të gjithë shtetin kur këtë e kërkon Prokurori i Përgjithshëm i Shtetit.

#### d. Zyra për parandalimin e shpëlarjes së parave (ZPSHP)

Zyra për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave është pjesë përbërëse e Ministrisë së Financave dhe kryen detyra që ndërlidhen me parandalimin dhe zbulimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit si dhe detyrave të tjera të parapara me Aktin për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe financimit të terrorizmit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë Nr. 60/2007).

Zyra është e përbërë nga menaxhmenti dhe 6 njësi organizative, përkatësisht: a) Sektori për parandalim dhe mbikëqyrjen b) Sektori për transaksione të dyshimta c) Shërbimet analitike d) Shërbimi i teknologjisë informative dhe e) Shërbimi për bashkëpunim ndërkombëtar.

ZPPSHP është e autorizuar që të ndaloj çdo transaksion për 72 orë, nëse beson që ka arsye të besueshme për të dyshuar se është një rast i shpëlarjes së parave. Sipas nenit 20 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të parave, ZPPSHP mund të filloj hetimin e një rasti kur “një transaksion apo një individ krijon dyshime për shpëlarje të parave” apo në bazë të »iniciativës me shkrim« nga organet shtetërore (Policia, gjykata, Zyra e Prokurorit të shtetit, Agjencia e Inteligjencës Sigurisë, Banka e Sllovenisë, Agjencia e Tregut të Sigurimeve, Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve apo trupat e inspektoratit të Ministrisë së Financave).

#### Vlera e të ardhurave të siguruar përkohësisht në rastet e shpëlarjes së parave

Tabela numër 4 tregon të dhëna rreth numrit të rasteve të shpëlarjes së parave, ku gjykatat në periudhën prej vitit 2000 deri në 2009 në faza të ndryshme të procedurave penale, kanë urdhëruar sigurimin e përkohshëm të kërkesës për konfiskim të të ardhurave dhe vlerën e tyre.

Tabela 4: Fondet e konfiskuara gjatë periudhës 2005 – 2009 (në valuta të huaja)

VITI	EUR	USD	GBP
2005	5.384	664.195	
2006	1 x pronë e paluajtshme		
2007	4.767.503	60.345	7.5
2008	1.925.828		
2009	3.224.615		
TOTALI	9.923.330	724.54	7.5
TOTALI NË EUR		<u>10.973.762</u>	

Tabela 4 tregon që gjykatat gjatë periudhës kohore prej 2005 deri në 2009 kanë urdhëruar konfiskimin apo sigurimin e përkohshëm të kërkesave për konfiskimin e të ardhurave në vlerën e përgjithshme prej 10.973.762 EUR. Sigurimi i përkohshëm i referuar në 12 raste për personave fizik dhe në 2 raste të personave juridik e që lidhen me dyshimet e bazuara për kryerje të veprave kriminale të shpëlarjes së parave. Gjykatat kanë urdhëruar ndërmarrjen e masave të sipërpërmendura: në vitin 2005 në një rast, në 2006 po ashtu një rast, në vitin 2007 në tri raste, 2008 në dy raste dhe në vitin 2009 në pesë raste.

Në vitin 2009, gjykatat (me propozim të Prokurorit të Shtetit) përkohësisht kanë siguruar të ardhurat, në vlerë prej 3.224.615 EUR. Këto masa të sigurimit të përkohshëm i referohen 6 rasteve të personave fizik dhe 1 personi juridik në gjithsej 4 raste.

Vlera e të ardhurave të konfiskuara (ende të siguruara nga dekrete të gjykatave me 31 dhjetor 2009), pa marr parasysh se kur ka hyr në fuqi masa e përkohshme e sigurimit të të ardhurave, ka qenë 12.360.204 EUR. Pjesë e të ardhurave kanë qenë në llogari të gjykatave të qarkut në Slloveni dhe të autoriteteve të tjera kompetente jashtë vendit (së bashku 5.612.482,03 EUR), si marrja e 1.987.637 EUR të referuara në vlerën reale të pronës së siguruar dhe disa veturave si dhe 4.760.085 EUR ishin marr në bazë të të Konventës së Strasburgut Nr. 141.

#### e. Gjykata Supreme

Departamenti i veçantë i gjykatave më me përvojë dhe më të kualifikuar e që janë përgjegjës për trajtimin e formave më të ashpra të krimit (duke e përfshirë edhe krimin e organizuar).

Përveç këtyre institucioneve/organeve, duhet theksuar gjithashtu të tjerët që janë përgjegjës për bashkëpunimin ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, Sllovenia është anëtar e Europol, Interpol, SIRENE, SECI, CEPOL, MEPA, Misioneve Ndërkombëtare, ENFSI. Po ashtu ka qenë e vlerësuar edhe nga Moneyval, GRECO, OECD, Komisioni Evropian etj.

Sllovenia me qëllim të luftës efikase kundër këtyre dukurive ka nënshkruar dhe ratifikuar një numër shumë të madh marrëveshjesh, me shumë shtete të ndryshme.

#### Zbatimi i ligjeve dhe efektet e arritura në praktikë

Përmes analizimit të legjislacionit që ndërlidhet me luftimin kundër krimit, analizat kanë treguar që në krahasim me pjesën tjetër të Evropës, ne kemi ligje më adekuate dhe institucione shumë më të specializuara për ndjekjen penale të krimeve, të cilat megjithatë nuk janë të lidhura me njëra tjetrën dhe nuk punojnë së bashku. Të gjeturat tregojnë që ky bashkëpunim nuk është duke funksionuar mirë për shkak të interesave personale të individëve që punojnë në këto institucione. Gjykatat të cilat së fundmi janë fajësuar për mos-ujtje të shkallës së krimit, nuk kanë përfaqësues politik që mund të flasin në favor të pavarësisë së gjykatave. Duhet theksuar më shumë që gjykatat janë ato që duhet të mbrojnë të drejtat e njeriut dhe që i peshojnë provat dhe jo ato që duhet të

provojnë fajësinë e kriminelëve. Institucionet e shtetit, të cilat duhet të kenë njohuri dhe pushtet, duket që po e humbin luftën me anën e kundërt sepse ato nuk janë të lidhura, nuk janë funksionale dhe nuk janë të harmonizuara. Institut i ri është Zyra Kombëtare e Hetimeve dhe ligji i ri për konfiskimin e aseteve të fituara në mënyrë jo-ligjore.

Për të dëshmuar që legjislacioni, veçanërisht ai për konfiskimin është i mirë, ne duhet të theksojmë raportin GRECO për Slloveninë. Raporti i ekipit vlerësues të GRECO (GET) në paralajmërime dhe rekomandime. Raportin e dytë të vlerësimit (Strasbourg, 12.12.2003) për Slloveninë ka theksuar kënaqësi dhe natyrisht paralajmërime e rekomandime:

*Provizionet e Kodit Penal janë adekuate për konfiskimin e të ardhurave dhe objekteve. Para së gjithash, është për tu përshëndetur fakti që konfiskimi i të ardhurave është mandator. Për më shumë, GET ka është informuar që konfiskimi përfshin gjithçka që kryerësi ka fituar gjatë veprës penale. Gjykata prandaj nuk duhet të zbrit "shpenzimet" që kryerësi i ka bërë nga të ardhurat e fituara ilegalisht. Kjo e lehtëson konfiskimin dhe nuk kërkon ndonjë dëshmi të veçantë apo kalkulim gjatë hetimeve apo procesit gjyqësor. GET e sheh si pozitiv faktin që jo vetëm të ardhurat mund të konfiskohen por edhe pronat në vlerë ekuivalente me të ardhurat mund të konfiskohen. Po ashtu ekzistojnë edhe rregullore të kënaqshme që mundësojnë bërjen të obligueshme për të dënuarit apo të akuzuarit që të paguajnë një shumë korresponduese brenda dy vitesh në rastet kur konfiskimi i të ardhurave apo pronës në vlerën ekuivalente me të ardhurat nuk është i mundshëm. Kohëzgjatja e shumë të procesit nga GET megjithatë mund të konsiderohet negative, në pendimin e saj për suksesin në marrjen e aseteve. GET ishte informuar që proceset gjyqësore penale normalisht zgjasin tre vjet e më shumë deri kur të jepet vendimi përfundimtar.*

*Provizionet ekzistuese ligjore të Kodit të Procedurës Kriminale janë të mjaftueshme për të lejuar marrjen e përkohshme të të ardhurave dhe objekteve. GET ka pasur përshtypjen që megjithatë këto provizione përdoren shumë rrallë dhe deri më tani vetëm shumë të vogla janë konfiskuar, megjithëse konfiskimi i të ardhurave dhe objekteve të fituara gjatë krimit është mandator, në fazën e gjykimit nëse kërkesat ligjore janë plotësuar. Për më shumë, jo të gjithë zyrtarët policor, prokurorët dhe gjykatësit kanë njohuri të mjaftueshme të këtyre provizioneve në mënyrë që të implementojnë konfiskimin e aseteve. Në mendimin e GET-së, është i nevojshëm trajnimi i tyre në përdorimin e provizioneve ligjore për konfiskimin.*

GET ka rekomanduar që në mënyrë që të promovohet përdorimi në praktikë i këtyre provizioneve ligjore për konfiskim të përkohshëm, duhet që: 1)shërbimet e prokurorisë duhet që të përdorin në maksimum provizionet ligjore të konfiskimit të përkohshëm në fillim të hetimit – nëse është e arsyeshme edhe në fazën preliminare, 2) Zyrtarët policor të Departamentit për Hetime Kriminale dhe prokurorët duhet të marrin trajnime specifike në aplikimin e provizioneve ligjore dhe 3)përkrahja në formën e model dokumenteve për marrjen e përkohshme (depozitave bankare, aksioneve, pronave të paluajtshme etj.) të cilat duhet të përgatiten dhe të jenë të qasshme për zyrtarët policor, gjykatësit hetues dhe prokurorët.

*GET po ashtu ka pasur përshtypjen se procesi i fillimit të hetimeve e veçanërisht përdorimi i teknikave të veçanta hetuese është aq kompleks sa që është e vështirë të sigurohen dëshmi përm-bajtësore të veprave penale dhe të identifikohen apo merren objektet dhe të ardhurat apo asetet në vlerë ekuivalente. Si rezultat, nuk është e qartë e veçanërisht në rastet e krimeve të komp-*

likuara ekonomike, në coftë se ka apo një mënyrë të thjeshtë dhe të shpejtë përmes së cilës policia mund të filloj hetimet dhe të aranzhoj masat e nevojshme, duke përfshirë edhe ngrirjen/marrjen e të ardhura që kanë origjinën në krime.

Për më shumë, GET gjatë vizitës ka kuptuar që autoritetet përgjegjëse për ndjekjen penale nuk janë gjithmonë në mënyrë të shpejtë të pajisura me dokumente të nevojshme dhe informata që do tu ofronin atyre mundësinë e marrjes së vendimit nëse marrja e aseteve apo asistencë ligjore është e nevojshme. Në mendimin e GET, në rastet e krimeve ekonomike dhe korrupsionit vetëm hetimet e filluara shpejt kanë mundësinë e suksesit. Transkacionet kryhen në mënyrën më të fshehtë të mundshme dhe nuk është në interes të askujt që të zbulohen, shpeshherë dëshmia e vetme qëndron në gjurmët që zgjasin shumë shkurt, kryerësit e veprave penale e paraqesin veten si individë serioz dhe dëshmitarët duket që nuk kanë parë, dëgjuar apo thënë asgjë. Prandaj, në shumë raste hetimet janë të suksesshme aty ku ekziston elementi i befasisë. **Për këtë arsye, GET ka rekomanduar që prokuroria të informohet menjëherë për hetimet kështu që të mund të marr udhëheqësinë dhe të vendos në mënyrë të shpejt nëse masat e përkohshme për heqje të pronësisë duhet të ndërmerren.**

Natyrisht, efektet e rëndësishme të rregulloreve »kundër« krimit të organizuar dhe atyre për konfiskimin e aseteve të fituara në mënyrë joligjore janë më shumë se thjeshtë të mira. Me to, Sllovenia ka krijuar bazën për vepruar në mënyrën e duhur kundër krimit të organizuar dhe për konfiskim. Sllovenia tenton të ketë efekt më të madh pozitiv nga ligji i ri për konfiskim i cili tani është në lexim të dytë në Parlamentin Slloven.

## **Roli i Shoqërisë Civile në luftën kundër krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme**

Siç kemi vërejtur, bashkëpunimi në mes të institucioneve të sundimit të ligjit (policisë dhe zyrave të prokurorëve publikë) në Slloveni, si dhe lidhja midis këtyre institucioneve dhe institucioneve financiare, u theksua si një nga problemet kryesore. Problemi i dytë është zhvillimi i dobët social dhe kjo është pikërisht arsyeja pse ne duhet të zhvillojmë kushtet për punë më të mira sociale. Nëpërmjet OJQ-ve, shoqëria civile mund të ketë ndikim në ngritjen e përgjegjësisë së zyrtarëve publik. Ndikimi në uljen e krimit është treguar përmes pavarësisë të mediave, sistemit arsimor, dhe presionit mbi të rinjtë për të vepruar drejtë dhe për të formuar vlera të reja. Shoqëria civile mban rolin më të rëndësishëm në parandalimin e krimit dhe mund të çojë në formimin e një shoqërie më të mirë. Shoqëria civile përfaqëson interesat e grupeve të veçanta dhe është duke ndërtuar partneritet në mes shoqërisë dhe institucioneve të tyre.

Në këtë mënyrë, ajo mund të ngrit vetëdijen e njerëzve që krimi i organizuar është një rrugë e keqe dhe e gabuar e jetesës. Përveç shoqërisë civile, institucionet arsimore dhe gazetaria hulumtuese po ashtu luajnë një rol të rëndësishëm në luftimin e krimit të organizuar. Ne do të rrisim bashkëpunimin e të gjithë akterëve në shoqëri për të reduktuar krimin, por më të rëndësishmet janë institucionet e ligjit, grupet profesionale, studiuesit akademik, organet përfaqësuese të ekonomisë, OJQ-të dhe shoqëria civile. Ne duhet të kombinojmë persona të interesuar të paanshëm, të cilët vijnë nga institucionet dhe grupet e lartpërmendura, për të debatuar rreth reduktimit të krimit të orga-

nizuar. Roli kryesor i forumeve rreth krimit të organizuar është për të pranuar sa më shpejtë koncepte të përbashkëta rreth reduktimit të krimit, për të formuar mjete të tjera ligjore dhe për të nxitur dialog më të mirë në mes të atyre që janë duke luftuar krimin në përgjithësi dhe krimin e organizuar në veçanti.

(Burimi: Društvo Integriteta – Transparency International Slovenia tash për tash është e vetmja OJQ, e cila fokusohet në ngritjen e transparencës dhe integritetit shoqëror në Slloveni).

## Përfundime

Krimi i organizuar në shumë mënyra është një çështje në zhvillim e sipër që po ndodh në Ballkanin Perëndimor, që reflekton mungesën e mbrojtjes së të drejtave pronësore, të mundësive të punësimit dhe dobësisë së shtetit. Projektet për ngritjen e kapaciteteve brenda sistemit të drejtësisë janë po aq me rëndësi sa edhe vet legjislacioni kur flasim për luftimin e krimit të organizuar. Informatorët pjesëmarrës dhe operacionet e fshehta policore janë me rëndësi kritike në luftimin e krimit të organizuar. Asistenca ndërkombëtare dhe kushtëzimi duhet të jenë të koordinuara në mënyrë që të shmangët stërngarkimi i administratave vendore. Shtetet e regjionit duhet të ndërmarrin një qasje më të balancuar për të bashkuar inteligjencën kundër krimit. Operacionet duhet të jenë të bazuara në vlerësime të sakta të kërcënimeve dhe jo në prioritetet e mediave apo politikës. Komuniteti ndërkombëtar duhet të ndihmoj në krijimin e ekspertizës së nevojshme për arritjen e këtij qëllimi.

Parandalimi dhe shtypja e krimit të organizuar, është në synim që askush nuk guxon ta vë në dyshim. Por, ne duhet të menaxhojmë dhe kontrollojmë krimin në vend të luftimit të tij. Krimi ka qenë prezent gjithmonë në histori dhe duket që gjithmonë do të jetë aty, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor. Ne duhet të kontrollojmë dhe të tentojmë ta ulim deri në minimumin e shkallës së rrezikshmërisë krimin e organizuar, meqenëse duket utopike që të zhduket përfundimisht, siç edhe na dëshmon përvoja e së kaluarës. Në këtë luftë është e pasigurt se kush do të fitoj. Menaxhimi dhe kontrollimi i krimit do të ndihmoj në krijimin e një shoqërie më të mirë. Për të bërë këtë, ne duhet të fokusohemi në nivelet më të kriminelëve duke e përdorur bashkëpunimin. Nëse ka mungesë të angazhimit në nivelet më të larta shtetërore, atëherë mungon edhe autoriteti moral për të përforcuar ligjin dhe për t'i dënuar kriminelët. Premtimet ambicioze dërgojnë drejt humbjes së besimit të publikut. Reformat e pakoordinuara do të thonë që askush nuk është i zotuar për të zbatuar ligjin deri në pikën e fundit. Reformat të cilat mbështeten jashtëzakonisht shumë vetëm në ligj dhe fuqizim qojnë drejt shtypjes, e kjo e stimulon krimin. Reformat të cilat vetëm në rastet e njerëzve të zakonshëm nuk kanë efekt në përgjithësi në krimin e organizuar.





Serbi

## Vlerësimi mbi nivelin e krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme

### Zanafilla e krimit të organizuar në Serbi

Çështja e krimit të organizuar është diskutuar veçanërisht gjatë periudhës së sanksioneve ndërkombëtare dhe luftërave jugosllave gjatë 1990-ve dhe pas vrasjes së Kryeministrit Zoran Djindjic.

"Mungesa e tregut të lirë ose, më mirë, fakti se partia komuniste kishte të drejtën e mendimit në gjithçka, veçanërisht ekonomi, kanë rezultuar në pamundësinë e zhvillimit të formave të caktuara të biznesit të paligjshëm. Me fjalë të thjeshta, partia dhe strukturat politike ishin mafia mbi të gjithë të tjerët. Veç kësaj, Serbia, ose më mirë, ish Jugosllavia ndryshonte nga vendet e tjera socialiste sepse qytetarët e saj mundnin t'i merrnin pasaportat lirshëm dhe pa kufizime, dhe numri i atyre qytetarëve që udhëtonin në perëndim si turistë dhe emigrantë gjithashtu përfshinte numër të madh të përfshirëve në veprimtari kriminale. Kjo, në një mënyrë, ishte "membranë" sigurie për shtetin (ish RSFJ).

Për shkak të tregut të kufizuar dhe mundësive të kufizuara për të fituar para në Jugosllavi (Serbi), por gjithashtu edhe për shkak të regjimit komunist represiv, numër i madh i kriminelëve vepruan ligjshëm në atdhe, përderisa kryenin biznes të paligjshëm dhe fitonin pasuri në tregjet e mëdha të Evropës Perëndimore. Regjimi komunist me vetëdije e toleronte këtë, shpesh duke i përdorur këta individë t'i kryenin punët e pista të shtetit dhe të merreshin me kundërshtarët e tij politikë jashtë shtetit. Në këtë mënyrë, ish RSFJ-ja me mbi 1 milionë emigrantë ekonomikë në vendet perëndimore, numër i madh i të cilëve u përfshinë në veprimtari kriminale, kishte blerë paqen relative shoqërore. Megjithatë, situata ndryshoi pas rënies së murit të Berlinit më 1989, kur qytetarët e vendeve tjera të Evropës Lindore ishin të lirë të udhëtonin në Perëndim. Skena ishte marrë nga grupe kriminale më të fuqishme dhe më të organizuara, kryesisht nga ish BRSS-ja dhe Shqipëria. Tani, kur kriminelët ishin toleruar deri në këtë kohë, kriminelët që i kishin fituar paratë e tyre jashtë nuk mund të qëndronin dhe t'i shpenzonin ato në Perëndim, kështu që filluan biznesin e tyre të paligjshëm në Serbi. Në të njëjtën kohë, qarqet profesionale të Serbisë filluan të interesohen më shumë për çështjen e krimit të organizuar e madje edhe politikanët filluan të flasin hapur për faktin që Serbia nuk ishte më immune ndaj problemeve të krimit të organizuar.

Fillimi i 90-ve karakterizohej nga ngjarjet tragjike lidhur me shpërbërjen e RSFJ-së dhe luftën në territorin e saj. Ky fakt është fort i lidhur me daljen e disa grupeve dhe akterëve të cilët ndryshuan nga kriminelë në heroj kombëtarë dhe mbrojtës të interesave të rrezikuar kombëtare. Kjo po ashtu ishte koha kur njësitë e rregullta dhe paraushtarake në territorin e ish Jugosllavisë filluan të armatosen rëndë, veçanërisht në republikat që kishin shpallur ndarjen nga RSFJ-ja, e të cilat deri atëherë nuk kishin forcat e tyre të armatosura dhe armët. Këto republika gjetën rrugë të ndryshme për të marrë armë dhe municione të përshtatshme, e cila nënkuptonte formimin e kanaleve të ndryshme të paligjshme jashtë, duke përdorur shërbimet e mafisë vendore dhe të huaj, përfshirë mercenarët e jashtëm, të ashtuquajturit "qentë e luftës".



Djem të fortë dhe biznesmenë kundërthënës, të cilët ishin terma eufemistikë për kriminelët, u bënë shumë të dobishëm për realizimin e objektivave politike dhe të luftës, veçanërisht për palët në luftë në ish Jugosllavi. Prandaj, në njërin anë më nuk kishte mirëkuptim taktik dhe të tërthortë por të hapur dhe të drejtpërdrejtë ndërmjet shtetit dhe fuqisë politike në ish republikat jugosllave dhe, në anën tjetër, strukturave të mafisë. Për ta kompletuar paradoksin, strukturat e mafisë dhe organizatat e anëve të ndryshme të luftës, përkundër retorikës së rëndë verbale, nacionaliste kishin bashkëpunim të ngushtë në fushën e tregtisë së drogave, armëve, karburanteve, dhe mallrave tjera që mungonin.

Kaosi i luftës së përgjithshme dhe anemia e plotë shoqërore favorizuan paraqitjen dhe forcimin e krimit të organizuar, e cila ishte theksuar sërish në Serbi me futjen e sanksioneve ekonomike të OKB-së, të cilat nënkuptonin pamundësinë e furnizimit normal dhe të ligjshëm të karburanteve, por gjithashtu edhe ilaçeve dhe mallrave tjera. Kjo krijoi atmosferën shoqërore dhe psikologjike ku çdokush që ia dilte të kontrabandonte mallra nga jashtë dhe ta thyente bllokadën e OKB-së perceptohej si person që realizonte synime shoqërore pozitive dhe të pranueshme, dhe jo si dikush i përfshirë në biznesin e paligjshëm dhe askush nuk paralajmërohej nga rreziku për forcimin e krimit të organizuar. Për më tepër, në atmosferën e zhgënjimit të përgjithshëm dhe pakënaqësisë për shkak të sanksioneve dhe kushteve të vështira të jetesës të shkaktuara nga sanksionet, vendet e Evropës Perëndimore dhe Sh.B.A.-të, të cilat i futën sanksionet, perceptohehin si armiq të Serbisë nga shumica e qytetarëve dhe, që këtej, të gjithë ata që ia dilnin t'i thyenin sanksionet dhe bllokadën trajtoheshin në shprehje ekstremisht pozitive, si "Heroj".

Prandaj, shteti jo vetëm që i toleronte grupet e përfshira në veprimtari kriminale, por shteti edhe i nxiste grupet e tilla. Në çdo rast, këto grupe përjetuan pranim të plotë shoqëror. Çiftimi i shtetit dhe ndërmarrjeve kriminale u bë më i fortë dhe më i dukshëm, dhe ishte vetëm çështje kohe se kur grupet e tilla do të dilnin nga kontrolli i regjimit të Millosheviçit, i cili me vetëdije i toleronte dhe përdorte ato. Sot, disa vjet pas rënies së Millosheviçit, deklarata dhe dëshmi të shumta të njerëzve të cilët morën pjesë në këto ngjarje zbulojnë se rol aktiv dhe i rëndësishëm është luajtur nga individë dhe grupe nga nëntoka kriminale. Këto grupe shpëtuan nga kontrolli ekzistues, dhe deri atëherë i suksesshëm, i Millosheviçit. Me fjalë të thjeshta, xhindi kishte dalë jashtë shishes; krimi i organizuar nuk ishte më nën kontroll dhe u bë faktor i pavarur, por po ashtu shumë ndikues në ngjarjet politike në Serbi. Për ta kompletuar ironinë, ajo që i ndodhi Zoran Djindjic duket të jetë përkim i ngjashëm i ngjarjeve. Pas përdorimit të strukturave kriminale për ta rrëzuar Slobodan Millosheviçin më 5 tetor 2000, ai gjithashtu e shtyu kohën e ballafaqimit përfundimtar me grupet e krimit të organizuar, pjesërisht për shkak të frikës ndaj tyre, por në çdo rast i bindur se ishte i aftë t'i kontrollonte dhe shkatërronte ato sapo të ishin krijuar kushtet për këtë (sapo legjislacioni i nevojshëm të miratohej), në mënyrë ligjore, të rregullt. Sidoqoftë, duket se mafia ishte aq e fortë dhe e lidhur me seri qendrash të fuqisë politike në Serbi, sa që ishte mafia e cila e para e goditi shtetin duke e vrarë Kryeministrin më 12 mars 2003.

Kjo pa dyshim është shenjë e vitalitetit dhe fuqisë e asaj që në teori dhe praktikë quhet krim i organizuar, dhe porosi për secilin që të mos luaj me mafinë që është e vështirë ta kontrollosh, dhe se lufta kundër krimit të organizuar nuk duhet të shtyhet me kur-

rfarë kushti, pavarësisht sesa i përshtatshëm dhe pragmatik mund të duket në momentin e caktuar, në kushte politike dhe ekonomike<sup>27</sup>.

*Niveli aktual i krimit të organizuar*<sup>28</sup>

Është e qartë se koncepti i krimit të organizuar në Serbi ndryshon gjatë viteve të fundit. Koha e grupeve të dhunshme kriminale, pak a shumë duke shfaqur hapur fuqinë dhe pasurinë e tyre, duke e paraqitur veten si patriotë dhe duke kryer punë të pista për politikanët, me sa duket ka kaluar.

Sidoqoftë, nuk do të thotë se krimi i organizuar nuk ekziston. Format "klasike" të grupeve të organizuara kriminale edhe sot janë të pranishme por janë më pak të njohura për publikun. Konfirmimi i parë i këtij fakti është "libri i bardhë" i sapo përgatitur nga policia për grupet e krimit të organizuar në Serbi. Dëshmia e dytë e ekzistimit të tyre është ende gjallë dhe me sa duket, tregu i narkotikëve është në ngritje. Shpërdorimi i drogave u rrit gjatë viteve të fundit në vend dhe ky treg nuk mund të furnizohej ndryshe pos përmes grupeve të organizuara kriminale me lidhje të mira me grupet e ngjashme në vendet tjera. Duket se vetëm një pjesë e vogël e grupeve të tilla është e pazbuluar. Dëshmia e tretë për praninë e krimit të organizuar të dhunshëm janë rastet e vjedhjeve me armë në vend dhe rastet e vrasjeve që përfshijnë gangsterët serbë, kryesisht në vendet tjera (si rasti i tashëm i vrasjes së I. Pukaniçit në Zagreb, ku kriminelët nga Serbia akuzohen si ekzekutues ose organizatorë).

Përkundër formave të tij klasike, të dhunshme, krimi i organizuar duket se merr çdo herë e më shumë forma të reja, përfshirë shpërdorimet financiare dhe mashtrimet. Ndarja e madhe ndërmjet dy tipeve është fakti se organizatorët e shpërdorimeve dhe mashtrimeve rrallë janë njerëz me të kaluar të pastër kriminale, por më shumë njerëz që e shfrytëzojnë rastin e pozitës së tyre zyrtare dhe që kanë ide të mira biznesore (edhe pse të paligjshme). Kriminelët e tillë vështirë se janë të gatshëm ta kalojnë tërë jetën në veprimtari kriminale, por parapëlqejnë ta shfrytëzojnë mundësinë dhe të pasurohen në kohë të shkurtër. Duke pasur këtë parasysh, mund të jetë gjithashtu problematike ta emërojmë nga pikëpamja teorike këtë tip të krimit të "organizuar".

Si koncepti klasik ashtu edhe koncepti më i ri i krimit të organizuar, mund ta ketë lidhjen e tij të qartë me akterët në politikat publike ose së paku shërbyesit civilë. Faktori më shqetësues në këtë kuptim është financimi i fshehtë i partive politike dhe mungesa e mjeteve efektive të kontrollit mbi të hyrat e zyrtarëve publikë dhe shërbyesve civilë. Askush nuk mund të pohojë pa prova se politikanët ose partitë financohen nga grupet e krimit të organizuar ose se ato mbrojnë interesat e tyre, por nuk është e mundur të pohohet e kundërta, përderisa burimet e fondeve të tyre të vërtetohen në mënyrë të pavarur. Ngjashëm, edhe pjesa mundësisht e kontrollueshme, pasuria e shërbyesve civilë nuk kontrollohet dhe krahasohet me të hyrat e tyre të ligjshme, as në bazë të përhershme e as në rastet kur ngriten dyshime në shtyp. Për më tepër, disa tipe të krimit të organizuar dyshohet se udhëhiqen nga politikanët – p.sh. drejtorët e ndërmarrjeve publike që e dëmtojnë pronën publike dhe nga udhëheqësit e partive dhe mbrojtësit e tyre.

<sup>27</sup> Jovan Ciric in THE FIGHT AGAINST ORGANISED CRIME IN SERBIA From the Existing Legislation to a Comprehensive Reform Proposal Belgrade 2008 page 45-49.

<sup>28</sup> Ky kapitull vjen nga teksti i autorit të njëjtë përgatitur për hulumtimin rajonal për krimin e organizuar, udhëhequr nga Monitori i Rrezikut, Sofje-Bullgari

Faktori ende jo mjaftueshëm i hulumtuar deri tani është roli i shërbimeve sekrete dhe të sigurisë dhe ish anëtarëve të tyre. Ndryshe nga vendet e tjera të Evropës Lindore, Serbia kurrë nuk i ka hapur dosjet e bashkëpunëtorëve dhe anëtarëve të shërbimeve sekrete dhe është e vështirë të vlerësohet se çfarë është ndikimi i tyre në politikat publike. Në të kaluarën, vet shërbimi sekret bashkëpunonte në mënyrë aktive me grupet e krimit të organizuar dhe në veprimtarinë kriminale në vend dhe jashtë. Shqetësim tjetër i lidhur me sigurinë është fakti se shumë zyrtarë policorë ose policë të pensionuar kanë lënë shërbimin publik dhe zgjedhën të punojnë për kompanitë private të sigurisë, duke ofruar mbrojtje. Pa dyshim, kjo shton rrezikun e korrupsionit dhe krijimit të rrjeteve të paligjshme në mesin e zyrtarëve ligj-zbatues dhe strukturave kriminale.

E ardhmja do të imponojë sfida të reja për ta luftuar krimin e organizuar. Për shembull, mund të pritët se liberalizimi i vizave me BE-në, në fuqi që nga dhjetori 2009, do ta bëjë krimin ndërkuftar funksional më lehtë. Perspektivat tjera të krimit të organizuar janë mashtrimet në internet dhe tipat tjerë të krimit të teknologjisë së lartë. Tipi i tretë i krimit të organizuar, që tashmë ekziston, dhe që duket se do të lulëzojë në periudhën e afërt, janë mashtrimet që dëmtojnë buxhetin publik, qoftë përmes nxjerrjes së parave publike nga skemat që përfshijnë zyrtarët shtetërorë ose përmes shmangies së detyrimeve tatimore. Domethënë, mekanizmat e kontrollit të shtetit janë thjeshtë të dobët që të përshtaten me numrin e madh të rasteve të këtij lloji.

Sado i rëndë që është krimi i organizuar, është e sigurt se shteti kurrë më parë nuk kishte mjete kaq të fuqishme për ta luftuar atë. Ka metoda të veçanta të lejuara për hetimet e krimit të organizuar, organet e specializuara policore që e luftojnë atë, prokuroria dhe gjykatat, ka parakushte ligjore të sekuestrohen të hyrat nga krimi në mënyrë efikase. Publiku përkrahë luftën kundër krimit të tillë, dhe vullneti politik ekziston, i paraqitur në përparësitë e shpallura dhe ndonjëherë në veprime. Në fund, ka mundësi të shfrytëzohet ndihma ndërkombëtare, në veçanti proceset anëtarësuese në BE, që lufta të jetë më efikase.

## Baza ligjore dhe ndarja e përgjegjësive për institucionet

### Konfiskimi i aseteve ( Pasqyrë e ligjit)

Ligji për konfiskimin e pronës që rezulton nga vepra penale ("Lajmëtari Zyrtar i Republikës së Serbisë", Nr. 97/2008) rregullon kushtet, procedurën dhe agjencitë kompetente për zbulimin, konfiskimin dhe menaxhimin e pronës që rezulton nga vepra penale.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen në rastet e veprave të mëposhtme penale:

- 1) krimi i organizuar (p.sh. të gjitha veprat penale kur krimi është kryer nga grupi i organizuar kriminal);
- 2) tregimi i materialeve pornografike dhe përdorimi i fëmijëve për pornografi;
- 3) disa vepra penale nga grupi i krimeve kundër ekonomisë;

- 4) prodhimi, mbajtja dhe tregtimi i paautorizuar i narkotikëve;
- 5) disa vepra penale kundër ligjit dhe rendit;
- 6) disa vepra penale kundër detyrës zyrtare (përfshirë ato me elemente të korrupsionit, si shpërdorimi i pushtetit sipas nenit 359);
- 7) kundër njerëzimit dhe vlerave tjera të mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare.

Për më tepër, ligji mund të zbatohet ndaj rasteve kur dyshohet për disa vepra tjera penale (lista është paraqitur në nenin 2), kur prona e fituar përmes veprës penale dhe/ose vlerës së objektit të veprës penale kalon shumë prej një milionë e pesëqindmijë dinarë.

Ligji përkufizon pronën si diçka që përfshin të mira të çfarëdo lloji, materiale dhe jo materiale, të luajtshme ose të paluajtshme, të vlerësueshme ose të pa vlerësueshme, dhe dokumente që në çfarëdo forme shërbejnë si prova të pasjes së një të drejte ose interesi në lidhje me të mirat e tilla. Po ashtu si pronë do të kuptohen edhe të hyrat ose përfitimet tjera që drejtpërdrejtë ose tërthorazi dalin nga vepra penale, si dhe të mirat në të cilat prona është transformuar ose me të cilat është përzier. Prona që rezulton nga vepra penale kuptohet se përfshin pronën e të dyshuarit, bashkëpunëtorit-dëshmitar, ose dëshmuesit, e cila padyshim është në shpërpjesëtim me të hyrat e ligjshme.

Agjencitë kompetente për zbulimin, konfiskimin, dhe menaxhimin e pronës që rezulton nga vepra penale janë: Prokurori Publik, Gjykata, njësia organizative e Ministrisë së Brendshme kompetente për hetim financiar, dhe Autoriteti për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar.

Njësia organizative kompetente për hetime financiare është njësi e specializuar organizative e Ministrisë së Brendshme e ngarkuar për zbulimin e pronës që rezulton nga vepra penale, dhe për kryerjen e detyrave tjera në pajtim me këtë ligj. Njësia vepron sipas detyrës zyrtare ose me urdhër të prokurorit publik dhe gjykatës. Agjencitë qeveritare dhe tjera, organizatat dhe ndërmarrjet publike janë të detyruara t'i ofrojnë ndihmë Njesisë.

Autoriteti për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar është agjenci brenda kornizës së Ministrisë së Drejtësisë. Agjencitë qeveritare dhe tjera, organizatat dhe ndërmarrjet publike janë të detyruara t'i ofrojnë ndihmë Autoritetit.

Autoriteti menaxhon pronën e konfiskuar që rezulton nga vepra penale, objektet e veprës penale, përfitimet nga prona që rrjedhë nga vepra penale, dhe pronën e ofruar si siguri në procedurën penale; bën vlerësime profesionale të pronës së konfiskuar që rezulton nga vepra penale; ruan, mirëmban dhe e shet pronën e konfiskuar përkohësisht që rrjedhë nga vepra penale dhe disponon me të hyrat e fituara pas shitjes në pajtim me ligjin; mban shënime të pronës që menaxhon dhe të procedurave që lidhen me vendim-marrjen për pronën e tillë; kryen detyra tjera në pajtim me këtë ligj.

Hetimi financiar mund të fillohet kundër një pronari nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm lidhur me posedimin e tij të konsiderueshëm që prona e tij rezulton nga vepra penale. Ajo përfshin mbledhjen e dëshmive lidhur me pronën, të hyrat e ligjshme dhe shpenzimet e jetesës së të akuzuarit, të dëshmitarit-bashkëpunues ose dëshmuesit, dëshmisë

lidhur me pronën e trashëguar nga pasardhësi ligjor, dhe/ose dëshmi lidhur me pronën si dhe shqyrtimin e dhënë për transferimin e pronës tek personi i tretë.

Hetimi financiar mund të fillohet sipas urdhrorit të prokurorit publik dhe udhëhiqet nga prokurori publik. Brenda hetimit financiar është e mundshme të merren masa të ndryshme, përfshirë kontrollimin e banesës ose ndërtesa tjera të pronarit ose personave tjerë, kur ka mundësi të gjetjes së dëshmive. Prokurori publik mund të urdhërojë bankën ose organizatën tjetër financiare që ta furnizojë Njësinë me të dhëna lidhur me pozitën e biznesit të pronarit si dhe llogaritë dhe kasafortat personale.

Nëse ekziston rreziku se konfiskimi i më vonshëm i pronës që rezulton nga vepra penale do të bëhej më i vështirë ose i pamundur, prokurori publik mund të bëjë kërkesë për konfiskimin e përkohshëm të pronës. Para marrjes së vendimit sipas kërkesës për konfiskimin e përkohshëm të pronës, gjykata mban seancë gojore dhe në pajtim me këtë e fton edhe pronarin e pronës, mbrojtësin e tij dhe/ose përfaqësuesin nëse ka ndonjë, dhe prokurorin publik. Kur ftesa për paraqitje nuk mund të dërgohet, gjykata emëron një përfaqësues për pronarin për të vepruar në procedurën e konfiskimit të përkohshëm të pronës. Në seancën e tillë, prokurori publik paraqet dëshminë dokumentare lidhur me pronën e pronarit, rrethanat që çojnë në dyshimin e arsyeshëm se prona është rezultat i veprës penale, si dhe rrethanat që theksojnë se rreziku i konfiskimit të mëvonshëm do të ishte më i vështirë ose i pamundur.

Pas hyrjes në fuqi të padisë së prokurorit, dhe më së voni brenda një viti, nga dita e mbylljes efektive të procedurës penale, prokurori publik bën kërkesë për konfiskimin e përhershëm të pronës që rezulton nga vepra penale. Përmes vendimit që rrëzon akuzën ose duke e liruar nga akuza, gjykata hedhë poshtë kërkesën për konfiskim të përhershëm të pronës dhe shfuqizon vendimin për konfiskim të përkohshëm të pronës.

Nëse kërkesa ka synim pronën e të dënuarit dhe/ose dëshmitarit bashkëpunues, prokurori publik paraqet dëshminë lidhur me pronën e zotëruar nga i dënuari dhe/ose dëshmitari bashkëpunues, për të hyrat e tij të ligjshme dhe rrethanat që nxjerrin në pah mos përpjesëtimin e dukshëm ndërmjet pronës dhe të hyrave të ligjshme. Pas kësaj, i dënuari dhe/ose dëshmitari bashkëpunues dhe përfaqësuesi i kundërshtojnë paraqitjet e prokurorit publik. Ka dispozita të ngjashme gjithashtu edhe lidhur me pronën e trashëgimitarit ligjor ose personit të tretë.

Ligji po ashtu përmban dispozita rreth dëgjimit gjyqësor dhe procedurës së ankesës.

Deri në kohën e shfuqizimit të vendimit për konfiskim të përkohshëm të pronës dhe/ose përfundimit të procedurave të konfiskimit të përhershëm të pronës, Autoriteti menaxhon pronën e konfiskuar duke zbatuar kujdesin si zotërues i mirë i shtëpisë dhe/ose si ekspert i zellshëm. Shpenzimet e ruajtjes së sigurt dhe mirëmbajtjes së pronës së konfiskuar përkohësisht mbulohen nga Autoriteti. Drejtori mund të vendosë që prona e konfiskuar përkohësisht mund të mbahet nga pronari me obligimin që të kujdeset për pronën si zotërues i mirë i shtëpisë. Pronari mbulon shpenzimet e ruajtjes së sigurt dhe mirëmbajtjes së pronës. Nëse kjo arsyetohet, drejtori, në disa raste, dhe në bazë të kontratës, mund t'ia besojë menaxhimin e pronës së konfiskuar përkohësisht ndonjë personi fizik ose juridik.

Me synim që të ruhet vlera e pronës së konfiskuar përkohësisht, Autoriteti, pas miratimit nga gjykata kompetente, mund ta shesë pronën e luajtshme pa vonesë, dhe/ose t'ia besojë ndonjë personi fizik apo juridik me qëllim që të shitet. Në mënyrë të veçantë, gjykata mund të vendosë që, në vend se të shitet prona, siguria e ofruar nga pronari ose personi tjetër mund të pranohet. Shuma e sigurisë përcaktohet në bazë të vlerës së pronës së konfiskuar përkohësisht. Pasi të depozitohet siguria, prona i dorëzohet garantuesit të sigurisë.

Shitja e pronës kryhet përmes ankandit publik gojor që lajmërohet në "Lajmëtarin Zyrtar të Republikës së Serbisë", dhe/ose medie tjera. Mallrat që prishen dhe kafshët mund të shiten pa ankand gojor publik. Prona e luajtshme shitet me çmimin i cili është i njëjtë ose më i lartë sesa vlera e llogaritur e përcaktuar nga Autoriteti. Nëse prona nuk shitet pas dy ankandëve gojorë publike, shitja mund të bëhet përmes pazarit të drejtpërdrejtë. Shitja e sigurimeve dhe dokumenteve tjera të negociueshme kryhet në pajtim me rregulloret lidhur me tregtinë e sigurimeve. Prona e luajtshme e pa shitur brenda një viti mund të dhurohet për qëllime humanitare ose të shkatërrohet. Fondet e nxjerra nga shitja e pronës ruhen në llogari të veçantë të Autoritetit derisa të anulohet vendimi për konfiskimin e përkohshëm të pronës. Këto fonde përdoren për rikthimin e pronës dhe kompensimin e dëmeve dhe shpenzimeve që Autoriteti ka pasur për veprimtarinë e vet.

Fondet e nxjerra nga shitja e pronës së konfiskuar përkohësisht e cila është vërtetuar se nuk rezulton nga vepra penale, i kthehen pronarit të pronës, dhe rriten sipas shkallës së interesit në vend në pajtim me periudhën përkatëse të kohës.

Pas zbritjes së shpenzimeve të menaxhimit të pronës së konfiskuar dhe zgjidhjes së ankesave civile të personit që i është shkaktuar dëmi, fondet e nxjerra përmes shitjes së pronës së konfiskuar përhershëm, paguhen në buxhetin e Republikës së Serbisë, dhe nga 20% i shpërndahen secilës: gjykatës, prokurorisë publike, Njësisë, dhe Autoritetit për financimin e punës së tyre. Fondet e mbetura përdoren për financimin e kujdesit shoqëror, shëndetësor, arsimor, dhe institucioneve tjera në pajtim me aktin përkatës të Qeverisë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar me synim konfiskimin e pronës që rezulton nga vepra penale realizohet në bazë të traktateve ndërkombëtare ose dispozitave të këtij ligji, nëse nuk ekziston traktati i tillë. Bashkëpunimi ndërkombëtar përfshin ndihmën në zbulimin e pronës që rezulton nga vepra penale, ndalimin e posedimit dhe konfiskimin e përkohshëm ose të përhershëm të pronës që rezulton nga vepra penale.

Parakushtet për ofrimin e ndihmës janë:

- 1) që masa e kërkuar nuk është në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik vendor;
- 2) që plotësimi i kërkesës së agjencisë së huaj nuk do të kishte ndikim në sovranitetin, politikat publike ose interesit tjerë të Republikës së Serbisë;
- 3) që të përmbushen standardet e gjyqimit të drejtë për marrjen e vendimit për konfiskim të përhershëm të pronës në procedurën e huaj.

*Arsyet për miratimin e ligjit*

Ky Ligj ka hyrë në fuqi më 1 mars 2009. Serbia dhe ish Jugosllavia gjithmonë kanë pasur dispozita që rregullojnë marrjen e asetëve të fituara përmes veprimtarisë kriminale. Sidoqoftë, me qëllim që të konfiskohen asetet e tilla ishte e nevojshme të ofrohen dëshmi se asetet janë pasojë e drejtpërdrejtë e veprës konkrete penale ose se është përdorur me qëllim të kryerjes së krimit konkret. Për shembull, shitësi i drogës, i dënuar për shkak të tregtisë së paligjshme vlera e së cilës është 300.000 euro, mund ta mbante pjesën tjetër të pasurisë të paprekur, meqë prokurorët dhe policia nuk mund të gjenin dëshmi që pjesa tjetër e pronës së tij (vlera e së cilës p.sh. është 3.000.000 euro) gjithashtu ka prejardhje përmes veprimtarisë së paligjshme.

Ky ligj në mënyrë efektive po e kthen barrën e provës. Është personi i dyshuar ose i dënuar ai që duhet të ofrojë dëshmi se prejardhja e pasurisë është e ligjshme. Praktikisht, shitësi i drogës nga rasti i lartpërmendur do të duhej të provojë se ai ka fituar pronën prej 2.700.000 euro në mënyrë të ligjshme. Për më tepër, të provuarit e tillë do të mund të kërkohej nga personat tjerë të lidhur me të, p.sh. ata tek të cilët personi i dyshuar, akuzuar ose dënuar e ka transferuar pronën.

Ligji është kundërshtuar para Gjykatës Kushtetuese, por gjithashtu edhe gjatë procesit të hartimit dhe miratimit. Gjykata Kushtetuese e Serbisë në qershor 2011 vendosi se disa dispozita të kundërshtuara të këtij ligji janë në pajtim me aktin më të lartë ligjor të vendit. Vendimi nuk merret me nenin që rregullon barrën e provave, por vetëm me ligjshmërinë e marrjes dhe konfiskimit të përkohshëm dhe të përhershëm.

*Ligji për organizimin dhe juridiksionin e autoriteteve qeveritare në luftimin e krimit të organizuar*

Veprimtaria e autoriteteve shtetërore në këtë drejtim ka filluar diku para vrasjes së Kryeministrit Zoran Djindjic, dhe ishte shkak i drejtpërdrejtë për vrasje. Nga pjesa e dytë e vitit 2002, kur filloi puna, deri më tani, mund të vërehen rezultate të mëdha në aspektin normativ: a) është miratuar legjislacioni i ri i rëndësishëm penal, duke vendosur disa krime të reja për krimin e organizuar; b) më 2002, është shtuar kapitulli i ri (XXIX/a) në Kodin Penal të 2001 – ky rregullon instrumentet procedurale për luftën kundër krimit të organizuar; c) është miratuar statuti i ri i veçantë për organizimin e autoriteteve shtetërore (prokurorinë publike, policinë dhe gjykatat) për ta luftuar krimin e organizuar (më 19 korrik 2002). Një vit pas kësaj, është themeluar departamenti i veçantë në Ministrinë e Brendshme për ta luftuar krimin e organizuar (UBPOK). Brenda një kohe të shkurtër, janë ratifikuar disa konventa ndërkombëtare, përfshirë Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërshtetëror, Konventën Evropiane për Parandalimin e Pastrimit të Parave, dhe të gjitha konventat përkatëse për ndihmën juridike ndërkombëtare, ekstradimin, transferimin e rasteve penale, etj. Janë miratuar statute të nevojshme kundër korrupsionit e që rregullojnë: parandalimin e konfliktit të interesit, qasjen në informata të rëndësishme publike, prokurimin publik, etj. Qeveria ka formuar Këshillin e "saj" për Luftën kundër Korrupsionit, i cili, në disa raste, ka provuar pavarësinë e tij nga qeveria.<sup>29</sup>

Ligji për organizimin dhe juridiksionin e autoriteteve qeveritare në luftimin e krimit të organizuar është botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë" Nr. 42/02, 27/03, 39/03, 67/03, 29/04, 58/04, 45/05, 61/05<sup>30</sup>.

Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, juridiksionin dhe kompetencat e organeve të veçanta qeveritare për zbulimin dhe përndjekjen e kryesve të veprave penale të parapara në këtë ligj. Krim i organizuar në dritë të këtij ligji përcaktohet "ekzekutimi i veprave penale nga grupi i organizuar kriminal ose grup tjetër i organizuar ose anëtarët e tjerë, për të cilët dënimi i paraparë është burgimi me katër vjet ose më shumë". Grupi i organizuar kriminal përbëhet nga grupi prej tre ose më shumë personave, i cili ekziston për një periudhë të caktuar kohore, vepron në pajtim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë veprave penale për të cilat dënimi i parashikuar është katër vjet burgim ose më shumë, me qëllim që drejtpërdrejtë ose tërthorazi të përfitojnë financiarisht ose përfitim tjetër parash. Grupi tjetër i organizuar përkufizohet si grup që nuk formohet me objektivin përfundimtar të kryerjes së veprave penale dhe që nuk ka strukturë të tillë të zhvilluar organizative, rolet e përkufizuara dhe vazhdimësinë e anëtarësisë, por është në shërbim të krimit të organizuar.

Autoritetet për luftimin e krimit të organizuar janë: Prokuroria e Veçantë, Njësia e Veçantë Policore, Njësia e Veçantë Gjyqësore, dhe Njësia e Veçantë e Paraburgimit.

Fillimisht, Prokurorisë Publike të Qarkut në Beograd i është dhënë juridiksioni për territorin e Republikës së Serbisë t'i procedojë veprat penale të krimit të organizuar. Prokurori i veçantë emërohet nga Prokurori Publik Republikan, nga mesi i prokurorëve dhe zëvendës-prokurorëve publikë që i plotësojnë kushtet për emërim si Prokuror Publik i Qarkut, me pëlqim të shkruar të të emëruarit. Prokurori Publik Republikan, në vijim të rekomandimit nga Prokurori i Veçantë, mund ta dërgojë prokurorin ose zëvendës-prokurorin publik në Prokurorinë e Veçantë. Nëse kërkohet për arsye të zhvillimit të procedurës penale, Prokurori i veçantë mund t'i kërkojë organit kompetent qeveritar ose organizatës që përkohësisht ta emërojë një person nga organi ose organizata e tillë në Prokurorinë e Veçantë. Zyrtari i emëruar nga organi ose organizata e tillë pa vonesë merr vendim lidhur me kërkesën e Prokurorit të Veçantë. Dërgimi bëhet me pajtimin e nëpunësit.

Është themeluar edhe Shërbimi i Veçantë për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit si pjesë e Ministrisë së Brendshme për të kryer detyra të zbatimit të ligjit lidhur me veprat penale të krimit të organizuar. Shërbimi vepron me kërkesë të Prokurorisë së Veçantë, në pajtim me ligjin. Ministri përgjegjës për çështjet e brendshme emëron dhe shkarkon zyrtarin komandues të Shërbimit pas mendimit të Prokurorit të Veçantë dhe përcakton veprimtarinë e Shërbimit, në pajtim me këtë Ligj. Ministri përgjegjës për çështjet e brendshme mund të vendosë ta caktojë një njësi organizative të Ministrisë së Brendshme – Xhandarmërinë në parandalimin dhe zbulimin e aktit kriminal të terrorizmit.

<sup>29</sup> Prof. Dr. Momcilo Grubac in THE FIGHT AGAINST ORGANISED CRIME IN SERBIA From the Existing Legislation to a Comprehensive Reform Proposal Belgrade 2008 Page 43.

<sup>30</sup> Translation used: [http://www.mpravde.gov.rs/images/17\\_laë\\_on\\_organized\\_crime.pdf](http://www.mpravde.gov.rs/images/17_laë_on_organized_crime.pdf)



Të gjitha organet dhe shërbimet qeveritare, sipas kërkesës së Prokurorit të Veçantë ose Shërbimit pa vonesë do të: mundësojnë përdorimin e çfarëdo mjeti teknik në disponim të tyre; sigurojnë përgjigje me kohë të anëtarëve dhe nëpunësve të tyre, përfshirë eprrorët e organeve ose agjencive; të japin informata ose të marrin në pyetje si të dyshuar ose dëshmitar; i dorëzojnë Shërbimit çdo dokument ose dëshmi tjera në posedim të tyre, ose të dërgojnë informata që mund të ndihmojnë në zbulimin e veprave penale ose krimin të organizuar.

Gjykata e Qarkut në Beograd ka juridiksion të shkallës së parë për territorin e Republikës së Serbisë në rastet penale ose krimin e organizuar. Gjykata e Apelit në Beograd ka juridiksion të shkallës së dytë. Gjykata Supreme e Serbisë vendos në konfliktet e juridiksionit ndërmjet gjykatave të rregullta në rastet penale lidhur me zbatimin e këtij ligji.

Po ashtu është themeluar Departamenti i Veçantë për procedimin e rasteve penale të krimin të organizuar (Departamenti i Veçantë i Gjykatës së Qarkut) brenda Gjykatës së Qarkut të Beogradit. Kryetari i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut menaxhon punën e Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut. Kryetari i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut emërohet nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut të Beogradit nga mesi i gjyqtarëve të caktuar në Departamentin e Veçantë të Gjykatës së Qarkut.

Është themeluar njësia e veçantë e paraburgimit në Burgun e Qarkut të Beogradit për paraburgimin e shqiptuar në procedurë penale për veprat e krimin të organizuar (me tej Njësia e Veçantë e Paraburgimit). Ministri përgjegjës për çështjet gjyqësore përcakton organizimin, punën dhe trajtimin e të paraburgosurve në Njësinë e Veçantë të Paraburgimit, në pajtim me Ligjin për Procedurë Penale dhe Ligjin për Zbatimin e Sanksioneve Penale.

Për veprat penale të krimin të organizuar zbatohen dispozitat e Ligjit të Procedurës Penale ndaj veprave penale të krimin të organizuar, derisa nuk rregullohet ndryshe nga ky ligj. Prokurori i veçantë dhe prokurori i autorizuar, personi i akuzuar dhe avokati i tij, dhe pala e dëmtuar dhe i autorizuari i tij, mund të propozojnë dëshmi të reja, më së voni para kalimit prej 30 ditësh nga nxjerrja e vendimit për ndërmarrjen e hetimit. Pas kalimit të kohës, gjyqtari hetues i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut, në seancën përfundimtare për regjistrimin e dëshmimeve i regjistron dëshmitë që do të paraqiten gjatë hetimit. Të gjitha kundërshtitë procedurale dhe të tjera që i referohen fazës së procedimit penal duhet të regjistrohen në atë seancë. Përrjashtimisht, dëshmitë e reja propozohen dhe të ngritën kundërshtimet pas kalimit të kohës, nëse dëshmitë nuk kanë ekzistuar më parë ose askush nuk ka ditur për to. Gjyqtari hetues i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut vendos për këtë me vendim.

E drejta për t'i ekzaminuar dosjet mund të ushtrohet nga koha e nxjerrjes së vendimit për ndërmarrjen e hetimit. Sidoqoftë, gjyqtari hetues i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut mund të vendosë, me vendim, se e drejta nga paragrafi 1 do të përdoret nga momenti pas dëgjimit të të gjithë të dyshuarve të përfshirë në kërkesë për ndërmarrjen e hetimit. Kundërshtimi ndaj këtij vendimi mund t'i dërgohet kryetarit të Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut i cili mund të vendosë për kundërshtimin brenda 48 orësh.

Gjykimi regjistrohet me zë dhe regjistrimi përmban tërë gjykimin, si dhe regjistrimet e formës së shkruar përfshirë të dhënat për fillimin dhe mbarimin e gjykimit, pjesëmarrësit e tashëm dhe dëshmitë e paraqitura, si dhe vendimet e kryetarit të panelit lidhur me menaxhimin e procedurës. Regjistrimi me zë transkriptohet brenda 72 orësh dhe paraqet një pjesë të regjistrimit të mbajtur në formë të shkruar. Regjistrimi me zë dhe transkriptet mbahen në të njëjtën mënyrë si regjistrimet në formën e shkruar.

Gjyqtari hetues i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut, domethënë kryetari i panelit të Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut mund të paguajë dëshmitë e ekspertëve dhe interpretuesve në shumën e dyfishtë të shumës që ata do të merrnin në vepra tjera penale.

Gjyqtari hetues i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut zotohet të urdhërojë kohën për kryerjen e ekspertizës dhe dërgimin e gjetjeve dhe raporteve. Koha nuk mund t'i kalojë 90 ditë. Në rast të mosrespektimit të kohës, gjyqtari hetues i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut, domethënë kryetari i panelit të Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut, dënon me gjobë ekspertin dëshmitar.

Nëse përsëri nuk respektohen afatet kohore gjatë vitit të njëjtë kalendarik, kryetari i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut mundet, përveç gjobës, t'i propozojë Ministrin të Drejtësisë t'i shlyejë emrat e atyre ekspertëve dëshmitarë nga lista me ndalim të përkohshëm të kryerjes së profesionit të tyre në kohën prej tri vjetësh.

Kur nuk është e mundur të sigurohet prania e dëshmitarit ose palës së dëmtuar në seancën kryesore, ata do të ekzaminohen duke përdorur video-konferencën. Ekzaminimi në këtë mënyrë i dëshmitarëve dhe palës së dëmtuar po ashtu bëhet përmes ndihmës ligjore penale ndërkombëtare. Sipas propozimit të arsyetuar të palës së interesuar, gjykata mund të vendosë për mbrojtjen e të dhënave personale të dëshmitarit ose palës së dëmtuar.

Personave që mbajnë pozita dhe/ose angazhohen në detyra dhe punë në njësitë e veçanta organizative, të përcaktuara sipas këtij Ligji, u kërkohet, para se ta marrin detyrën, të dërgojnë me shkrim të dhëna të sakta dhe të plota për statusin e tij/saj financiar dhe statusin financiar të bashkëshortit, të afërmve me lidhje gjaku, dhe marrëdhëniet anësore të gjakut deri në shkallën e tretë, dhe të afërmve nga martesat deri në shkallën e dytë të lidhjes, në pajtim me aktin e nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Serbisë. Këto të dhëna paraqesin sekret zyrtar. Verifikimi dhe kontrollimi i statusit financiar i personave mund të bëhet pa dijeninë e këtyre personave para emërimit, gjatë kohës sa shërbejnë dhe gjatë një viti pas mbarimit të shërbimit, në pajtim me aktin e Qeverisë së Republikës së Serbisë.

Të gjithë personat e angazhuar në detyra brenda fushëveprimit të autoriteteve qeveritare lidhur me luftimin e krimit të organizuar i trajtojnë të gjitha informatat dhe të dhënat, për të cilat janë vënë në dijeni gjatë kryerjes së këtyre detyrave, si sekret zyrtar. Prokurori i Veçantë, Kryetari i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Qarkut, Kryetari i Departamentit të Veçantë të Gjykatës së Apelit, dhe komanduesi i Shërbimit, përcaktojnë aktin e sekreteve zyrtare lidhur me organet që ata menaxhojnë.

Zbatimi filloi nga 28 shkurti 2003.

*Gazeta zyrtare nr. 72/2009 – ndryshimet e Ligjit*

Ndryshimet që hynë në fuqi plotësisht nga 1 janari 2010 ofrojnë ndryshime në disa fusha. E para është krijimi i kompetencës së organeve të specializuara në rastet kur nuk ka element të krimit të organizuar, por personi i dyshuar për veprën penale të korrupsionit është zyrtar publik i rangut të lartë ose në rastet kur të hyrat nga krimi i organizuar janë përafërsisht 2 milionë euro ose më shumë.

Ndryshimet tjera lidhen me organizimin e organeve gjyqësore. Në vend të prokurorisë publike të qarkut në Beograd, me prokurorinë e saj të veçantë, ekziston njësia e veçantë – Prokuroria për krimin e organizuar. Ngjashëm, juridiksioni i gjykatave ndryshon (p.sh. më lart sesa gjykata e qarkut).

Ndryshime tjera të rëndësishme lidhen me kohën e prokurorit të veçantë dhe zëvendësve të tij, si dhe për detyrën e policisë që menjëherë ta informojnë prokurorin publik për të gjitha rastet kur dyshohet për vepra penale të mbuluara nga ky ligj.

#### *Kodi i Procedurës Penale*

Kodi i Procedurës Penale ("Gazeta Zyrtare e IRJ-së 70/2001 dhe 68/2002 dhe "GZ e RS", 58/2004, 85/2005, 115/2005, 85/2005, 49/2007, 20/2009, 72/2009 dhe 76/2010) parasheh teknika të veçanta hetuese për rastet e krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda. Ndryshe nga veprat tjera të krimit të organizuar, të përkufizuara ngjashëm si në legjislacionin tjetër të cituar, teknikat e veçanta mund të zbatohen për rastet e shpërdorimit të pushtetit, tregtimi i ndikimit, dhënia dhe marrja e ryshfetit, edhe nëse s'ka element të krimit të organizuar. Krime tjera të rënda, për të cilat këto dispozita mund të zbatohen, përfshijnë veprat penale të vrasjes, pengmarrjes, grabitjes, falsifikimit të parave, pastrimit të parave, veprat lidhur me narkotikët, kontrabandimi i njerëzve, terrorizmi ndërkombëtar, etj. Po ashtu mund të zbatohen edhe në rastet e krimeve të luftës.

#### **Vëzhgimi i fshehtë me zë dhe pamor i të dyshuarit**

Duke vepruar sipas kërkesës së shkruar dhe të arsyetuar të Prokurorit Publik, Gjyqtari Hetues mund të urdhërojë vëzhgimin dhe regjistrimin e bisedave telefonike dhe të tjera ose komunikimin me mjete tjera teknologjike dhe videoregjistrimin ose vendndodhjen si dhe vëzhgimin elektronik të personave për të cilët ka bazë dyshimi për ndonjë nga veprat e lartpërmendura.

Masat urdhërohen nga Gjyqtari Hetues me propozim të Prokurorit Publik, në urdhër të shpjeguar. Urdhri përfshin të dhënat për personin kundër të cilit zbatohen masat, bazat e dyshimit, mënyra e zbatimit, fushëveprimi dhe kohëzgjatja e masës. Masat mund të zgjasin deri në tre muaj dhe për shkak të arsyeve të rëndësishme mund të zgjasin edhe për tre muaj shtesë. Zbatimi i teknikës së veçantë hetuese, ose masave nga të cilat ajo përbëhet, mbarojnë menjëherë sapo të pushojë nevoja për zbatimin e tyre. Urdhri i Gjyqtari Hetues zbatohet nga policia, Agjencia Informativ-Sigurisë, ose Agjencia Ushtarake e Sigurisë. Kompanitë dhe entitetet postare, telegrafike dhe ndërmarrjet

tjera të regjistruara për transferimin e informatave, kanë detyrim t'i mundësojnë policisë dhe organeve tjera t'i zbatojnë teknikën e veçanta të hetimit. Regjistrimet, sipas urdhrit të Gjyqtarit Hetues, mund të bëhen në banesa, ndërtesa tjera, ose në vend të hapur. Pas përfundimit të teknikës së veçantë hetuese, autoriteti që zbatoi urdhrin, pa vonesë dërgon raportin dhe regjistrimin tek Gjyqtari Hetues. Gjyqtari Hetues mund të urdhërojë transkriptimin dhe përshkrimin e të gjitha ose ndonjë pjese të regjistrimit të nxjerrë nga përdorimi i mjeteve teknike. Gjyqtari Hetues fton Prokurorin Publik që të njihet me materialin e nxjerrë nga përdorimi i teknikës së veçantë hetuese.

Teknika tjera të veçanta hetuese, ku përdoren rregulla të ngjashme si për veprat e lartpërmendura janë:

- Paraqitja e shërbimeve të simuluar të biznesit dhe përfundimi i çështjeve të simuluar ligjore
- Dërgesa e kontrolluar
- Kërkimi automatik i kompjuterizuar i të dhënave personale dhe tjera
- Angazhimi i agjentit të fshehtë.

Teknikë veçanërisht e rëndësishme është **Ekzaminimi i dëshmitarëve bashkëpunues**. Prokurori Publik mund t'i propozojë gjykatës ekzaminimin e një personi në cilësinë e dëshmitarit për të cilin ka dyshim të bazuar se ai është anëtar i organizatës kriminale dhe i cili shprehimisht e ka pranuar këtë, kundër të cilit është nxjerrë urdhëri i hetimit ose është ngritur akuza e drejtpërdrejtë për veprën krimi i organizuar për të cilën ai është rrëfyer në tërësi dhe rrëfimi i tij është vërtetuar me dëshmi tjera.

Që një person të bëhet dëshmitar bashkëpunues, ai duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme: se kjo është e përshtatshme në vështrim të natyrës dhe rrethanave të veprës penale për të cilën ai dyshohet se e ka kryer; që ka arsye të pritet se rëndësia e dëshmisë së tij për zbulimin, provimin ose parandalimin e veprave tjera nga organizata kriminale është më e madhe se efektet dëmtoese të veprës penale të cilën ai dyshohet se e ka kryer; se, në vështrim të fakteve ekzistuese, ka arsye për të besuar se përcaktimi i fakteve të rëndësishme në procedurën penale do të ishte i pamundur ose shumë i vështirë nëse dëshmitari bashkëpunues nuk i ekzaminon.

## Zbatimi i ligjeve dhe efektet e arritura në praktikë

Sipas Strategjisë Kombëtare për Luftimin e Krimit të Organizuar (29 mars 2009), vlerësimi se cilat janë format më të shpeshta të krimit të organizuar në Republikën e Serbisë, janë: trafikimi i drogës, korrupsioni, trafikimi i njerëzve, pastrimi i parave.

Viteve të fundit ka përparim, veçanërisht në fushën e luftës kundër keqpërdorimit të drogës. Teknikat e veçanta hetuese, si masat e vëzhgimit të fshehtë dhe dërgesat e kontrolluara, janë përdorur çdo herë e më shumë nga autoritetet ligj-zbatuese. Si rezultat i bashkëpunimit të mirë ndërmjet agjencive dhe bashkëpunimit policor ndërkombëtar në nivel operacional, kanë vazhduar kapje të mëdha të drogës dhe zbrërthimi i grupeve

të organizuara kriminale. Edhe pse nga homologët ndërkombëtarë njihen përparimet në luftën kundër drogave, Serbia mbetet vend transit për trafikimin e drogave në Evropë. Si provë e bashkëpunimit të mirë është shembulli i një nga rasteve më domethënëse të filluar shkak i bashkëpunimit të mirë ndërkombëtar – rasti "Luftëtari Ballkanik" i cili lidhet me vëzhgimin dhe kapjen e 2.174 kilogramëve kokainë në Urugai më 15 tetor 2009, bashkë me kapjen e 235 kilogramëve kokainë në afërsi të qytetës italiane Pisa më 19 janar 2009. Në këtë rast, më 12 prill 2010 është ngritur akuza kundër 20 individëve, të akuzuar për organizimin e grupit me qëllim të kryerjes së veprës penale si dhe prodhimit, ruajtjes dhe qarkullimit të narkotikëve.

Analiza e punës së kryer nga Prokuroria e Krimit të Organizuar gjatë periudhës nga marsi 2009, kur ligji hyri në fuqi, deri në mars 2010, tregon se Prokuroria ka nisur hetimet financiare kundër 232 personave, ka dorëzuar kërkesën për marrjen e përkohshme të pronës kundër 54 personave, ka kërkuar marrjen e përhershme të pronës kundër 4 personave dhe ka lëshuar urdhër për kufizim me disponimin e aseteve të luajtshme kundër 7 personave. Vetëm për një vit e gjysmë ka pasur rreth 20 vendime për marrjen e përkohshme dhe disa për marrjen e përhershme të aseteve. Drejtorati tani menaxhon asetet e mëposhtme: rreth 70 shtëpi, banesa dhe ndërtesa tjera, 110 makina, 9 hotele dhe restorante dhe 2/3 e një shtëpie pushimi, 1 fermë dhe 44 hektarë të tokës ndërtimore, 1 depo. Gjithashtu, në llogarinë bankare të Drejtoratit dhe Bankës Kombëtare janë përafërsisht 800.000 euro (tetëqind mijë) dhe të hyrat mujore nga qerazimi i pronës së paluajtshme llogariten në përafërsisht 12.000 euro (dymbëdhjetë mijë). Aktualisht, vlera e përgjithshme e aseteve të konfiskuara që menaxhohen nga Drejtorati është përafërsisht **dyqind milionë euro (200.000.000)**.

Gjatë dy viteve të fundit, Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria Publike Republikane kanë nënshkruar disa marrëveshje dypalëshe me homologët e tyre përkatës nga vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe ato të Bashkimit Evropian. Para këtyre nismave, kriminelët shpesh shfrytëzonin institutin tradicional ligjor të mos ekstradimit nga shtetet të shtetasve të vet. Të vendosur me përkushtim që t'i ndjekin të gjithë kriminelët pa marrë parasysh shtetësinë e tyre, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Serbisë filloi një seri të marrëveshjeve dypalëshe të cilat duhet të mundësojnë ekstradimin e shtetasve serbë të cilët kanë kryer vepra penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në qershor 2010, Republika e Serbisë nënshkroi marrëveshje me Republikën e Kroacisë duke dërguar porosi të qartë se çështja e shtetësisë nuk do të shfrytëzohet më si formë e mbrojtjes nga kriminelët. Gjatë javës së parë të nëntorit 2010, do të nënshkruhen marrëveshje të ngjashme me Malin e Zi dhe kontaktet me pjesën tjetër të vendeve të interesuara të Ballkanit Perëndimor janë në vazhdim. Po ashtu, Republika e Serbisë po e tërheqë rezervën e paraqitur në instrumentin depozitues të ratifikimit të Konventës Evropiane për Ekstradimin lidhur me këtë çështje<sup>31</sup>.

Krimet<sup>32</sup> e kryera nga grupet e organizuara kriminale mund të procedohen qoftë nga organet e specializuara që punojnë në këtë fushë ose nga forcat e "rregullta" policore dhe të prokurorisë publike. Domethënë, prokuroria e veçantë për krime të organizuara mund të vendosë që të ngrisë akuzë apo jo për vepra të rënda që përfshijnë elementin e krimit

<sup>31</sup> Teksti nga fillimi i këtij kapitulli deri në këtë pikë rrjedhë nga raporti i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e masave kundër krimit të organizuar në periudhën 2008 – 2010

<sup>32</sup> Teksti deri në fund të këtij kapitulli rrjedhë nga teksti i të njëjti atëherë përgatitur për hulumtimin rajonal për krimin e organizuar, udhëhequr nga Monitori i Rrezikut, Sofje, Bullgari.

të organizuar. Sidoqoftë, për qëllime statistikore, dokumentet e prokurorisë së specializuar janë më të besueshmet, meqë ato qartë duhet të mbulojnë vetëm rastet e krimit të organizuar. Brenda gjashtë vjetësh të prokurorisë së veçantë, janë akuzuar gjithsej 1068 persona për gjithsej 2410 vepra penale brenda 102 dosjeve të veçanta penale.<sup>33</sup>

Grupet më të mëdha individuale janë "veprat kundër paqes dhe rendit publik" (sepse vet organizimi i grupit kriminal është vepër penale) me gjithsej 898 raste (37.26%) dhe krimet kundër detyrës zyrtare me gjithsej 619 raste (25,68%)<sup>34</sup>.

Në 67 raste prokuroria u mor me krime të tilla si vrasje ose dëmtime të rënda trupore, pothuajse të gjitha të filluara në vitin 2003. Ky fakt mund të jetë pasojë e "numrit të errët" të lartë të veprave të dhunshme penale përfshirë vrasjet. Sidoqoftë, mbase ka më shumë të ngjarë se këta numra tregojnë ndryshimet e natyrës së krimeve të kryera nga grupet e organizuara kriminale kohëve të fundit (p.sh. përqendrimi në shpërdorimet financiare më shumë sesa në fushat klasike të krimit të organizuar). Ngjashëm, numri prej 37 krimeve të proceduara për shkak të detyrimit ose rrëmbimit gjithashtu lidhet me vitet e para të punës së prokurorisë së veçantë<sup>35</sup>.

Prokuroria e veçantë është marrë me shumë vepra penale të kryera kundër të drejtave pronësore (gjithsej 221). Në mesin e tyre, akuza vjedhje me armë është më shpeshti e ngritur në vitin 2005, tipet e rënda të vjedhjes në vitin 2006, dhe mashtrimit në vitin 2007. Krimi ekonomik, me gjithsej prej 182 procedura ishte çështje shqyrtimi nga prokuroria e veçantë që nga viti 2005. Krimet më të shpeshta nga kjo kategori ishin kontrabandimi (50), falsifikimi i markave me vlerë (42), falsifikimi i parave (27) dhe shmangia nga tatimi (22)<sup>36</sup>.

Gjithashtu gjatë punës së prokurorisë së veçantë ka pasur 180 raste krimesh që kanë përfshirë prodhimin ose tregtimin e narkotikëve. Shumica ishin nisur gjatë vitit 2003, dhe numrat kanë rënë dukshëm në vitet 2004 dhe 2005 dhe përsëri janë ngritur në vitin 2008<sup>37</sup>.

Brenda grupit të gjerë të veprave penale "kundër rendit publik" (898), shumica i përkasin organizimit kriminal si të tilla. Krimet tjera nga ky grup janë kontrabandimi i njerëzve dhe kalimi i paligjshëm i kufirit (81, shumica në vitin 2006) dhe posedimi i paligjshëm i armëve të zjarrit dhe eksplozivëve (71)<sup>38</sup>.

Falsifikimi i dokumenteve është përndjekur në gjithsej 52 raste. Veprat e ndërlidhura me korrupsionin ishin përndjekur mjaft shpesh (619 raste), në veçanti nga viti 2006. Kjo përfshinë 465 raste të "shpërdorimit të pushtetit", 72 raste të marrjes së ryshfetit, 57 raste të dhënies së ryshfetit, 6 raste të korrupsionit të gjyqtarëve ose prokurorëve, dhe vetëm 2 raste të tregtimit të ndikimit<sup>39</sup>.

<sup>33</sup> Prokuroria e specializuar për krimin e organizuar – Gjashtë vitet e para", Beograd, 2009, faqe 64.

<sup>34</sup> Ibid. p. 65.

<sup>35</sup> Ibid, p. 67

<sup>36</sup> Ibid, p. 70 and 71.

<sup>37</sup> Ibid, p. 72.

<sup>38</sup> Ibid, p. 76.

<sup>39</sup> Ibid. p. 78.

## Rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010

Sektori joformal, i mbushur me dobësitë në politikat e taksave dhe shpenzimeve, si dhe në zbatimin e ligjit, përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, mbetet i madh. Ai zvogëlon bazën e taksave dhe efikasitetin e politikave ekonomike. (Faqe 30, e Raportit të Progresit për vitin 2010).

Ka vazhduar ndërtimi i kapaciteteve kryesisht brenda shërbimeve të specializuara të policisë kriminale të tilla si shërbimet për luftimin e krimin të organizuar, hetimet financiare dhe krimet e teknologjisë së lartë. (Faqe 53, e Raportit të Progresit për vitin 2010)

### 4.3.5. Luftimi i krimin të organizuar dhe terrorizmit

Është arritur përparim i madh në luftimin e krimin të organizuar. Në shtator 2009 është miratuar dhe ka filluar zbatimi i planit të veprimit për ta luftuar krimin e organizuar. Kapacitetet hetuese dhe përdorimi i teknikave të veçanta hetuese janë forcuar edhe më shumë. Ka vazhduar trajnimi i specializuar i shërbimeve përkatëse policore. Ka vazhduar puna, nën udhëheqjen e Prokurorit të Veçantë të Krimin të Organizuar, e njësisë për hetime financiare brenda shërbimit të krimin të organizuar. Konfiskimi i aseteve ka filluar në mënyrë më sistematike dhe konfiskimet janë kryer në numër të madh të rasteve.

Është përmirësuar bashkëpunimi ndërmjet agjencive përkatëse brenda vendit, në rajon dhe në aspektin ndërkombëtar, që ka çuar në rezultate të mira të hetimeve të profilit të lartë kundër grupeve të organizuara kriminale. Në këto raste, një numër i të dyshuarve janë arrestuar dhe janë konfiskuar asetet e fituara paligjshëm. Në tetor 2010 është nënshkruar marrëveshja me Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Kroacinë, Malin e Zi dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, e cila themelon zyrën rajonale në Beograd për përmirësimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimin të organizuar.

Është përmirësuar bashkëpunimi me Eurojust dhe Serbia ka themeluar pika shtesë kontakti. Në maj 2010 është mbajtur takim me përfaqësuesit e Eurojust me qëllim të përgatitjes së negociatave për marrëveshje bashkëpunimi. Mbrojtja e të dhënave personale dhe të dhënave të klasifikuara është kyçe për përmbylljen e suksesshme të marrëveshjes së tillë.

Sidoqoftë, ende nuk është miratuar Kodi i ri i rishikuar plotësisht i Procedurës Penale. Komisioni për Bashkërendimin Ndër-ministror në fushën e Çështjeve të Drejtësisë dhe të Brendshme ka treguar pak aktivitet. Kapaciteti i shërbimeve të specializuara policore për të kryer hetime proaktive dhe të angazhohet në çështje policore të udhëhequra nga inteligjenca, mbetet i kufizuar për shkak të mungesës së stafit dhe mungesës së ekspertizës analitike. Numri i dënimeve përfundimtare mbetet i ulët.

Mungesa e kontrollit përkatës dhe vëzhgimi i vijës së kufirit administrativ me Kosovën

vazhdon të jetë problematik në një fushë që është e cenueshme nga veprimtaria e krimit të organizuar. Bashkëpunimi, zbatimi i protokollit policor dhe shkëmbimi i informatave të rëndësishme me EULEX-in ka nevojë të përmirësohet ende. Ende mungon baza uniforme e të dhënave për rastet e krimit të organizuar. Bashkëpunimi ndërmjet shërbimeve, përfshirë administratën e taksave, doganat, dhe Administratën për Parandalimin e Pastrimit të Parave, ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm. Ka nevojë të përmirësohet mbrojtja e dëshmitarëve. Kapacitetet e kufizuara të agjencisë për menaxhimin e aseteve të marrura dhe vendosja e shpejtë në ankand e aseteve të marrura në mungesë të dënimit ose ndonjë rrezik i përkeqësimit të shpejtë ngrisin disa shqetësime. Në tërësi, Serbia ka filluar t'i adresojë përparësitë e saj në luftimin e krimit të organizuar. Rezultatet aktuale në hetimin e veprimtarisë së krimit të organizuar në nivelin shtetëror dhe ndërkombëtar dhe në konfiskimin e aseteve të fituara paligjshëm janë inkurajuese, por ka nevojë të ndiqen nga procedura transparente, të paanshme dhe efektive në gjyqësi. Kapacitetet e agjencive ligj-zbatuese për të përdorur teknika hetuese moderne, në veçanti në fushën e hetimeve financiare, kanë nevojë të forcohen më shumë (Faqet 54 dhe 55 e Raportit të Progresit për vitin 2010).

## **Roli i Shoqërisë Civile në luftën kundër krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme**

Sipas Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit, organizatat e shoqërisë civile janë akterë të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar. Roli i organizatave të shoqërisë civile, sipas planit të veprimit, është informimi i publikut rreth rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar, ngritja e vetëdijes publike për rreziqet nga krimi i organizuar, ndërtimi i mekanizmave të besueshëm për mbrojtjen e qytetarëve që i raportojnë veprat penale të krimit të organizuar, pjesëmarrja e përbashkët në projektet që synojnë arritjen e qëllimeve të Strategjisë<sup>40</sup>

<sup>40</sup> Burimi i informacionit për NBI: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/Mesko/235122.pdf>; faqe 243-259



## Përfundime

Krimi i organizuar në Serbi është i pranishëm në të dyja format e tij “klasike”, si krim i dhunshëm, kontrabandimi i narkotikëve, vjedhja e makinave, etj, por gjithashtu edhe në formën e “re”, të organizuar si krim i “jakës së bardhë” lidhur me shpërdorimet e privatizimit, shmangia nga tatimet ose shpërdorimi i burimeve publike. Element domethënës që ka ndikim në nivelin e krimit të organizuar është statusi i vendit transit për disa tipe të veprimtarisë kriminale. Faktor tjetër i rëndësishëm është bashkëpunimi rajonal dhe ndër-shtetëror i grupeve të organizuara kriminale.

Që nga viti 2003 dhe vrasja e Kryeministrit Zoran Djindjic, nga një grup i organizuar kriminal, Serbia ka ndërtuar kornizë të fortë ligjore dhe institucionale për ta luftuar krimin e organizuar, që përfshin organet e veçanta të krijuara (prokuroria, gjykatat, njësitë policore), mundësinë për të përdorur teknika të veçanta hetimi me qëllim të luftimit të krimit të organizuar (vëzhgimi, përdorimi i shërbimeve të simuluar të biznesit dhe përfundimi i çështjeve të simuluar ligjore, dërgesa e kontrolluar, kërkimi i kompjuterizuar automatik i të dhënave personale dhe tjera, angazhimi i agjentëve të fshehtë) si dhe mundësia e dhënies së statusit të dëshmitarit bashkëpunues anëtarit të grupit të organizuar kriminal.

Një mjet tjetër i rëndësishëm për ta luftuar bazën ekonomike të krimit të organizuar, është kthimi i barrës së provave rreth ligjshmërisë së prejardhjes së pronës në rastet kur dyshohet për krim të organizuar dhe mundësia e kryerjes së hetimit financiar efektiv. Kjo u mundësoi organeve shtetërore që në mënyrë efektive t’i marrin dhe konfiskojnë të ardhurat nga krimi por po ashtu edhe pronën tjetër të personave të dyshuar dhe atyre të lidhur me ta, kurdo që nuk ka pasur dëshmi për bazën ligjore të prejardhjes së fondeve.

Përderisa zbatimi i masave të përmendura solli rezultate domethënëse deri tash, ka edhe sfida të reja. Në disa shkallë problemet kanë ngjarë lidhur me bashkëpunimin me vendet tjera, veçanërisht kur vepra penale sipas legjislacionit serb nuk njihet në atë formë gjetiu (p.sh. shpërdorimi i pushtetit lidhur me menaxherët e firmave të sektorit privat), dhe janë bërë përpjekje nga Ministria e Drejtësisë dhe organe tjera të rëndësishme për t’i tejkaluar përmes ndryshimeve në legjislacionin penal dhe marrëveshjeve për bashkëpunim ndërkombëtar.





Turqi

## Vlerësimi mbi nivelin e krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme

### Situata e përgjithshme në Turqi

Krimi i organizuar është një aktivitet fitimprurës, i cili ndikon në jetën ekonomike, politike dhe sociale. Korrupsioni, kontrabanda, trafikimi dhe pastrimi i parave kanë ndikim negativ mbi stabilitetin politik, ekonomik dhe social të vendeve.

Burimet kryesore të të ardhurave ilegale në Turqi janë të lidhura me trafikimin e drogës, por gjithashtu edhe me kontrabandën, mashtrimet dhe falimentimet, falsifikimin e dokumenteve, grabitjet, plaçkitjet dhe kidnapimet në autostradë dhe krimet serioze kundër shtetit. Metodot primare për pastrimin e fondeve janë transferet e parave dhe transaksionet tjera bankare, transaksionet komerciale, transaksionet e llogarive dhe blerja e pronës së paluajtshme<sup>41</sup>.

Vlerësimi i Europolit "Kërcënimi i Krimit të Organizuar 2011" tregon se Turqia është një pikë kryesore tranzitore në BE për emigrimin ilegal. Hyrjet ilegale të emigrantëve nga Turqia janë rritur për mbi 500 % në mes të viteve 2009 dhe 2010. Raporti tregon se kjo rritje e rëndësisë së Turqisë si pike kyçe për emigrantët ka gjasë të shfrytëzohet nga grupet e krimit të organizuar turk, të cilët tashmë janë jashtëzakonisht të aftë në menaxhimin e rrugëve për produktet e paligjshme.

Përveç pozitës gjeostrategjike, Turqia ka gjithashtu histori të nëntokës kriminale të rrënjosur thellë dhe kontrabandës e cila e bënë edhe më të vështirë luftimin e këtyre aktiviteteve ilegale. Me qëllim të ndryshimit të këtij roli, Turqia ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në vitet e fundit edhe në nivelin lokal edhe në atë ndërkombëtar. Ky dokument analizon këto ndryshime legale së bashku me rezultatet në realitet dhe problemet me zbatimin që lidhet me vlerësimin dhe raportin e progresit të Komisionit Evropian dhe Task Forcës së Veprimit Financiar.

## Baza ligjore dhe ndarja e përgjegjësive për institucionet

### Krimi i Organizuar

Me legjislacionin turk, krimi i organizuar është i ndarë në dy grupe: ato të kryera për qëllime terroriste dhe ato për përfitime të paligjshme. Ky punim fokusohet në ato që kërkojnë përfitime jo të ligjshme. Ky lloj i krimit përfshinë kontrabandën, trafikimin e drogës, armëve dhe arit, pastrimin e parave, trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigrantëve, trafikimin e organeve dhe indeve, falsifikimet dhe krimet financiare (subvencionet, korrupsioni në prokurime dhe kreditë, etj.). Në Kodin Penal turk (Ligji Nr. 5237) termi "kriminel i organizuar" definohet si "personi i cili organizon, administron, përfshihet apo kryen vet apo në bashkëpunim në emër të një organizate.

Termi "krim i organizuar" është përdorur në vende të ndryshme në Kodin Penal. Neni Nr. 78 i përcakton dënimet për formimin e grupeve kriminale për kryerjen e krimeve

<sup>41</sup> FATF, 2007 Vlerësimi për Turqinë

kundër njerëzimit dhe gjenocidin. Në një numër nenesh, organizatat e krimit janë përmendur për të shtuar dënimet për krimet e kryera. Për shembull, sipas Neni 79/2 dënimi për trafikimin e emigrantëve u ngarkohet për gjysmë në rast të kryerjes së këtyre shkeljeve brenda kornizës së aktiviteteve të një grupi të organizuar kriminal. Ngjashëm, dënimet për kërcënime (5237/106-d), vjedhjet e kualifikuara (5237/142-3), plaçkitjet e kualifikuara (5237/149-f), depozitimi apo shpërndarja e substancave të rrezikshme pa leje (5237/174-2) dhe prodhimi apo shitja e drogave që shkaktojnë varësinë/kënaqësinë apo qetësimin (5237/188-5) rritet në rast se krimi është kryer nga një organizatë kriminale.

Neni kryesor në Kodin Penal turk mbi krimin e organizuar është Neni 220 mbi "Formimin e grupeve kriminale me qëllim të kryerjes së krimeve". Sipas Neni 220, kush formon apo drejton grupe të organizuara për të kryer veprime të cilat definohen si shkelje sipas ligjit, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet në mos ky grup i organizuar vëzhgohet që të cilësohet se kryen shkelje duke pasur parasysh strukturën, numrin e anëtarëve, mjetet dhe pajisjet në dispozicion për këtë qëllim. Megjithatë, së paku tre anëtar kërkohen për ekzistimin e një grupi të organizuar. Ata që bëhen anëtarë të një grupi të organizuar me qëllimin për të kryer krime dënohen me dënim me burgim nga një deri në tri vite.

Në rast se grupi i organizuar kriminal është i pajisur me armë, dënimi që caktohet rritet nga  $\frac{1}{4}$  në  $\frac{1}{2}$ . Në rast të kryerjes së një krimi brenda një kornize të aktiviteteve të një grupi të organizuar, shkelësit i shtohet dënimi për këtë krim. Drejtuesit e grupeve kriminale të organizuara u shtohet dënimi për të gjitha shkeljet e bëra brenda kornizës së aktiviteteve të grupit të organizuar. Çdo person i cili kryen një shkelje në emër të grupit të organizuar kriminal pa qenë anëtarë i atij grupi i shtohet dënimi duke qenë si anëtarë i grupit të organizuar. Çdo person i cili me dëshirë dhe me vetëdije e ndihmon një grup të organizuar kriminal ndonëse nuk është pjesë e strukturës hierarkike të grupit, dënohet sikur të ishte anëtarë i grupit të organizuar. Në fund, çdo person i cili bënë propaganda duke e lëvduar grupin e organizuar kriminal dhe qëllimin e tij dënohet me dënim prej një deri në tri vite. Dënimi i vënë rritet për  $\frac{1}{2}$  në rast të kryerjes së kësaj shkeljeje përmes organeve të shtypit apo atyre transmetuese.

Kodi i Procedurës Penale cili përcakton kompetencat në lidhje me kryerjen e hetimeve kriminale, duke mbuluar çështje të tilla si kërkimi, ndërprerja e komunikimit, mbulimin e mbikëqyrjes dhe ekzaminimin fizik, ka hyrë në fuqi me 1 qershor 2005. Prandaj, nëse ka bazë të fuqishme për dyshim se krimi për "formimin e një organizate për kryerjen e krimeve" është kryer, pastaj "baza për arrest me një dëshmitarë" mund të mendohet si ekzistuese<sup>42</sup>. Kodi lejon gjykatësin apo, në rast të rrezikut për vonesë, prokurorin publik, të vendosë që t'a lokalizoj, ta dëgjoj apo regjistroj korrespondencën përmes telekomunikimit apo ta vlerësoj informacionin rreth shenjave për të dyshuarin apo të akuzuarin nëse gjatë hetimit apo ndjekjes të bërë në lidhje me krimin ka bazë të fortë të dyshimit se krimi është kryer dhe se nuk ka mundësi tjera për të marrë evidencë. Prokurori publik do ta dorëzoj vendimin e tij menjëherë tek gjykatësi për aprovimin e tij dhe gjykatësi do të marrë një vendim brenda 24 orëve. Në rastet kur kohëzgjatja skadon apo gjykatësi vendos në mënyrë të kundërt, masa do të ngritet nga prokurori publik menjëherë. Vendimi për masat mund të jepet për një kohëzgjatje mak-

<sup>42</sup> Neni Nr. 100 i Kodit të Procedurës Penale

simale prej tre muajsh dhe gjykatësi mund të vendosë ta shtyj kohëzgjatjen disa herë, secilën here jo më tepër se një muaj, nëse shihet e nevojshme.

Vendimet e shpallura dhe ndërveprimet e bëra sipas këtij neni do të mbahen konfidenciale derisa masa është në pritje<sup>43</sup>.

Kodi i lejon gjykatësit, apo në rast rreziku për vonesë, prokurorit publik të autorizoj shërbyesit civil të veprojnë si hetues sekret, në rastet ku ka shenja të forta të dyshimit se krimi që është duke u hetuar është kryer dhe nëse nuk ka mjetet tjera në dispozicion për të gjetur fakte. Agjenti sekret është i obliguar që të kryej çfarëdo hetimi në lidhje me organizatën, aktivitetet për të cilat ai është caktuar, gjithashtu hetimet në lidhje me krimin e kryer brenda aktiviteteve të kësaj organizate<sup>44</sup>.

Nëse ka bazë të fortë të dyshimit se formimi i organizatës kriminale është kryer dhe nëse nuk ka mjete tjera për të gjetur fakte, aktivitetet e të dyshuarit apo akuzuarit të kryera në sfera të hapura të publikut dhe vendit të tij të punës, mund të jetë subjekt i vëzhgimit me mjete teknike, duke përfshirë zërin dhe regjistrimin e pamjeve<sup>45</sup>.

Rastet e lidhura me krimet për krijimin e organizatave kriminale gjykohen nga gjykatat penale. Megjithatë, Neni 250 i Kodit të Procedurës Penale përcakton masat specifike për krimet e kryera duke përdorur forcën dhe kërcënimin brenda një organizate të krijuar me qëllim të përfitimeve të padrejta ekonomike; prodhimi dhe shitja e narkotikëve apo substancave stimuluese të kryera brenda aktiviteteve të një organizate kriminale; formimi i grupeve të organizuara kriminale për të kryer shkelje kundër sigurisë kombëtare, rendi kushtetues dhe funksionimi i normave kushtetuese, mbrojtja kombëtare dhe sekretet shtetërore si dhe komploti. Sipas këtij Neni, këto raste do të gjykohen nga Gjykata Penale, e cila me propozim të Ministrisë së Drejtësisë, do të emërohet nga Këshilli i Lartë i Gjykatësve dhe Prokurorëve dhe qarku i këtij dënimi nga kjo Gjykatë Penale do të përfshijë më tepër se një provincë. Ligji gjithashtu përfshinë masa specifike për fazat e hetimit dhe ndjekjes. Hetimi i rasteve, të cilat janë në sferën e Nenit 250 do të udhëhiqen nga prokurorët publik të cilët kanë qenë të autorizuar me detyrën e hetimit dhe ndjekjes së këtyre krimeve nga Këshilli i Lartë i Gjykatësve dhe Prokurorëve.

Për këto raste, periudha normale e arrestimit prej 24 orëve, do të aplikohet 48 orë për individët të cilët janë arrestuar pa një urdhër apo krimet të cilat janë nën fushën e këtij Neni 250<sup>46</sup>. Gjatë ndjekjes, këto krime konsiderohen në mesin e çështjeve urgjente dhe rastet e lidhura me to gjithashtu do të gjykohen gjatë periudhave të pushimeve gjyqësore. Në rastet kur numri i të akuzuarve është shumë i madh dhe një pjesë e tyre nuk është e përfshirë në disa prej seancave dëgjimore të gjykatës, gjykata mund të vendosë t'i organizoj sesionet e tilla në mungesë të tyre. Megjithatë, nëse gjatë sesionit të organizuar në mungesë të tyre, zbulohet një rrethanë e cila ndikon tek ata, pikat kryesore të fjalëve të folura dhe ndërveprimet, gjithashtu edhe çështjet e lidhura me këtë do tu prezantohen në sesionin vijues. Me qëllim të krijimit të sigurisë, gjykata mund të marrë vendim që ta organizoj dëgjimin në një tjetër vend. Gjatë këtyre rasteve, një pjesë e arsyeshme e kohës do ti ofrohet prokurorit publik, palës ndërhyrëse apo përfaqësuesit të

<sup>43</sup> Neni Nr. 135 i Kodit të Procedurës Penale

<sup>44</sup> Neni 139 i Kodit të Procedurës Penale

<sup>45</sup> Neni 140 i Kodit të Procedurës Penale

<sup>46</sup> Neni 251 i Kodit të Procedurës Penale

tij me qëllim të njoftimit për bazën e akuzës; të akuzuarit apo avokatit mbrojtës, me qëllim që ta mbron veten nga akuzat. Kjo periudhë mund të zgjatet me vetë iniciativë në rastet kur përndryshe e drejta për mbrojtje do të kufizohet<sup>47</sup>.

Turqia ka adoptuar Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në vitin 2007<sup>48</sup>. Me qëllim që të kualifikohet nën këtë ligj, krimi ose duhet të jetë dënim për jetë apo mbi 10 vite apo krim për formim terrorist apo krime të organizuara ilegale. Masat për mbrojtjen e dëshmitarit nën këtë ligj përfshijnë ndërrimin e identitetit, adresën, mbrojtjen fizike dhe operacionin plastik për t'ia ndryshuar pamjen fizike.

### **Turqia është nënshkruese e traktateve vijuese ndërkombëtare;**

- Konventës së Kombeve të Bashkuara (KB) Kundër Trafikimit të Paligjshëm të Dro-gave Narkotike dhe Substancave Psikotrope
- Konventa e KB Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtarë (2001) (Konventa e Palermos)
- Konventa e KB Kundër Korrupsionit (e ratifikuar me 2006)
- Konventa Civile Kundër Korrupsionit e Këshillit të Evropës (e ratifikuar me 2003)
- Konventa Penale e Korrupsionit e Këshillit të Evropës (e ratifikuar me 2004)
- OECD Konventa Ndërkombëtare Kundër Mitos (ratifikuar me 2003)

### **Konfiskimi i Pasurisë së Paligjshme**

Ana parandaluese e regjimit turk Kundër Pastrimit të Parave (AML) së pari u themelua përmes Ligjit mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave (Ligji 4208 i 19 Nëntorit 1996), Rregullorja për mbështetjen e këtij ligji dhe për Njësinë e Inteligjencës Financiare Turke -MASAK- Komunikata. Në vitin 2006, Turqia dekretoi një ligj të ri Kundër Pastrimit të Parave (Ligji 5549 i 18 tetorit 2006), i cili zëvendëson dhe fuqizon një numër të madh të dispozitave.

Në 2005, Kodi i ri Penal ishte futur në përdorim në të cilin, Neni Nr. 281 ishte për pastrimin e Pasurive të fituara si rezultat i shkeljeve. Rrjedhimisht, çdo person i cili i përfiton pasuritë si rezultat i një shkelje e cila *kërkon minimumi gjashtë muaj apo më shumë dënim me burgim, apo e bartë atë në një vend të huaj për të qenë subjekt i transaksioneve me qëllim të fshehjes së burimeve ilegale të këtyre pasurive dhe për të dhënë përshtypjen se ato janë përfituar në mënyrë të ligjshme*, dënohet me burgim nga tri deri në shtatë vite, dhe gjithashtu imponohet një gjobë ndëshkimore deri në njëzet-mijë ditë. Çdokush, i cili nuk merr pjesë në kryerjen e krimit, por i blenë apo përdor të ardhurat e krimit me dëshirë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vite. Në rastet kur ky aktivitet është kryer nga një grup i organizuar kriminal, dënimi rritet edhe për një herë.

Ligji Kundër pastrimit të Parave, është shkruar me qëllim të përcaktimit të parimeve dhe procedurave për parandalimin e pastrimit të pasurive nga krimi. Sipas ligjit, çdonjëri i cili punon në fushën e bankave, sigurimeve, tregjeve të kapitalit, huazimit të parave, artefakteve historike apo ndonjë fushe të tillë në të cilën paraja mund të pastrohet është i obliguar që ta identifikon konsumatorin dhe të raporton çfarëdo transaksioni të dyshimtë tek Presidenca e Bordit për Hetimin e Krimeve Financiare e cila vepron nën

<sup>47</sup> Neni Nr. 100 i Kodit të Procedurës Penale

<sup>48</sup> Law No 5276 on Witness Protection

Ministrinë e Financave. Këto palë gjithashtu janë të obliguar të raportojnë çdo transaksion i cili tejkalon shumën e përcaktuar nga Ministria dhe pastaj të ofron të gjitha dokumentet kur ti kërkohet. Ligji i mbron palët e obliguara nga çdo veprim i bërë nën autoritetin e këtij ligji. Pëlqimi i palëve të obliguara sigurohet me autoritetin e Presidencës për të kërkuar një inspektim brenda institucionit dhe inspektorët duhet të raportojnë çdo shkelje të obligimeve tek Presidenca.<sup>49</sup> Gjoha administrative për mospërputhje ndryshon në mes të 2000 deri në 10.000 Lira turke (800 deri 4000 Euro) dhe dënimi gjyqësor është nga një deri në tri vite burgim.<sup>50</sup>

Në rastet e dyshimit, Presidenca raporton rastin tek prokurori. Kodi i Procedurës Penale përcakton procedurat për konfiskim. Konfiskimi mund të kryhet nga anëtarët e forcave të sigurisë me vendim të gjykatësit apo nëse ka rrezik për vonesë, me urdhër të shkruar të prokurorit publik; Në rastet kur nuk është e mundur që të arrihet prokurori publik, me urdhër të shkruar të eprorit të lartë të forcave të sigurisë. Kur konfiskimi realizohet pa mandatin e një gjykatësi, konfiskimi duhet të dorëzohet gjykatësit i cili ka juridiksionin për aprovim brenda 24 orëve. Gjykatësi do ta nxjerr vendimin e tij brenda 48 orëve nga akti i konfiskimit; përndryshe konfiskimi automatikisht do të anulohet. Konfiskimi do ti njoftohet viktimës i cili i ka pësuar humbjet pa vonesë<sup>51</sup>.

Mallrat e palëvizshme, mjetet e transportit tokësor, detar apo ajror, të gjitha llojet e llogarive në banka apo institucione tjera financiare, të gjitha llojet e të drejtave dhe kredive ndaj personave fizik apo juridik, dokumentet e vlefshme, aksionet në firmën ku ai është hisedarë, gjërat në kasafortat e huazuara dhe pasuritë tjera që i takojnë atij mund të konfiskohen në rastet kur ka bazë të fuqishme të dyshimit, duke tentuar të tregohet se krimi nën hetim apo nën ndjekje është kryer dhe se ato janë marrë nga ky krim<sup>52</sup>. Në rastet kur ka bazë të fuqishme të dyshimit se krimi po kryhet brenda aktiviteteve të një kompanie dhe se ka nevojë të zbulohet të vërtetat faktike, gjykatësi apo gjykata është e autorizuar për të caktuar një administrues të besueshëm të kompanisë me qëllim të udhëheqjes së biznesit për kohën sa zgjatë hetimi apo ndjekja.<sup>53</sup>

Turqia është nënshkruese e Konventës mbi Pastrimin, Hulumtimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit (Konventa e Strasburgut). Turqia është anëtarë i Task Forcës për Veprim Financiar (TFVF) dhe Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO).

### **Institucionet Përgjegjëse**

Institucionet kryesore përgjegjëse për luftimin e krimit të organizuar janë policia dhe gjyqësori. Paralel me zhvillimet në fushat e teknologjisë dhe ekonomisë të përjetuara në vitet 90-ta në Turqi, lufta profesionale kundër grupeve të krimit të organizuar të cilat i kanë zgjeruar fushat e aktiviteteve të tyre duke bërë ndryshime në strukturat ekzistuese është udhëhequr që nga viti 1998 nga Departamenti i Luftës Kundër Krimit të Organizuar nën Drejtoratin Gjeneral të Departamentit të Luftës Kundër Kontrabandës dhe Krimit të Organizuar (KOM). Departamenti është përgjegjës për gjurmimin e aktiviteteve të këtyre organizatave, të ndërmer masa paraprake për të shmangur aktivitetet e tyre, të mbledh statistika dhe të

<sup>49</sup> Ligji Nr. 5549 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Produkteve nga Krimi, Kapitulli 2

<sup>50</sup> Ligji Nr. 5549 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Produkteve nga Krimi, Kapitulli 3

<sup>51</sup> Neni 127 i Kodit të Procedurës Penale

<sup>52</sup> Neni 128 i Kodit të Procedurës Penale

<sup>53</sup> Neni 133 i Kodit të Procedurës Penale



zhvillon strategji të reja. Nën KOM, në vitin 2000 është themeluar Akademia Ndërkombëtare e Turqisë për Luftën Kundër Drogave dhe Krimin të Organizuar (TADOC) për të ngritur kapacitetet njerëzore dhe për të shtuar bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar, brenda kornizës së bashkëpunimit Turqi-UNODC. Përgjithësisht, KOM ka afër 6,500 anëtarë dhe 80 nëndivizione në tërë vendin.


Nën gjyqësor, gjykatat penale janë gjykata përgjegjëse që të merren me krimin e organizuar. Rastet e futura në dosje për shkak të (a) Prodhimit dhe tregtisë me narkotik apo substanca stimuluese të kryera brenda aktiviteteve të organizatave kriminale dhe (b) Krimet e kryera duke përdorur forcën dhe kërcënimin brenda një organizate të formuar për të marrë përfitime të jashtëligjshme ekonomike do të gjykojnë nga Gjykata Penale, e cila me propozim të Ministrisë së Drejtësisë, do të emërohet nga Këshilli i Lartë i Gjykatësve dhe Prokurorëve dhe çarku i gjykimit të kësaj Gjykate të Apelit do të mbulojë më tepër se një provincë. Në vitin 2010, kishte 20 Gjykata të Apelit në Turqi.<sup>54</sup>

Njësia e Inteligjencës Financiare turke (FIU) – “Mali Suçlar Araştırma Kurulu (MASAK)” është një pikë kyçe për përpjekjet e AML/CFT-së turke. Sistemi rregullator zbatohet dhe mbikëqyret nga katër agjencione primare; FIU-ja, Agjencioni për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Bankave, Bordi i Tregut të Kapitalit dhe Nën-sekretariati i Thesarit. Sistemi i AML/CFT-së mbikëqyret nga një multi agjencion, Bordi Koordinues për Luftimin e Krimin Financiar.

“MASAK” pranon raporte të dyshimta të transaksioneve dhe i përpunon rastet të cilat i përcillen prokurorit publik për veprim kundër pastrimit të parave. Autoritetet turke për fuqizimin e ligjit kanë kompetenca gjithëpërfshirëse legale për mbledhjen e evidencës dhe imponimin e nxjerrjes së dokumenteve dhe gjithashtu mund të përdorin teknika të hulumtimit special me leje të gjykatësit dhe urdhrin e prokurorit publik.

### Zbatimi i ligjeve dhe efektet e arritura në praktikë

Sipas Raportit të Aktiviteteve të Departamentit të Policisë për vitin 2010 për Kundër Kontrabandë dhe Krim të organizuar, 744 operacione janë realizuar brenda përpjekjeve kundër grupeve të krimit të organizuar në pesë vitet e fundit dhe hetimet e krimit të organizuar janë bërë mbi rreth 12,111 të dyshuar.



*Grafikoni 1: Numri i Operacioneve të Krimin të Organizuar, të Dyshuarit dhe të Arrestuarit përgjatë viteve (Burimi: Raporti Vjetor KOM 2010)*

<sup>54</sup> Raport i Aktiviteteve të Ministrisë së Drejtësisë 2010

Statistika të ngjashme në lidhje me numrin e rasteve të hapura për shkak të krimeve për formimin e organizatave kriminale mbahet nën Drejtoratin e Përgjithshëm të Statistikave dhe Regjistrave Kriminale. Megjithatë, këto statistika nuk ndahen me publikun në faqen e internetit të Drejtoratit dhe me qëllim të marrjes së tyre, një aplikim zyrtar kërkohet një proces i gjatë burokratik.

Vitet/Lloji i aktivitetit ilegal	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Numri i Kontrabanduesve të Drogës	6,121	6,209	6,527	7,493	8,350	7,934	11,109	11,979	17,127	28,734	32,101	31,524
Rastet e Kontrabandimit të Drogës	2,737	2,857	2,952	3,544	4,147	3,736	5,164	5,714	4,850	13,692	15,433	18,073
Rastet e Krimit të Organizuar	191	393	466	514	323	230	328	221	228	167	118	119
Anëtarët e Arrestuar të Krimeve të Organizuara	1,294	2,420	2,676	3,770	2,358	1,755	2,717	2,344	2,957	2,463	2,239	2,200
Rastet e Kontrabandimit me Qenie Njerëzore	-	115	152	331	394	263	-	-	378	375	317	305
Imigrantët Ilegal	-	-	95,524	95,365	78,757	56,219	61,228	57,428	51,983	64,290	62,459	34,345
Rastet e Kontrabandimit të Armëve	227	205	507	206	114	117	255	185	165	144	139	134
Arrestimet e Kontrabanduesve të Armëve	762	650	1064	579	359	341	691	560	647	598	619	196
Rastet e Kontrabandimeve Nukleare	1	1	1	1	1	4	-	1	1	-	-	6
Kontrabanduesit Nuklear	8	6	1	7	-	-	-	-	5	-	-	-
Numri i Trafikantëve me Qenie Njerëzore	-	-	-	-	-	-	227	379	422	308	248	301
Numri i Viktimave të Trafikuara	-	-	-	-	-	-	239	256	246	148	118	102

Grafikoni 4: Numri i Aktiviteteve dhe të Arrestuarve të Krimit të Organizuar, Turqi (1998-2009)


Burimi: Selimoglu, F. H., "Krimi i Organizuar Ndërkombëtar: Si Turqia dhe Be-ja e Luftojnë atë?", Temë e Masterit, 2010

Sa i përket luftës kundër pastrimit të parave, Turqia në përgjithësi i ka kompletuar mekanizmat bashkëpunues ndërkombëtar dhe ka fuqizuar në praktikë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar. Çështjet kryesore të ballafaquara gjatë zbatimit të ligjeve kundër pastrimit të parave janë si vijon:

- Ndonëse autoritetet kompetente janë të afta dhe aktivisht të angazhuara në sistemin kundër pastrimit të parave, prokurorët dhe gjykatësit kanë informacion të kufizuar për sistemin kundër pastrimit të parave;<sup>55</sup>

<sup>55</sup>FATF Vlerësimi për Turqinë, 2007

- Derisa numri i raporteve të transaksioneve të dorëzuara tek MASAK është rritur në mënyrë substanciale, niveli i raportimeve mbetet i ulët kur konsiderohet madhësia dhe natyra e sektorit financiar të Turqisë, sipas FATF.



Grafikoni-2 Numri i transaksioneve të dyshimta të raportuara përgjatë viteve (Burimi: MASAK)

Veç kësaj, shumica e raportimeve vijnë nga bankat (Shiko Grafikonin 3). Nuk ekziston sistem për monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë së palëve tjera të obliguara me kërkesat kundër pastrimit të parave.

Burimet e Raporteve të Transaksioneve të Dyshimta	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Bankat	351	1133	2903	4889	9480	9968
Agjencionet Ndërmjetëse	1	7	40	9	168	28
Ata që operojnë në tregjet e kapitalit	-	-	-	15	32	70
Firmat e Sigurimeve dhe Pensioneve Individuale	-	-	3	10	129	148
Noteritë	-	-	-	1	6	1
Shërbimet Postare	-	-	-	-	6	25
Zyrat e Këmbimit	-	-	-	-	2	11
<b>TOTALI</b>	<b>352</b>	<b>1140</b>	<b>2946</b>	<b>4924</b>	<b>9823</b>	<b>10251</b>

Grafikoni 3: Burimet e Raportimeve të Transaksioneve të Dyshimta përgjatë viteve (Burimi: MASAK)

Përveç numrit të madh të raportimeve, ndjekjet mbesin të ulëta. Në 2009, 23 raste ishin sjellë në prokurori krahasuar me 42 në 2008. Dënimet, konfiskimet, dhe ngrirja e pasurive mbeten të ulëta.

## Rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010

Raporti i Progresit të BE tregon se Turqia është duke punuar për të plotësuar kushtet e anëtarësimit në BE në fushën e luftimit të krimit të organizuar. Turqia ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme sa i përket trafikimit me qenie njerëzore, bashkëpunimin policor me Europol-in, pastrimin e parave, parandalimin e krimit të organizuar dhe trafikimin me njerëz. Përveç kësaj ka pasur edhe ndryshime të rëndësishme ligjore në Turqi në fuqizimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

Megjithatë, sipas raporteve, Turqia akoma ka nevojë për të bërë zhvillime dhe të zbattoj plotësisht marrëveshjet që i ka nënshkruar në nivel lokal.

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian 2010 ka theksuar rëndësinë e Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe zbatimin e tij që nga nëntori i 2008. Që atëherë, është themeluar një departament për Mbrojtjen e Dëshmitarëve brenda policisë turke dhe njësitë e mbrojtjes së dëshmitarëve në 60 provinca.

Në raport është theksuar nevoja për themelimin e bazës së të dhënave të ADN-së dhe shenjave të gishtërinjve. Komisioni e mirëpret ngritjen e kapaciteteve të njësisë speciale i cili punon brenda departamentit për Luftimin e Kontrabandës dhe Krimit të Organizuar. Megjithatë, cilësia dhe besueshmëria tek fuqizimi i ligjit mbetet të zhvillohet. Një çështje tjetër shqetësuese e theksuar në Raportin e Progresit janë edhe mbledhja e të dhënave të besueshme dhe të krahasueshme të nevojshme në lidhje me fuqizimin e ligjshmërisë.


Sa i përket luftës kundër pastrimit të parave, Raporti i Progresit i BE përmend mungesa të veçanta të identifikuar nga FATF të cilat përfshijnë fusha të tilla si penalizmi i financimit të terrorizmit dhe një kornizë ligjore adekuate për identifikimin dhe ngrirjen e pasurive të terroristëve. Turqia akoma nuk e ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës mbi Pastrimin, hulumtimin, konfiskimin e pasurive nga krimi dhe mbi financimin e terrorizmit (CETS 198) ndonëse e ka nënshkruar atë në vitin 2007.

Raporti mirëpret ngritjen e konsiderueshme të numrit të raportimeve të transaksioneve të dyshimta sa i përket pastrimit të mundshëm të parave. Megjithatë, në krahasim me këtë, numri i raportimeve për transaksione të dyshimta sa i përket financimit të terrorizmit u zvogëluar që nga 2008. Raporti gjithashtu vëren se dënimet, konfiskimet dhe ngrirja e pasurive mbeten të ulëta.

## Përfundime

Turqia ka treguar përpjekje të rëndësishme me qëllim të ballafaqimit me problemin në rritje të krimit të organizuar në vitet e fundit. Gjatë procesit të aderimit në BE, një numër i ndryshimeve po bëhet me qëllim të ofrimit të ligjeve turke në linjë me *acquis communautaire*. Këto përfshijnë Kodin e ri Penal të Turqisë, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin mbi Parandalimin e Pastrimit të Pasurive të Fituara nga Veprat Kriminale. Turqia gjithashtu ka nënshkruar shumicën e traktateve ndërkombëtare.

Sa i përket kapaciteteve institucionale, megjithatë, Turqia akoma ballafaqohet me disa sfida. Vlerësimet ndërkombëtare tregojnë se ka një rritje të nevojës për trajnimin e personelit të gjyqësorit për sistemin kundër pastrimit të parave. Përveç kësaj, nevojiten më tepër trajnime për palët e obliguara të cilat janë përgjegjëse për t'i raportuar transaksionet e dyshimta të parave. Zbatimi i ligjeve mbetet joadekuat.



**Maqedoni**

## Ligji dhe praktika në luftimin e krimit të organizuar në Republikën e Maqedonisë<sup>56</sup>

Analiza e strukturës dhe mënyrës se si vepron krimi i organizuar në Republikën e Maqedonisë paraqitet me qëllim të ilustrimit të situatës pas depërtimit të formave të reja të veprimeve kriminale, qëllimi përfundimtar i të cilave janë përfitimet e mëdha të paligjshme. Sidoqoftë, nuk ishte e lehtë të merren të dhëna të sakta nga burimet zyrtare. Në faqen e Ministrisë së Brendshme pjesërisht paraqiten informata lidhur me trafikimin e njerëzve<sup>57</sup>. Botimi më i fundit i Zyrës Shtetërore të Statistikave (ZSHS) nuk përmban ndonjë të dhënë rreth krimit të organizuar dhe kryerësve të tij<sup>58</sup>. Metodologjia dhe emërtimi që ZSHS-ja përdor janë të ndryshme nga ato të Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë.

### Përkufizimi i problemit<sup>59</sup>

Duke shmangur përkufizimin e kësaj dukurie, bashkësia ndërkombëtare miratoi *një listë të kritereve ose elementeve* për përcaktimin e nocionit që identifikon ekzistimin dhe veprimet nga grupet kriminale tradicionale dhe rrjetet si dhe përfshirjen e entiteteve ligjore ose profesionistëve në forma të rënda të krimit të organizuar dhe krimin e "jakës së bardhë". Lista e kritereve e miratuar nga Bashkimi Evropian lidhur me krimin e organizuar përmban gjithsej 11 kritere, të ndara në dy grupe: **kriteret e detyrueshme dhe zgjedhore**. Andaj, besohet se duhet të paraqiten së paku gjashtë kritere me disa tipe të sjelljes ose veprimeve kriminale nga grupet kriminale që të vlerësohen si të organizuara<sup>60</sup>.

Për qëllim të Konventës së OKB-së për Krimin e Organizuar dhe Ndërshtetëror<sup>61</sup>, ai përkufizohet: "grupi i organizuar kriminal" nënkupton grupin e strukturuar të tre ose më shumë personave, që ekziston për një periudhë kohore dhe vepron së bashku me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda ose veprave të parapara në pajtim me këtë Konventë, me qëllim që, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, të marrin përfitim financiar ose tjetër. Ky përkufizim përdoret në Ligjin e Prokurorisë Publike<sup>62</sup>, sipas të cilit është themeluar Prokuroria Themelore kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

<sup>56</sup> Paraqitja e krimit të organizuar në Republikën e Maqedonisë analizohet bazuar në kërkesat e paraqitura në Rezolutën e EKOSOK-ut Nr. 1998/14 të 28 korrikut 1998.

<sup>57</sup> Situata në fushën e trafikimit të njerëzve dhe kontrabandimit të migrantëve në 2008; Situata në fushën e krimit të organizuar dhe veprimtarisë së MB-së në 9 muaj të 2009.

<sup>58</sup> <http://www.stat.gov.mk/Publikacij/2.4.10.12.pdf>

<sup>59</sup> Analiza është përgatitur bazuar në dokumentet nga Ministria e Brendshme. Pjesë të vlerësimit bazohen në të dhënat empirike dhe të pandryshueshme të policisë lidhur me rastet e dokumentuara dhe raportuara që janë në fazë të përndjekjes, hetimit ose procedimit gjyqësor. Nuk janë përdorur të dhëna nga burime tjera. Kriteret për karakteristikat kryesore të grupeve të organizuara kriminale, të pranuar në nivelin ndërkombëtar, janë përdorur si standarde themelore përzgjedhëse.

<sup>60</sup> Këto kritere përfshijnë elementet e mëposhtme: bashkëpunimi i tre ose më shumë individëve për periudhë më të gjatë ose të pakufizuar, të dyshuar ose të dënuar për kryerjen e veprave të rënda (të përcaktuara si të tilla në legjislacionin shtetëror për shkak të marrjes së përfitimit ose fuqisë, ku të gjithë të përfshirët kanë një detyrë ose rol); ekziston forma e disiplinës së brendshme dhe kontrollit; zbatohet dhuna ose forma tjera të frikësimit; zbatohet presioni në politikë, medie, administratë publike, sistemin ligjor; zbatohet korrupsioni ose format tjera të ngjashme në drejtësi dhe ekonomi; përdoren strukturat tregtare dhe biznesore si dhe pastrimi i parave, dhe veprimet në nivel ndërkombëtar.

<sup>61</sup> Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 55/25 e 15 nëntorit 2000, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërshtetëror-

<sup>62</sup> Ligji për Prokurorinë Publike nga 2007, Gazeta Zyrtare e RM-së Nr. 150, 12.12.2007

Regjistrimi, dokumentimi dhe analizimi i kësaj dukurie në Republikën e Maqedonisë bazohet në dispozitat e Kodit Penal si dhe praktikat ndërkombëtare dhe kriteret e miratuara për elementet që e bëjnë etiologjinë, dukurinë dhe praninë e grupeve të organizuara kriminale dhe veprimet e tyre në një fushë të caktuar. Pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal më 1996 Ministria e Brendshme themeloi emërtimin e ri të mbikëqyrjes së statistikave të krimit brenda kornizës së të cilës janë nënvizuar grupi i veprave tipike për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Ky grup mbikëqyrë në aspektin statistikor veprat në cilat përfshijnë në dispozitat ligjore elementet e veprimeve të organizuara ose grupeve, krime që në nivelin ndërkombëtar pranohen si më të shpeshta në veprimet e grupeve të organizuara kriminale si dhe vepra në fushën e korrupsionit<sup>63</sup>.

## Kriminalizimi i veprimeve të organizuara kriminale

Kodi Penal i 1996 i Republikës së Maqedonisë<sup>64</sup> përfshin dy dispozita në dy kapituj të veçantë të ligjit që inkriminojnë anëtarësinë në organizata kriminale: bashkimi për veprime armiqësore – dispozitë që inkriminon (1) komplotimin, bandat, ose bashkimet tjera të njerëzve me qëllim të kryerjes së veprave kundër shtetit, si dhe (2) anëtarësimi në bashkimet e tilla dhe dënimi i parashikuar është burgimi nga një deri në dhjetë vjet (1) dhe nga gjashtë muaj deri në pesë vjet (2); si dhe bashkimi kriminal<sup>65</sup> – dispozitë që inkriminon (1) krijimin e grupit ose bandës qëllimi i së cilës është kryerja e krimit i cili mund të sanksionohet me dënim me burgim prej 3 vjetësh ose më shumë, si dhe (2) përkatësia në këtë grup ose bandë. Dënimi i parashikuar është dënimi me burg prej një deri në pesë vjet (1), nga tre muaj deri në tri vjet (2), nga një deri në pesë vjet (3). Anëtar i grupit ose bandës, i cili zbulon grupin, përkatësisht bandën, para se ta kryejë ndonjë krim në të ose për të, lirohet nga dënimi (4).

<sup>63</sup> Bazuar në emërtim, gjatë 1997 dhe 1998 janë regjistruar gjithsej 317 vepra të këtij grupi të cilat janë kryer nga 436 kryerës. Nga numri i përgjithshëm i veprave të raportuara me elemente të të qenit të organizuar në mënyrën se si janë kryer (të kryera nga grupet, bandat ose shoqëritë) kanë qenë 27 raste të falsifikimit të parave, 19 raste të trafikimit të paligjshëm të drogave, 11 raste të kontrabandimit dhe 5 raste të grabitjes.

<sup>64</sup> Kapitulli 28 – Krimet kundër shtetit, Neni 324 – Bashkimi për veprime armiqësore dhe Kapitulli 33 – Veprat kundër rendit public, Neni 394 – Bashkimi kriminal

<sup>65</sup> Bashkimi kriminal – Neni 394

(1) Personi që krijon grup ose bandë që ka qëllimin e kryerjes së krimit, për të cilin mund të shqiptohet dënimi me burg prej tri vjetësh ose më shumë, dënohet me burg prej një deri në pesë vjet.

(2) Anëtar i grupit ose bandës dënohet me burgim prej tre muajsh deri në tri vjet.

(3) Nëse grupi ose banda ka për qëllim të kryejë krime për të cilat mund të caktohet dënimi prej së pakku tetë vjetësh, organizatori mund të dënohet me burgim prej së paku katër vjetësh dhe antëari i grupit ose bandës dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

(4) Anëtar i grupit ose bandës që e zbulon grupin, përkatësisht bandën, para se ta kryejë ndonjë krim në të ose për të, lirohet nga dënimi.

Objektet dhe mjetet e përdorura nga grupi ose banda për përgatitjen e krimit, si dhe financimi i tyre, konfiskohen.

Elementet e këtyre dy dispozitave nga Kodi Penal që inkriminojnë formimin e organizatave ose shoqatave kriminale janë:

- Kohëzgjatja e bashkëpunimit (e papërcaktuar);
- Bashkëpunimi i së paku tre personave (organizatori dhe dy persona tjerë);
- Formimi i organizatave ose shoqatave me qëllim të kryerjes së krimeve;
- Përfshirja në kryerjen e më shumë se një krimi;
- Përfshirja në kryerjen e krimeve të rënda (e cila parasheh dënim me burgim prej më shumë se tri vjetësh);
- Përfshirja në kryerjen e krimeve të llojit të veçantë (për Nenin 324 – kundër shtetit);
- Anëtarësia në shoqatën kriminale.

Shoqata kriminale është formë veçanërisht e rrezikshme e veprimit përgatitor për kryerjen e një numri veprash. Thelbi i saj lidhet në mobilizimin dhe organizimin e një numri personash për veprim të përbashkët bazuar në planin e përgatitur paraprakisht. Me inkriminimin e shoqatës kriminale si akt i veçantë, parashihet faza e mëparshme e formimit dhe organizimit të shoqatës kriminale si dhe përkatësia, p.sh. anëtarësia në shoqatën e tillë, nëse është rast i krimit më të rëndë. Formimi i shoqatës kriminale ka karakter të *delictum sui generis* me përjashtim të komplotit ku veprimet që janë pjesë e shoqatës përcaktohen më parë. Për shkak të rrezikut nga shoqërimi në kuptimin e krijimit të kërcënimit nga kryerja e një numri krimesh, kjo vepër është e natyrës së pavarur lidhur me kryerjen e veprimeve të parapara në plan të shoqatës ashtu që organizatori dhe anëtarët e shoqatës përgjigjen për këtë veprim edhe kur kryhen vetëm disa krime të planifikuara<sup>66</sup>.

Me amendamentet nga 2004<sup>67</sup> të Kodit Penal, disa nene të reja kanë zgjeruar fushëveprimin e inkriminimeve me përkufizimin e "organizatës terroriste"<sup>68</sup> me burgim minimal prej tetë vjetësh. Amendamentet më 2008 kanë përfshirë përgjegjësinë penale për "financimin e terrorizmit" (Neni 395-v) dhe veçanërisht krijimi i grupit të organizuar për atë qëllim është i dënueshëm me burgim prej minimum katër vjetësh<sup>69</sup>. Veç kësaj, ligjvënësi ka paraparë mundësinë që të trajtohet si grupi i organizuar nëse organizohet për "parandalimin e zgjedhjeve dhe votimit" (Neni 158 p. 2)<sup>70</sup>. Amendamentet e Kodit Penal nga 2009 edhe më shumë i kanë zgjeruar veprimet e grupit të organizuar në "Përdorimi i paautorizuar i të drejtave pronësore dhe kompanisë së tjetrit" (Neni 285 p. 5) duke parashikuar dënimin prej 5 vjetësh burgim<sup>71</sup>.

Është arritur përmirësim i dukshëm lidhur me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit me amendamentet nga ligji penal më 2004, e që zgjeruan politikat kriminale në luftën kundër korrupsionit, krimeve financiare dhe pastrimit të parave, duke vendosur vepër të re penale "**Mbulimin e prejardhjes së pronës së fituar shpërpjesëtimisht**" që mbulon zyrtarët publikë dhe personat përgjegjës që do të paraqesin informata të pavërteta për pasuritë dhe të hyrat e tyre ose për të cilat gjetjet tregojnë se pasuritë e tyre i tejkalojnë të hyrat e tyre ligjore në gjerësi domethënëse<sup>72</sup>.

<sup>66</sup> Shih: Vlado Kambovski, ibid.

<sup>67</sup> Gazeta Zyrtare Nr. 19/04 30.03.2004

<sup>68</sup> Neni 394-a Organizata Terroriste

<sup>69</sup> Gazeta Zyrtare Nr. 7/08 15.07.2008

<sup>70</sup> (2) Personi i cili kryen krimin e përcaktuar në paragrafin (1) përmes përdorimit të armëve, eksplozivëve ose mjeteve tjera të rrezikshme, duke përdorur dhunë ndaj dy ose më shumë personave ose brenda grupit të organizuar, ose në zonën e dy ose më shumë vendeve zgjedhore, dënohet me burgim nga një deri në tri vjet.

<sup>71</sup> Gazeta Zyrtare Nr. 114/09 14.09.2009

<sup>72</sup> Neni 359-a i Kodit Penal



Për më tepër, lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë, dispozita nga Neni 118 e Kodit Penal është shumë e rëndësishme, e cila parasheh se legjislacioni penal për qytetarin e Republikës së Maqedonisë zbatohet edhe në rastet kur ai kryen veprë jashtë shtetit.

Përveç kësaj, legjislacioni në sferën e luftës kundër krimit të organizuar është forcuar me Ligjin e veçantë për Kushtet dhe Procedurat për Përgjimin e Komunikimeve<sup>73</sup> dhe Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve<sup>74</sup>.

Ligji që plotëson Ligjin për Procedurën Penale (miratuar në korrik 2008) zgjeron fushëveprimin e zbatimit të masave të hetimit të veçantë të cilat ofrojnë zbatimin e këtyre masave për veprat për të cilat është paraparë dënimi me burgim nën katër vjet, pa kërkuar ekzistimin e grupit të organizuar prej së paku tre personave.

### Masat konfiskuese dhe paraprake

Një mënyrë e rëndësishme për forcimin e politikave kriminale është ndarja e organizatave kriminale dhe kriminelëve nga të ardhurat e fituara paligjshëm me mjetet e marrjes, p.sh. konfiskimi. Nga aspekti i pastrimit të parave konfiskimi është shumë i rëndësishëm duke pasur parasysh se, shqetësimi i kriminelëve që të ardhurat e tyre kriminale mund të konfiskohen, është faktori themelor që i motivon t'i pastrojnë të ardhurat nga krimi<sup>75</sup>.

Tre paragrafët e parë nga Neni 5 i Konventës së Vjenës mbulojnë problemin e konfiskimit në nivelin kombëtar, duke imponuar një seri obligimesh për shtetet, pa ndonjë kufizim në siguri. Përcaktimi i dyfishit të Konventës për pranimin e një nga dy tipet e sistemeve – konfiskimin e pronës ose konfiskimin e vlerave të caktuara, lë hapësirë për probleme në bashkëpunim ndërkombëtar. Sidoqoftë, Konventa nuk përmban ndonjë kufizim për miratimin e të dyja llojeve të konfiskimit në të njëjtën kohë.

Problemet e këtij lloji tejkalohen me Konventën e Strasburgut e cila bën përpjekje që ta forcojë plotësisht efikasitetin e bashkëpunimit në rastet e konfiskimit. Edhe pse teksti i dispozitës nga Neni 27 (2(a)) është i ngjashëm me tekstin nga Konventa e Vjenës, ai megjithatë shkon përtej në kërkesat e paraqitura duke i kërkuar secilit shtet të miratojë legjislacion ose masa tjera të nevojshme që do t'i mundësojnë t'u përgjigjet dy tipave të konfiskimit. Këto dhe dispozita tjera (13(4), 18(4)) që rregullojnë këtë procedurë i vendosën të dy sistemet e konfiskimit në të njëjtin nivel<sup>76</sup>.

Konfiskimi dhe marrja në nivel ndërkombëtar veç kësaj rregullohen dhe forcohen me nenin 12 të Konventës së Palermos ku parashihet mundësia për zbatimin e këtyre masave lidhur me të ardhurat nga krimi të fituara nga veprimtaria kriminale të parapara brenda kësaj Konvente.

Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar të trija konventat si dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (KKBKK).

<sup>73</sup> Ligji për Përgjimin e Komunikimeve, Nëntor 2006, Gazeta Zyrtare Nr. 121/2006

<sup>74</sup> Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, Gazeta Zyrtare Nr. 38/05

<sup>75</sup> Pastrimi i Parave, Libër, Slagjana Taseva, në gjuhën angleze, DataPons Shkup 2007

<sup>76</sup> Ibid p. 270

### a) Dispozitat materiale

Dispozitat nga nenet 98-100 nga Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë kanë paraparë mundësinë e *marrjes së përfitimit* të nxjerrë nga krimi, nga kryerësi dhe nga personat tek të cilët ajo është transferuar nëse nuk e kanë ditur – dhe kanë mundur ta dijnë – se ajo ka prejardhje nga krimet.

Për më tepër, miratohet parimi i zbatimit të të dy sistemeve për konfiskim – *prona dhe vlera* ashtu që nëse marrja nuk është e mundur kryerësi obligohet ta paguajë shumën që është e barabartë me përfitimin e nxjerrë.

Kjo dispozitë siguron bashkëpunim ndërkombëtar cilësor brenda kornizës së ndihmës së ndërsjellë juridike kur vendoset konfiskimi në rast të pastrimit të parave, në pajtim me dokumentet ndërkombëtare.

Forcim domethënës i mundësive për ndihmë juridike të ndërsjellë brenda kornizës së konfiskimeve është siguruar me miratimin e Ligjit për amendamentimin e Kodit Penal, në prill 2004<sup>77</sup>. Në amendamente titulli i Kapitullit 7 është zëvendësuar me "Konfiskimi i pronës dhe përfitimeve dhe konfiskimi i gjërave". Për më tepër, në tekstin e neneve 97-100 fjala "marrje" zëvendësohet me fjalën "konfiskim"<sup>78</sup>. Me këtë propozim, konfiskimi është paraparë si masë penale (jo sanksion!) dhe nga aspekti i zbatimit të standardeve ndërkombëtare është e rëndësishme që gjykata të jetë e aftë të nxjerrë vendim për konfiskimin në procedurën e parashikuar nga ligji dhe, në rastet kur për shkak të pengesave faktike ose ligjore, ajo nuk do të ketë mundësi të udhëheqë procedurë kundër kryerësit. Kjo po ashtu zgjidhë mëdyshjen që nëse masa e konfiskimit kërkon vendim gjyqësor për vepër të ndërlidhur penale. Veç kësaj, është po ashtu e rëndësishme të parashihet mundësia që, bazuar në marrëveshje ndërkombëtare, prona e konfiskuar t'i kthehet shtetit tjetër, konfiskimi nga personat e tretë, si dhe konfiskimi nga entitetet ligjore<sup>79</sup>.

Konfiskimi i të ardhurave nga krimi i kryer nga entiteti ligjor rregullohet nga dy nene të ndarë por të ndërlidhur të Kodit Penal: neni 96e ("Konfiskimi i pronës, fitimit nga prona dhe marrja e sendeve") që është paraparë nga ligji amendamentues i vitit 2004 si pjesë e Kapitullit të ri VI a "Sanksionet kundër Personit Juridik" parasheh që (1) Prona e konfiskuar dhe fitimi nga prona e fituar përmes veprimit kriminal nga personi juridik i nënshtrohet dispozitave të neneve 98 deri 100 të këtij Kodi. Neni 100 "Konfiskimi i pronës së fituar nga personi juridik" parasheh si më poshtë: Nëse personi juridik përfiton pronë të nxjerrë nga kryerja e veprës penale, ajo konfiskohet.

Në këtë kontekst, ia vlen të përmendet paragrafi 2 i nenit 96e i cili parasheh përgjegjësinë shtesë për personat fizikë pas personave juridikë (domethënë investuesit ose aksionarët) në rast se të hyrat fillimisht të fituara nga personi juridik nuk mund të konfiskohen nga entiteti në fjalë: (2) Nëse nga personi juridik nuk mund të konfiskohet prona ose përfitimi pronësor për shkak të faktit se ai është shuar para zbatimit të konfiskimit, atëherë themeluesi(t) e personit juridik, p.sh. për kompaninë aksionarët ose

<sup>77</sup> Gazeta Zyrtare Nr. 19/04 30.03.2004

<sup>78</sup> Teksti në maqedonishte përdor jo vetëm dy por katër terme të ndryshme, me sa duket rastësisht, për ta caktuar qoftë humbjen e përhershme apo të përkohshme të pronës; në shumë raste e njëjta fjalë përdoret për të dyja llojet e masave (ST).

<sup>79</sup> Kazнено – pravната reforma pred predizvicite na XXI vek, d-r Vlado Kambovski, Bato & Divajn, Skopje, 2002

investuesit e përbashkët janë të detyruar që bashkërisht ta caktojnë shumën e barabartë me përfitimin e nxjerrë pronësor. Kodi Penal gjithashtu parasheh konfiskimin e pronës që përbën dobitë, siç parashihen në nenin 100-a të Kodit Penal për konfiskim (në origjinal “marrje”) të dobive si dhe objekteve (e debatueshme) që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

## b) Dispozitat procedurale

Si rregull i përgjithshëm, regjimi i konfiskimit është dënim sikur parashihet nga neni 537(1) i Kodit të Procedurës Penale “Gjykata me vendim mund të shqiptojë konfiskimin e përfitimit<sup>80</sup> pronësor përmes të cilit i akuzuari gjendet fajtor, në vendimin për qortim ose në vendimin për zbatimin e masës edukative, përkatësisht në vendim me të cilin shqiptohet masa e sigurisë”.

Veç kësaj, ashpërsia e ligjit themelor theksohet nga rregullat procedurale meqë neni 533(1) i Kodit të Procedurës Penale (KPP) (ish neni 486) thekson se “*prona dhe përfitimi pronësor i nxjerrë nga kryerja e aktit kriminal vërtetohet në procedurë penale ex officio*”. Gjithashtu paragrafi 2 parasheh se si Gjykata ashtu edhe autoritetet tjera, para të cilave zhvillohet procedura penale, janë të detyruara të mbledhin dëshmi gjatë procedurës dhe t’i inspektojnë rrethanat “*të cilat janë të rëndësishme për përcaktimin e pronës dhe përfitimit pronësor*”. Për më tepër, neni 536(1) i KPP-së (ish neni 489) parasheh që sapo të përmushen kushtet për konfiskimin e pronës dhe përfitimit pronësor, gjykata *ex-officio* urdhëron masa të përkohshëm sigurie.

Në anën pozitive lidhur me konfiskimin e vlerës, mund të vërehet se sa kërkojnë aktivitet të gjerë *ex-officio* të gjykatës, rregullat procedurale në vendosjen për konfiskimin e vlerës së përfitimit pronësor. Veç dispozitave të cituara më lart, Neni 535 i KPP-së (ish neni 488) i kërkon gjykatës “*të urdhërojë ekspertizën*” në rast se vlera e përfitimit pronësor nuk mund të përcaktohet nga mjete tjera (paragrafi 1) si dhe të lëshohet kërkesa ndërkombëtare për marrje në rast kur supozohet se prona gjendet jashtë shtetit (paragrafi 2) dhe kërkon që gjykata gjatë mbledhjes së dëshmive të nevojshme për përcaktimin e shumës së saktë të përfitimit pronësor, mund të kërkojë të dhëna shtesë nga organet shtetërore, institucionet financiare dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë e që të gjithë janë të detyruar t’i dërgojnë informatat e kërkuara pa vonesë (paragrafi 3). Republika e Maqedonisë ende nuk e ka përfshirë ndërrimin e barrës së provave në kornizën e masave që shënjestrojnë të ardhurat e krimit.

Sa i përket rregullave të veçanta procedurale të cituara më lart, ato mund të gjenden në nenin 532 (ish neni 485) dhe nenin 541 (ish neni 493a) të KPP-së. Neni 532(1) parasheh konfiskimin in rem në aspektin e përgjithshëm, duke paraparë që “*objektet të cilat duhet të konfiskohen sipas Kodit Penal do të konfiskohen po ashtu kur procedura penale nuk mbaron pa vendim që e gjen të akuzuarin fajtor*”. Prandaj, kjo dispozitë i referohet rasteve kur ka përfunduar procedura penale por, për shkak të pengesave të lartpërmendura faktike ose ligjore, nuk ka qenë e mundur dënimi i kryerësit (p.sh. kryerësi nuk ka mundur të identifikohet ose duhet të ndërpritet procedura penale, etj.). Po ashtu është e zbat-

<sup>80</sup> Fitimi pronësor”, “përfitimi pronësor” si dhe “fitimi material” përdoren si përkthime alternative për fjalën e njëjtë në maqedonishtë “umomna korucm”.

ueshme nga gjykata, sipas paragrafit 3, "kur në verdiktin i cili e gjen të akuzuarin fajtor është dështuar nxjerrja e vendimit të tillë".

Rregulla më të shumta procedurale mund të gjenden në nenin 541 të KPP-së (ish neni 493a) i cili parasheh: (1) Kur ka pengesa faktike dhe ligjore për zhvillimin e procedurës penale kundër personit, gjykata do të zbatohet<sup>81</sup> procedurë të veçantë për konfiskimin e pronës dhe përfitimit pronësor dhe konfiskimin<sup>82</sup> e objekteve sipas propozimit të Prokurorit Publik nëse plotësohen disa kushte për zbatimin e këtyre masave të veçanta nga Kodi Penal.

Në procedurën e veçantë të përmendur më lart, gjykata ekzaminon dëshmitë e nevojshme që të vendosë nëse prona ose objektet përkatëse mund të konsiderohen si të ardhura nga krimi ose dobi pasurore (paragrafi 2). Është e dukshme se ende duhet të vërehet se të dy nenet – 532 dhe 541 – qartë mbulojnë paratë, objektet ose pronën e konfiskueshme sipas dispozitave të veçanta lidhur me disa vepra në Pjesën e Veçantë të Kodit Penal, përfshirë mes tjerash, pastrimin e parave në nenin 273(8) ose organizimin terrorist ("financimin") në nenin 394a(6).

Konfiskimi nga palët e treta mbulohet lidhur me konfiskimin e të hyrave nga krimi në pajtim me nenin 98(2) të Kodit Penal.

Kodi i Procedurës Penale ofron mbrojtje të mëtejme për të drejtat e palëve të treta bona fide. Neni 534 (ish neni 487) thekson se personi tek i cili është transferuar përfitimi pronësor si dhe përfaqësuesi i personit juridik do të ftohen për t'u marrë në pyetje në procedurat paragjyqësore dhe gjatë gjykimit, kur kanë të drejtë të paraqesin të dëshmi lidhur me përcaktimin e përfitimit pronësor.

### c. Masat e përkohshme

Një nga dy dispozitat boshtore brenda regjimit të masave të përkohshme është neni 219 i KPP-së (ish neni 203) që rregullon "konfiskimin e përkohshëm" të objekteve:

*(1) Objektet të cilat sipas Kodit Penal duhet të konfiskohen ose mund të shërbejnë si dëshmi në procedurën penale, konfiskohen përkohësisht dhe i besohen në ruajtje gjykatës ose ruajtja e tyre sigurohet në mënyrë tjetër.*

Në kontekst të dispozitës së mësipërme, termi "konfiskuar përkohësisht"<sup>83</sup> qartë i referohet asaj që çdokush normalisht do ta quante "marrje", që nënkupton masë të përkohshme. Si pasojë, neni 219(1) duket se zbatohet për çdo objekt që mund të konfiskohet sipas Kodit Penal përfshirë të ardhurat nga krimi si dhe dobitë pasurore të aktit kriminal dhe, padyshim, objektet që janë përfituar, duke qenë kështu të konfiskueshme sipas nenit 273(8) të KPP-së<sup>84</sup>. Për shkak të gjuhës kufizuese, neni 219(1) i KPP-së duket

<sup>81</sup> Përkthimi konfirmohet nga autoritetet e vendit

<sup>82</sup> Teksti i theksuar me pika i përshtatet kuptimit të termit të përdorur në origjinal në maqedonishte. Përkthimi në anglishte në vend të kësaj përdor fjalën "seizure". Origjinali në maqedonishte është "odzemanje".

<sup>83</sup> Origjinali në maqedonishte është "privremeno odzemanje".

<sup>84</sup> Në anën tjetër, fakti se Neni 219(1) i referohet "objekteve" por jo "të ardhurave" në kuptim të gjerë (ose "përfitim pronësor" meqë përdoret gjerësisht në KPP nënkupton se është dashur të synojë t'i mbulojë objektet e konfiskueshme sipas nenit 100a të Kodit Penal si dhe ato që bien nën fushëveprimin e dispozitave të veçanta si neni 273(8) por jo të ardhurat nga krimi në kuptimin e përgjithshëm.

se nuk mbulon as gjërat e paprekshme pronësore (p.sh. sigurimet e pa-materializuara<sup>85</sup> ose paluajtshmërinë). Ngjashëm, duket se paraja mbulohet vetëm nga ky nen për aq sa mund të konsiderohet "objekt" e që është, kryesisht në formën e të gatshmeve, përderisa asetet që përbëhen nga paraja në llogari bankare (depozitat në llogarinë bankare, etj.) duke se nuk mund të merren sipas nenit 219(1) të KPP-së.

Ligji amendamentues i 2004 futi një lloj të ri të masave të përkohshme në Kodin e Procedurës Penale në nenin 220 (ish neni 203a), sipas të cilit:

*(1) Gjyqtari hetues ose këshilli me vendim mund të urdhërojë sigurimin e përkohshëm të objekteve dhe mjeteve të cilat ndërlidhen me aktin kriminal. Prona ose mjetet që i nënshtrohen sigurimit janë nën mbikëqyrjen e gjykatës. Sigurimi i përkohshëm i objekteve ose pronës kuptohet<sup>86</sup> si ngrirje e përkohshme, marrje, mbajtje fondesh, llogarish bankare dhe transaksione financiare ose të ardhura nga krimi.*

Neni 220 i shtuar më pas (ish neni 203a) nuk është harmonizuar plotësisht me nenin tashmë ekzistues 219 (ish neni 203) i cili çoi në njëfarë mbivendosjeje dhe kështu e bënë të vështirë të përcaktohet fushëveprimi i saktë i dispozitave përkatëse<sup>87</sup>.

Në përmbajtje të tij, neni 219 dhe 220(1) përshkruan dy lloje të ndara të masave shtrënguese që janë të ndryshme jo vetëm në emrin e tyre ("sigurimi i përkohshëm" k. "konfiskimi i përkohshëm") por gjithashtu edhe sa i përket mbulimit të tyre. Në këtë kontekst, derisa neni 219 kufizohet në marrjen e objekteve të konfiskueshme sipas Kodit Penal, fushëveprimi i "sigurimit të përkohshëm" në nenin 220(1) përfshin çdo objekt dhe mjete që lidhen me aktin kriminal pa marrë parasysh nëse ato a mund të jenë lëndë e konfiskimit përfundimtar. Sidoqoftë, këto nene mbivendosen kur është fjala për objekte që nuk janë të lidhura me aktin kriminal por gjithashtu janë të konfiskueshme sipas Kodit Penal. Për objekte të tilla, praktikisht është e pamundshme të përcaktohet cila masë duhet të zbatohet për marrjen e tyre: "konfiskimi i përkohshëm" sipas nenit 219(1) ose "konfiskimi" tjetër i cili është një nga format e masave të sigurimit të përkohshëm sipas nenit 220(1).

Është shumë e rëndësishme përdorimi i terminologjisë juridike përkatëse për shkak të parimit të përgjithshëm të ligjshmërisë dhe sundimit të së drejtës. Në këtë aspekt, është e nevojshme të përmendet se në këto dy nene termi "konfiskim" përdoret për dy terme të ndryshme në maqedonishte: "zaplenuvanje"<sup>88</sup> në nenin 219 dhe "odzemanje"<sup>89</sup> në nenin 220(1). Sidoqoftë, kjo nuk nënkupton se këto masa kanë karakter të ndryshëm. Në të kundërtën, të dyja janë masa të përkohshme, e cila është e vetë dukshme lidhur me nenin 219 por në mënyrë të barabartë në rast të nenit 220(1) të cilat, sipas nenit 220(3) "mund të zgjasin deri në fund të procedurës" meqë kjo e fundit dhe ato të dyja përbëjnë privimin e përkohshëm të objekteve pronësore të cilat depozitohen në vend ruajtjen e gjykatës.

<sup>85</sup> Domethënë, sigurimet që nuk janë në letër dhe që nuk ekziston certifikatë, (atom und të ekzistojnë vetëm në formë të hyrjeve në librin e depozitimeve, etj.).

<sup>86</sup> Në këtë kontekst, shprehja "kuptohet si" i referohet listës së mbyllur të masave të zbatueshme përmes të cilave mund të bëhet sigurimi i përkohshëm i objekteve ose pronës.

<sup>87</sup> TI Maqedoni ka dërguar nismën në Gjykatën Kushtetuese për ta kontrolluar pajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 203a.

<sup>88</sup> "zaplenuvanje"

<sup>89</sup> "odzemanje"

Ndryshimet e vetme janë se, së pari, masat e sigurimit të përkohshëm, përfshirë "konfiskimi" në nenin 220(1) mund të zbatohet në bazë diskrecionale përderisa "konfiskimi i përkohshëm" duket të jetë i detyrueshëm sipas nenit 219 dhe, së dyti, masat e përkohshme të sigurimit zbatohen vetëm nga gjykata përderisa "konfiskimi i përkohshëm" po ashtu mund të zbatohet, sipas disa kushteve të përshkruara më poshtë, nga autoritetet ligj-zbatuese.

Për ta përmbledhur, ndërlidhja ndërmjet masave ngrirëse sipas paragrafëve 1 dhe 2 nuk është krejtësisht i qartë dhe lë të hapura shumë pyetje; kjo padyshim është rezultat i pasaktësive në procesin legjislativ dhe jo thjeshtë të përkthimit të keq.

Mund të gjenden rregulla të mëtejme procedural në paragrafët që mbesin të nenit 220, si:

(7) *Vendimin për ngrirjen e transaksionit financiar ose llogarisë bankare, gjykata e dërgon në bankë ose institucionin tjetër financiar.*

(8) *Askush nuk mund të pretendojë për fshehtësi bankare me qëllim që t'i ikë ekzekutimit (ta shmangë zbatimin) të vendimit gjyqësor për ngrirjen e përkohshme, marrjen ose mbajtjen e mjeteve të depozituara në bankë.*

Në kontekst të paragrafit të fundit, ngrirja padyshim i referohet parave në llogari bankare (paragrafi 7) ndërsa marrja ("konfiskimi") u referohet mjeteve që duket se shëndrojnë të gatshmet ose mjetet tjera të prekshme fizikisht të depozituara në bankë (p.sh. kasaforta). Në anën tjetër, mbetet konfuzioni për karakterin ndarës të "mbajtjes".

Të gjitha masat e përkohshme që u referuan më lart, mund të urdhërohen vetëm me vendim gjyqësor sapo të ketë filluar hetimi: gjatë fazës së hetimit nga gjyqtari hetues; pas nisjes së akuzave penale nga gjykata (gjyqtari ose paneli i gjyqtarëve).

Sipas Kodit të Procedurës Penale, hetimi penal kundër personit konkret fillon formalisht nga gjyqtari hetues sipas kërkesës së prokurorit publik. Urdhërat e ngrirjes dhe marrjes mund të qëndrojnë deri në përfundimin e procedurës. Kjo shprehimisht theksohet në rast të sigurimit të përkohshëm dhe/ose masave ngrirëse sipas nenit 220, paragrafët 3 dhe 4. Lidhur me nenin 219, nuk ka rregull të tillë specifike në KPP, megjithatë është e dukshme se procedura është e ngjashme me atë të nenit 220(3) lidhur me sigurimin e përkohshëm.

Sistemi ligjor maqedonas lejon masat e përkohshme në disa raste po ashtu edhe para fillimit formal të hetimit: neni 219(4) i KPP-së (ish neni 203) autorizon organet ligj-zbatuese që përkohësisht t'i marrin objektet gjatë procedurës së ashtuquajtur para-hetuese. Në kontekst të KPP-së, kjo i referohet, si rregull i përgjithshëm, Ministrisë së Punëve të Brendshme. Neni 145 (ish neni 142a) zgjeron këtë autoritet tek administrata e doganave (paragrafi 1) si dhe tek Policia Financiare (paragrafi 2) në rastet që bien nën kompetencat e tyre specifike, përfshirë, në rastin e të dyja autoriteteve, veprën e pastrimit të parave (neni 273 KPP).

Nenet 144 dhe 157, cituar nga neni 219(4) të KPP-së, i përkasin Kapitullit XV të Kodit të Procedurës Penale i cili merret me procedurën para-hetuese. Neni 144 (ish neni 142) vendos rregullat e përgjithshme se çfarë masash mund të merren nga organet ligj-zbat-

uese për ta zbuluar kryerësin, zbuluar dhe siguruar gjurmët e veprës dhe objekteve me vlerë të konsiderueshme dhe për t'i mbledhur të gjitha informatat e nevojshme për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale. Neni 157(1) i KPP-së (ish neni 147) në anën tjetër, parasheh që nëse ka rrezik të shtyrjes, Ministria e Punëve të Brendshme (ose, siç kemi parë më lart, Policia Financiare dhe Doganat) mund të ndërmarrin disa masa hetuese edhe para fillimit të hetimit, përfshirë marrjen ("konfiskimin e përkohshëm") të objekteve sipas nenit 219 të KPP-së (ish neni 203).

Ndryshe nga "konfiskimi i përkohshëm" (p.sh. marrja) i objekteve, sigurimi i përkohshëm dhe/ose masat e ngrirjes sipas nenin 220 të KPP-së (ish neni 203a) përfshirë "konfiskimin" (paragrafi 1) dhe "ngrirja (e përkohshme)" (paragrafët 1-2) nuk mund të zhvillohen nga autoritetet ligj-zbatuese në fazën para-hetuese të procedurës penale.

Lidhur me sigurimin e aseteve që përbëjnë të ardhura nga krimi, neni 536 i KPP-së (ish neni 489) parasheh masë të ndarë, të mëtejme që mund të zbatohet ekskluzivisht nga gjykata gjatë procedurës për konfiskimin e pronës dhe përfitimit pronësor (Kapitulli XXX): Kur plotësohen kushtet për konfiskimin e pronës dhe përfitimit pronësor, gjykata ex-officio urdhëron masat e përkohshme të sigurimit të parapara në nenin 219 të këtij ligji.

## Ndarja e përgjegjësisë për institucionet

Përveç cilësisë së kornizës ligjore që trupëzon standardet ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, segment i rëndësishëm i çdo regjimi cilësor kundër krimit të organizuar dhe konfiskimit janë institucionet që ndërmarrin veprime për zbulim dhe përndjekje. Duke pasur parasysh kompleksitetin e problemit, veçantinë e veprimeve, përfshirjen e numrit më të madh të veprimeve të ndërmarra nga persona të ndryshëm, që zakonisht veprojnë në territorin e disa shteteve, si dhe vështirësitë në sigurimin e dëshmitëve dhe fillimin e procedurave gjyqësore, këto aktivitete ndërmerren nga numër i madh i institucioneve<sup>90</sup>.

Praktika ndërkombëtare tregoi se vendosja e një regjimi cilësor për luftimin e krimit të organizuar, kërkon përpjekje të veçanta nga shtetet e krijuara rishtas që janë në fazën e tranzicionit. Kanë qenë të nevojshme përpjekje të veçanta për amendamentimin e ligjeve duke zbatuar standarde ndërkombëtare si dhe për ndryshimin e rolit tradicional të disa institucioneve dhe krijimin e institucioneve të reja.

Në Republikën e Maqedonisë me Kodin Penal të vitit 1996 si dhe me ligjet në fushën e ekonomisë, janë bërë hapa më domethënës për zbatimin e rendit të ri shoqëror, operationeve financiare dhe fiskale, rol i cili kuptohet dhe vlerësohet gradualisht. Ajo që mungon në këto përpjekje është efektiviteti në zbatimin e kornizës ligjore si dhe vendosja e duhur e burimeve në institucione. Nga treguesit empirikë dhe analizat e disa rrethanave, del përfundimi se nuk janë ndërmarrë masa të mjaftueshme të çfarëdo lloji për parandalimin e sjelljes kriminale si rezultat i tranzicionit dhe ndryshimeve në rendin shoqëror. Brenda kësaj kornize, segment i rëndësishëm janë masat kundër pastrimit të parave dhe konfiskimi i aseteve kriminale, duke pasur parasysh se synimi përfundimtar i organizatave kriminale dhe individëve është marrja e të ardhurave nga

<sup>90</sup> Pastrimi i Parave, Libër, Slagjana Taseva, p.

krimi dhe përfshirja e tyre në ekonominë ligjore.

Organet qendrore, nga të cilat është pritur të ndërmarrin masa kundër krimit të organizuar, ishte **Ministria e Brendshme** ku është themeluar Departamenti i Krimit të Organizuar me kompetencë qendrore për territorin e tërë shtetit. Duke synuar zbatimin e standardeve ndërkombëtare për krijimin e shërbimeve të veçanta që do të jenë kompetente për mbikëqyrje, kontrollim dhe hetim në fushën e krimit të organizuar financiar në Republikën e Maqedonisë, janë ndërmarrë masa të veçanta me qëllim të themelimit të këtyre shërbimeve<sup>91</sup>.

Në shtator 2001, pas miratimit të ligji për parandalimin e pastrimit të parave, është themeluar Drejtorati Kundër Pastrimit të Parave. Në nëntor 2002, pas miratimit të Ligjit kundër Korrupsionit në prill, është themeluar Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Në qershor 2003 është themeluar Policia Financiare e cila sot ka staf të plotë dhe ka filluar të veprojë me efikasitet. Veç kësaj, është krijuar njësi e veçantë në Prokurori për Krimin e Organizuar.

**Prokuroria Themelore** për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit është e autorizuar të veprojë për veprat penale të kryera nga grupi i strukturuar i tre ose më shumë personave për të cilët dënimi minimal është katër vjet burgim, për veprën e dhënies dhe marrjes së ryshfetit në vlerë domethënëse, për veprat e kontrabandimit me droga, dhe tipe tjera të krimeve të rënda. Është e rëndësishme të përmendet se prokurori publik është i autorizuar të ndërmarrë aktivitete ndërkombëtare kur krimi i kryer nga grupi i strukturuar kriminal është i natyrës ndërkombëtare.

**Njësia për Parandalimin e Pastrimit të Parave** - është njësi e llojit administrativë që ka nevojë ta zbatojë Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Është themeluar në shtator 2001 si organ i Ministrisë së Financave.

Bazuar në Ligjin për **Policinë Financiare**<sup>92</sup> - është formuar organi i administratës publike që vepron brenda Ministrisë së Financave. Interpretimi i lirë i synimit për formimin e këtij organi (i cili nuk është deklaruar në Ligj) do të ishte luftimi i krimit të organizuar financiar.

**Administrata e Doganave** - vepron brenda Ministrisë së Financave. Duke pasur parasysh standardet dhe praktikat ndërkombëtare në punën e administratës së doganave, ajo ndërmerr hapa për zgjerimin e punës në fushën e parandalimit të kalimit të kufirit dhe krimit të organizuar dhe, brenda kësaj kornize, gjithashtu në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.

**Zyra e të Hyrave Publike** - është kompetente për kontrollimin dhe mbledhjen e taksave publike. ZHP-ja është e autorizuar të hetojë dhe ka autorizime të veçanta brenda kornizës së kontrollit. Bazuar në Ligj, ZHP-ja është e obliguar ta kontrollojë prejardhjen e pronës së taksapaguesve dhe të raportojë, për dyshimet e saj për krimet ose veprat e

<sup>91</sup> Sektori i Veçantë i Krimit Financiar, Sektori për Bashkëpunim Policor Ndërkombëtar, Sektori për Teknikat e Veçanta të Hetimit, Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Njësia për Analizat e Inteligjencës Kriminale që do të bashkëpunojnë me Policinë Financiare, Doganat dhe Drejtoratin kundër Pastrimit të Parave.

<sup>92</sup> Ligji për Policinë Financiare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 55 nga 16 qershori 2002. Ligji ka hyrë në fuqi më 1 shtator 2002.




kryera, tek organet kompetente për përndjekje. Me qëllim të thjeshtimit të kontrollit në fushën e taksave fiskale, ZHP-ja ka vendosur sistemin për regjistrim qendror të pronës së paluajtshme. Në të ardhmen kjo bazë e të dhënave mund të paraqesë bazë solide brenda kornizës së hetimeve dhe analizave të të dhënave financiare.

**Ministria e Drejtësisë** - ka rol të rëndësishëm në përgatitjen e ligjeve, miratimin e dokumenteve ndërkombëtare dhe zbatimin e tyre në legjislacionin shtetëror. Për më tepër, Ministria po ashtu ka rol të rëndësishëm në bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale specifike dhe luan rol kyç brenda kornizës së ndihmës juridike për shkëmbimin e dokumenteve, duke ofruar dëshmi, marrjen dhe konfiskimin, si dhe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në rastet e ekstradimit.

**Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit** - është formuar në nëntor 2002 bazuar në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Ky organ i pavarur shtetëror i përbërë nga shtatë anëtarë është kompetent për zbatimin e ligjit që vendos masat për parandalimin e korrupsionit gjatë ushtrimit të pushtetit dhe kryerjes së detyrave të caktuara publike, masat për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe masat për parandalimin e korrupsionit gjatë kryerjes së detyrave me interes publik nga entitetet ligjore.

Ligji për Menaxhimin e Pronës së Marrë, Fitimeve Pronësore dhe Objekteve të Marra në Procedurë Kriminale dhe Kundërvajtëse, miratuar në qershor 2008, është miratuar si përgjigje ndaj nevojës për shmangien dhe parandalimin e keqpërdorimit dhe sjelljes së pahijshme në trajtimin e pronës së marrë, si një nga burimet e mundshme të korrupsionit. Ky Ligj parasheh themelimin e **Agjencisë për Trajtimin e Pronës së Marrë**.





Shqipëri

## Vlerësimi mbi nivelin e krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme

Vështrim i perspektivës shqiptare në legjislacionin dhe praktikën e luftës kundër krimit të organizuar dhe aseteve të paligjshme

Pozita gjeografike e Shqipërisë, duke shërbyer si udhëkryq midis lindjes dhe perëndimit, niveli i lartë i varfërisë në gjithë vendin, mosfunksionimi i shtetit ligjor dhe mungesa e instrumenteve të nevojshme ligjore për ta luftuar krimin e organizuar, kanë qenë faktorët kryesorë për transformimin e vendit në rrugë kryesore për tregtinë e paligjshme dhe veprimtari kriminale. Gjatë regjimit totalitar, rrethimi dhe pamundësia e kalimit të kufijve shërbyen si arsye kryesore për veprimtarinë e parë të vërejtur të krimit të organizuar e cila përbëhej nga kontrabandimi i grupeve kriminale të hajnave. Pas viteve 1990, hapat e parë të demokracisë dhe hapjes së kufijve nuk mund të mos shqetësoheshin pa importimin e tendencave kriminale nga vendet fqinje. Brenda një periudhe të shkurtër, grupet e thjeshta kriminale do të zhvilloheshin në grupe të strukturuar dhe organizuara. Duke u përballur me funksionimin e dobët të institucioneve shtetërore dhe paaftësisë së tyre që të përballen dhe t'i luftojnë veprimtaritë e grupeve të organizuara kriminale, do të çonin në situatë të rënduar e cila do ta rendiste Shqipërinë në mesin e vendeve me shkallë të lartë të krimit.

Grupet e armatosura kriminale dhe veprimtaria e grupeve arritën shkallën më të lartë më 1997 dhe në të njëjtën kohën dolën si grupe të strukturuar kriminale. Këto grupe të strukturuar kriminale i ndanë detyrat, kishin veprimtari kriminale të vazhdueshme, intensifikuan veprat e rënda, etj.

Për disa vjet reagimi ndaj veprimtarive kriminale në rritje ishte i dobët për shkak të presionit, korrupsionit, frikës dhe pasigurisë. Sidoqoftë, ishte presioni i vazhdueshëm ushtruar nga organizatat ndërkombëtare dhe nga vet qytetarët që i bënë institucionet të ndërmarrin masa për luftimin e krimit të organizuar dhe disa prej formave të tij, si: trafikimi i qenieve njerëzore – femra ose fëmijë, trafikimi i armëve, trafikimi i automjeteve, trafikimi i substancave narkotike dhe kultivimi i bimëve narkotike. Sipas të dhënave të policisë, gjatë periudhës 2002-2006 janë shuar rreth 500 grupe kriminale me tendencë të krimit të organizuar, në mesin e të cilave kishte edhe organizata kriminale të mirëfillta që merreshin me substanca narkotike, trafikimin e qenieve njerëzore dhe trafiqe tjera, si dhe krime ekonomike dhe pastrim parash. Vetëm gjatë periudhës 2005-2007 janë shuar dhe përfunduar disa përndjekje penale lidhur me luftën kundër krimit të organizuar të cilat kanë ndikuar në ndërtimin e besimit dhe ngritjen e vetëdijes tek qytetarët.

Aktualisht Shqipëria është shtet anëtarë në disa nisma rajonale dhe më të gjera dhe anëtarë i organizatës "SECI", "Interpol", ajo po ashtu ka ratifikuar dhe nënshkruar disa konventa ndërkombëtare dhe marrëveshje për ta luftuar krimin e organizuar. Këto dispozita e obligojnë Shqipërinë të angazhohet për bashkëpunim rajonal dhe marrëdhënie të mira fqinjësore me qëllim të zhvillimit të projekteve të përbashkëta në çështje të lidhura me luftën kundër krimit të organizuar, migrimit dhe trafikimit të paligjshëm, veçanërisht pëfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandimin, trafikimin e paligjshëm të armëve dhe automjeteve, kontrollin dhe sigurinë e kufijve, etj.

Raportet nga Departamenti i Shtetit i Sh.B.A.-ve tregojnë se veprimtaria kriminale në përgjithësi ka rënë, siç ilustron nga numri i vrasjeve të regjistruara, e cila nga përafërsisht 200 në vitin 2006 ka rënë në më pak se 90 në secilin nga dy vitet e fundit. Po ashtu vlerësohet se vazhdojnë të rriten aftësitë ligj-zbatuese të Shqipërisë, veçanërisht në fushat e trajnimit kundër narkotikëve dhe krimit të organizuar. Gjatë vitit 2010, Ministria e Brendshme ka raportuar se policia shtetërore ka hetuar 1931 raste të ndërlidhura me korrupsionin dhe krimet financiare, dhe autoritetet kanë arrestuar 359 persona. Qeveria ka konfiskuar përafërsisht 835 milionë lekë shqiptar (8 milionë \$) asete. Sipas Ministrisë së Brendshme, policia ka zbërthyer grupet e organizuara kriminale gjatë vitit. Sidoqoftë, krimi i organizuar mbetet problem i madh për zhvillimin e vendit. Hap domethënës në luftën e Shqipërisë kundër krimit të organizuar është bërë me Ligjin e sapo miratuar i njohur me emrin “Anti Mafia”, duke zgjeruar mundësitë ligjore që të ndalohet kjo dukuri e cila prej ca kohësh është bërë murtajë për vendin dhe reputacionin e tij ndërkombëtar.

### Baza ligjore dhe ndarja e përgjegjësive për institucionet

Korniza ligjore e luftës kundër krimit të organizuar përbëhet nga këto ligje kryesore:

- Ligji Nr. 8920 i datës 11.07.2002 “Për Ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndër-shtetëror dhe dy protokolleve; Protokollit të Palermos të vitit 2000 “Për Parandalimin, Luftimin dhe Dënimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht femrave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara “Kundër Krimit të Organizuar Ndër-Shtetëror”;
- Ligji Nr. 9749 i datës 04.06.2007 “Për Policinë Shtetërore”;
- Ligji Nr. 8677 i datës 02.11.2000 “Për Organizimin dhe Veprimtarinë e Policisë Gjyqësore”, i plotësuar me Ligjin Nr. 10 301 të datës 15.07.2010;
- Ligji Nr. 7895 i datës 27.01.1995 “Për Kodin Penal” me amendament të ndryshme plotësuese kryesisht lidhur me veprat e cilësuar si krim i organizuar;
- Ligji Nr. 7905 i datës 21.03.1995 për “Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë” i cili viteve të fundit ka kaluar nëpër seri të ndryshimeve dhe përmirësimeve lidhur me procedurat penale të kryerësit e veprave penale dhe zbatimin e metodave dhe teknikave të specializuara hetuese;
- Ligji Nr. 10 192 i datës 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit përmes Masave Parandaluese kundër Aseteve”, po ashtu i njohur si Ligji “Kundër Mafisë” i cili shfuqizoi dhe zëvendësoi Ligjin Kundër Mafisë të vitit 2004.

Ligji Anti Mafia - ndahet në 7 kapituj: (i) parimet dhe dispozitat e përgjithshme; (ii) sekuestrimi i aseteve; (iii) administrimi i aseteve të sekuestruara; (iv) konfiskimi i aseteve të sekuestruara; (v) vendimi, apelimi dhe ekzekutimi i masave parandaluese; (vi) përdorimi i aseteve të konfiskuara; dhe (vii) dispozitat përfundimtare. Ai synon t'i adresojë sfidat e luftimit të krimit të organizuar përmes regjimit modern të konfiskimit të të ardhurave të ndërlidhura me veprimtarinë kriminale dhe zhvillohet në përvojën e legjislacionit paraprak për mos-dënim bazuar në falsifikim, deri në vitin 2004.

Neni 1 parasheh objektin (lëndën) e ligjit i cili i përkufizon procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër aseteve të personave të cilët i nënshtrohen këtij ligji si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim. Neni 2 parasheh qëllimin e ligjit si parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të aseteve të personave të cilët kanë nivel të paarsyetuar ekonomik si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale.

Ligji Kundër Mafisë mundëson mos-dënimin e bazuar në procedurë të falsifikuar që të rimerren të ardhura nga krimet (neni 3). Ai ofron kthimin e barrës së provës dhe i jep përparësi konfiskimit kriminal. Po ashtu ofron masat parandaluese, të cilat në nenin 4 përkufizohen si çdo masë e natyrës pronësore që gjykata urdhëron në procedure gjyqësore përmes sekuestrimit të aseteve, veprimtaria ekonomike dhe profesionale e personave, si dhe përmes konfiskimit. Procesi është i natyrës civile dhe bazohet në Kodin e Procedurës Civile (neni 5). Sidoqoftë, procedura zhvillohet nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (neni 7) e cila, kërkesat për konfiskim, i gjykon me një gjyqtar të vetëm. Kërkesat për konfiskimin e aseteve gjykohen me praninë e tre gjyqtarëve. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda po ashtu gjykon me praninë e tre gjyqtarëve.

Një nga sfidat kyçe me të cilat përballet legjislacioni është nevoja për luftimin e barazpeshuar të pushtetit shtetëror dhe nevoja të sigurohet se zbatohet sundimi i së drejtës, se garantohet gjykimi i drejtë për të gjitha palët e përfshira. Lidhur me dispozitat e gjykimit të drejtë, Kushtetuta e Shqipërisë garanton presupozimin e pafajësisë dhe të drejtën e gjykimit të drejtë. E drejta në pronë po ashtu sigurohet në nenin 42 të Kushtetutës, edhe pse qartas dispozita e tillë nuk i njeh të ardhurat nga krimi si pronë ligjore, dhe për këtë arsye mund t'i nënshtrohet marrjes dhe konfiskimit për aq sa bëhet duke siguruar të drejtën e gjykimit të drejtë dhe procesin e duhur. Ligji Kundër Mafisë zbatohet ndaj aseteve si për personat fizikë dhe të afërmit e tyre (deri në brezin e 4) ashtu edhe për personat juridikë. Meqë procedura zhvillohet kundër personit që posedon të ardhurat nga krimi dhe jo kundër vet pronës, prokuroria duhet ta lidhë personin me veprimtarinë penale në fjalë, ose marrëdhënia që personi në posedim të të ardhurave nga krimi (me dijëni ose pa dashje) ka ndaj personit që ka kryer ndonjërin nga veprat sipas nenit 3. Sidoqoftë, në ligj nuk është e qartë se deri në çfarë gjerësie prokuroria duhet të paraqesë se nuk mund të provojë prejardhjen ligjore të aseteve, dhe nëse është e mjaftueshme për prokurorinë që ta vërtetojë se ajo nuk mund ta paraqesë prejardhjen ligjore të aseteve.

Hetimi dhe zhvillimi i ndërgjyqësisë është përgjegjësi e prokurorit me ndihmën e policisë gjyqësore (neni 9). Janë tre prokurorë me përgjegjësi për këtë punë dhe secilit i janë caktuar nga një ose dy policë gjyqësorë të punojnë me të.

Lidhur me administrimin e aseteve të sekuestruara, neni 16 i Ligjit Kundër Mafisë imponon detyrën që gjykata ta caktojë administratorin që t'i ruajë dhe administrojë asetet e sekuestruara dhe, nëse është e mundshme, ta rrisë vlerën e tyre. Neni 17 kërkon që administratori të paraqesë lutje tek Gjykata për ta autorizuar dhënien në hua, të nënshkruajë marrëveshje pajtimi, arbitrimi, premtimi, zotimit, hipoteke ose tjetërsimi të aseteve të sekuestruara ose të kryejë veprime tjera ligjore të administrimit.

Agjencia për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAASK) është përgjegjëse për administrimin e aseteve të marra sipas Ligjit Kundër Mafisë dhe Ligjit

Nr. 9258 për Masat kundër Financimit të Terrorizimit dhe për vënien në jetë të aseteve të konfiskuara sipas Ligjit Kundër Mafisë. Pronësia e pronës i kalon shtetit sapo të nxirret urdhëri i konfiskimit (neni 29.3). Administratori i caktuar t'i menaxhojë asetet e sekuestruara mund të vazhdojë të veprojë në emër dhe për llogari të AAASK-së derisa nuk zëvendësohet nga ndonjë person tjetër (neni 31). Administratori është i detyruar ta likuidojë (shesë) pronën e luajtshme (neni 32), por Këshilli i Ministrave, duke vepruar sipas kërkesës së Ministrit të Financave (neni 33) është përgjegjës për të vendosur se çfarë duhet të ndodhë me pronën e luajtshme dhe të paluajtshme e cila mund të përdoret për veprimtari ekonomike, tregtare dhe profesionale. Neni 37 themelon fondin e veçantë për parandalimin e kriminalitetit me 50% të të hyrave të nxjerra gjatë viteve 2009-2010.

### Institucionet Përgjegjëse

**Ministria e Brendshme** (Policia Shtetërore) organizon punën për identifikimin dhe luftimin e krimit të organizuar, arrestimin e autorëve dhe përndjekjen e tyre. Bashkëngjitur këtij institucioni, janë themeluar struktura të veçanta për luftimin e krimit të organizuar, si pjesë e Departamentit të Përndjekjes Penale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, me organizim qendror dhe lokal. Departamenti i Kufijve dhe Migracionit po ashtu ndihmon në këtë fushë duke ndërmarrë masa për ruajtjen dhe kontrollimin e kufijve, kontrollimin dhe trajtimin e të huajve, etj. Specialistët në këto struktura kanë kompetencë të mbledhin informata dhe kompetencat e policisë gjyqësore. Këto struktura organizohen në atë mënyrë që të jenë të afta të mbledhin informata për tendencat e krimit të organizuar, ta kontrollojnë atë dhe të ofrojnë dëshmitë e nevojshme për paraburgimin e kryerësve.

**Ministria e Drejtësisë** - angazhohet në hartimin e legjislacionit në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të paligjshëm, si dhe përgatitë politikat për luftimin serioz të krimit të organizuar.

**Prokuroria e Përgjithshme** - përndjekë veprimtarinë e organizuar kriminale dhe zbulon veprimtarinë e kryerësve në tërësi, ofron dokumentim ligjor për veprimtarinë e tyre dhe propozon dënime të rëna penale. Prokuroria mbikëqyrë zbatimin e metodave dhe teknikave aktuale për hetimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit, duke ofruar kështu dëshmi ligjore për veprimtarinë e kryerësve.

**Gjykatat:** Neni 7 i Ligjit Anti Mafia, përkufizon kompetencat dhe përbërjen e gjykatës. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese procedohet në shkallën e parë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, dhe në shkallën e dytë nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Prokuroria dhe Policia Gjyqësore janë përgjegjëse për verifikime parajmëruese të aseteve: hetimi i aseteve financiare, veprimtarisë ekonomike, tregtare ose profesionale, mënyrës së jetesës dhe burimeve të të hyrave të personave, të cilët i nënshtrohen zbatimit të këtij ligji. Me autorizimin e lëshuar nga Prokuroria ose Gjykata, zyrtarët e Policisë Gjyqësore mund të vendosin për sekuestrimin e dokumenteve të gjykuara bazuar në rregullimet e ofruara në nenet 208, 209, 210 dhe 211 të Kodit të Procedurës Penale.

Institucioni përgjegjës për administrimin e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara është Agjencia e Administrimit të Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAASK), siç përkufizohet në nenin 34 të Ligjit Anti Mafia.

## Zbatimi i ligjeve dhe efektet e arritura në praktikë

Zbatimi i bazës ligjore për këtë çështje ofron një numër të aluzioneve (çështjeve) për t'u adresuar. Legjislacioni dytësor ka nevojë të zhvillohet më tej me qëllim të përkrahjes së legjislacionit aktual kryesor. Ligji Anti Mafia përmban shumë kufizime kohore, të cilat zbatohen strikt dhe mund të çojnë në dështim të procedurave për konfiskim civil. Ka rreziqe të dukshme nëse palët mund ta shtyjnë procedurën dhe kështu ta mundin qëllimin e legjislacionit. Kjo çështje duhet të adresohet duke siguruar që ekziston sistemi i menaxhimit efektiv të rasteve që të përcillen kufijtë kohorë dhe se prokuroria dhe policia gjyqësore kanë burime të mjaftueshme, dhe se gjykata ka kohë të mjaftueshme që të sigurojë se janë ndërmarrë hapa të nevojshëm në kohë të mirë.

Regjistruesi i aseteve duhet të jetë elektronik dhe në dispozicion të të gjitha agjencive përkatëse për ta parë dhe freskuar. Së paku ai duhet të jetë i aftë që të lidhet me rastin dhe ta identifikojë në mënyrë unike çdo aset duke regjistruar datën e marrjes dhe nga kush; përshkrimin; kushtet e asetit; vendin; vlerën e vërtetë dhe aktuale; shumën e nxjerrë nga shitja; dhe metodën e disponimit. Nëse asetet e vlerës së vogël nuk hyjnë në regjistrë individualisht, ato duhet të grupohen së bashku dhe të paraqiten në regjistrë si grup. Po ashtu ka nevojë për statistika më komplete dhe për raportimin publik të punës së AAASK-së dhe agjencive të saj partnere.

Është i nevojshëm rregullimi më i qartë për mundësitë e teknikave të veçanta hetuese, rishikimi i Ligjit Kundër Mafisë lidhur me të, si dhe zgjerimi i mundësive të paraqitura në Kodin e Procedurës Penale.

Sidoqoftë, miratimi dhe zbatimi i legjislacionit aktual provohet të jetë efektiv. Institucionet po bashkëpunojnë dhe është zgjeruar numri i rasteve të suksesshme. Gjatë vitit 2010, Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda ka nxjerrë rreth 30 vendime me burgim deri në 25 vjet dhe vendime me burgim të përjetshëm, për disa organizata të njohura kriminale dhe trafikues ndërkombëtar të cilat janë konsideruar si raste të suksesshme në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të narkotikëve.

## Rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010

Në Raportin e Progresit të vitit 2010, Komisioni Evropian ka vlerësuar qartë se Shqipëria ka vendosur kornizën përkatëse ligjore dhe institucionale lidhur me luftën kundër krimit të organizuar. Reformimi i autoriteteve ligj-zbatuese si dhe burimet dhe pajisjet përkatëse të tyre, i kanë kontribuar luftimit të kësaj dukurie. Sidoqoftë, zbatimi efektiv i legjislacionit të ri dhe profesionalizmi i strukturave të reja dhe sistemeve duhet të vërtetohen më tej në praktikë. Duhet të sigurohet hetimi proaktiv dhe rastet që janë hetuar me sukses duhet të ndiqen nga dënimet. Veprimtaria e grupeve të organizuara kriminale në Shqipëri, që kanë ndikim jashtë vendit, mbetet çështje e shqetësimit serioz. Është i nevojshëm forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar përfshirë, në veçanti, vendet fqinje. Derisa e vë theksin në kornizën e përmirësuar ligjore me Ligjin



“Anti Mafia”, KE-ja vëren se duhet të sigurohet dhe demonstron zbatimin e tij efektiv, në veçanti menaxhimi efektiv i aseteve të marra dhe konfiskuara, përmes regjistrimit të konfiskimeve përfundimtare.

Sa i përket zbatimit të bazës ligjore, KE-ja e vlerëson atë lidhur me strukturat institucionale që në praktikë merren me dukurinë. Struktura e re policore që reflekton përpjesëtimin që i është dhënë hetimit të krimeve të organizuara, është në fuqi që nga korriku i vitit 2000. Janë ofruar burimet njerëzore me qëllim të shtimit të numrit të stafit që merren me hetimet e krimit të organizuar dhe janë vënë dispozita buxhetore për investime të mëtejme. Futja e njësive të përbashkëta hetuese për ta luftuar krimin ekonomik dhe korrupsionin është provuar efektive. Janë bërë përpjekje të rritet kapaciteti hetues dhe promovohet qasja më proaktive dhe e udhëhequr nga inteligjenca. Kështu, është e nevojshme që të vazhdojë trajnimi me prokurorinë dhe agjencitë ligjzbatuese me qëllim që të forcohet më tej bashkëpunimi operacional ndërmjet policisë dhe prokurorisë. Përqëndrimi i fortë që të zhvillohet më tej i referohet trajnimit të specializuar, në veçanti aspekteve ndërkombëtare të krimit të organizuar. Komisioni Evropian tërheq vëmendjen se qasja proaktive e autoriteteve ligjzbatuese është kyçe në luftimin e krimit të organizuar, i cili mbetet çështje shqetësimi për vendin.

### **Roli i Shoqërisë Civile në luftën kundër krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme**

Lufta kundër krimit të organizuar, duke qenë dukuri e shqetësimit të madh për vendin tonë, po ashtu shpesh ndiqet dhe ngritet nga organizatat e shoqërisë civile dhe ndihma e bashkësisë ndërkombëtare. Fushatat e ngritjes së vetëdijes dhe ofrimit të informatave, konsiderohen mjet i suksesshëm që përdoret nga këto organizata për informimin e publikut për shkaqet, pasojat dhe mënyrat mbrojtëse ndaj kësaj çështjeje. Numër i konsiderueshëm i OJQ-ve ofrojnë ndihmë ndaj viktimave të trafikimit, veçanërisht fëmijëve dhe femrave. Këto organizata po ashtu angazhohen në rehabilitimin shoqëror të viktimave nga krimi i organizuar, ndihmën terapeutike dhe shërimin e përdoruesve të substancave narkotike.

## Përfundime

98

Fusha e luftimit të krimit të organizuar dhe trafikimit të paligjshëm është një nga fushat me përparësi të Republikës së Shqipërisë, në kontekstin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Shqipëria duhet të angazhohet në promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore për zbatimin e projekteve të përbashkëta në çështjet e ndërlidhura me luftën kundër krimit të organizuar dhe aseteve të fituara paligjshëm. Këto përpjekje duhet të bëhen nga të gjitha institucionet përkatëse duke synuar shkatërrimin e grupeve kriminale, zvogëlimin e krimit të organizuar dhe që qytetarët të lirohen nga shqetësimi i kriminalitetit, si dhe të vendosen standarde të larta sigurie, të zbatohet ligji prerë dhe të respektohen të drejtat dhe liritë njerëzore.

Duhet të përqendrohet vëmendja te monitorimi në praktikë i legjislacionit, me vëmendje të veçantë në hetimin dhe konfiskimin e aseteve. I tërë sistemi duhet ta vërtetojë transparencën dhe përshtatshmërinë e kthimit të të ardhurave nga krimi. Akterët shtetërorë duhet t'i ofrojnë të gjitha burimet e nevojshme që të zbatohet qartë Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Terrorizmit.





British Embassy  
Pristina

The opinions expressed herein are those of the author. This publication was made possible through support provided by:  
Mendimet e shprehura në tekst janë të autorit. Ky publikim është bërë i mundur nga përkrahja e ofruar prej: